



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në
“Inxhinierinë Fizike”**

ofruar nga

**Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti Politeknik i
Tiranës”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof.Dr. Margarita Ifti

2. Dr. Erinda Ndreçka

Tetor 2024

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Për programin e studimit Bachelor në “Inxhinierinë Fizike” ofruar nga Institucioni i
Arsimit të Lartë “Universiteti Politeknik i Tiranës”**

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti Politeknik i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Inxhinierisë Fizike
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në “Inxhinierinë Fizike”
4	Urdhëri/VKM i licensimit:	Shkresë MASH Nr. 5354 Prot, datë 22.08.2005
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër QSHA Nr. 221, datë 12.05.2021
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vjet/6 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	32 PAE/3 PAK v.a. 2023-2024 30 PAE/5 PAK v.a. 2022-2023 30 PAE/9 PAK v.a. 2021-2022
18	Numri i studentëve:	- 5 Studentë regjistruar v.a. 2023-2024 (35 Studentë aktivë) - 7 Studentë regjistruar v.a. 2022-2023 (65 Studentë aktivë) - 20 Studentë regjistruar v.a. 2021-2022 (72 Studentë aktivë)
19	Komente / të tjera:	-

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit të ciklit të parë “Bachelor në Inxhinierinë Fizike”, është miratuar nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës përmes shkresës me Nr. 5354 Prot, datë 22.08.2005. Ky program studimi nuk ka kaluar më parë në proces akreditimi.

Bazuar në dokumentacionin e ofruar, në raportin e vlerësimit të brendshëm si dhe nga vizita në institucion, rezulton se programi i studimit *Bachelor* në “Inxhinierinë Fizike”, është program studimi i ciklit të parë, me formë studimi me kohë të plotë, zhvillohet në gjuhën shqipe, në auditor dhe i përket nivelit të 6^{te} të kualifikimit sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Kohëzgjatja normale e programit të studimit është 3 vite, gjithsej 180 kredite ECTS.

Programi i ciklit të parë të studimit Bachelor në Inxhinierinë Fizike në thelbin e tij ka si objektiv kryesor t’u japë studentëve njohuri shkencore themelore që ofrojnë sektorët e ndryshëm të Fizikës së Zbatuar. Në përfundim të programit të studimit, inxhinieri i ardhshëm pajiset me njohuri për: metodologjitë moderne të Fizikës së zbatuar, zgjidhjen e problemeve konkrete të projektimit dhe administrimit, teknologjinë e pajisjeve lazer dhe të fibrave optikë, përdorimin e teknologjisë kompjuterike, zbatimin e projekteve të ndryshme inxhinierike, mirëmbajtjen dhe kontrollin e asistuar të sistemeve inxhinierike, optikën inxhinierike, fotonike, në teknologjinë e matjeve të rrezatimeve optike, të temperaturës, të emisioneve akustike etj. Përmes kësaj synohet t’u ofrohen studentëve perspektiva më të mira lidhur me përshtatjen, fleksibilitetin dhe integrimin në tregun e punës. Gjithashtu përgatitja e ofruar i lejon studentit të diplomuar në këtë program studimi vazhdimin e mëtejshëm të studimeve në ciklin e dytë Master.

Nga takimet në dekanat e departament, si edhe nga dokumentat e shqyrtuara, rezulton që ky program ka gjithashtu si qëllim të jetë në përmirësim të vazhdueshëm dhe të përafrohet me programet e studimit të ngjashme në BE dhe që përshtaten më mirë tregut dhe kërkesave të industrisë në Shqipëri.

Niveli i kualifikimit të stafit akademik që angazhohet në këtë program studimi është një garanci më shumë për vijueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e tij.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

GVJ përbëhet nga dy anëtarë: Prof. Dr. Margarita Ifti dhe Dr. Erinda Ndreçka. Koordinator teknik për ASCAL në këtë procedurë vlerësimi është MSc. Muhamed Prezja.


Ekspertët e vlerësimit të jashtëm janë përzgjedhur duke patur në konsideratë kompetencat profesionale në lidhje me fushën e këtij programi studimi, eksperiencën e tyre në vlerësime të programeve të studimit, integriteti profesional, mungesa e konfliktit të interesit për të siguruar paanshmëri dhe objektivitet në gjykim dhe në vlerësim.

GVJ, në punën e tij, ka shfrytëzuar “Raportin e vlerësimit të brendshëm” të hartuar nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm (GVB), i ngritur pranë Departamentit të Fizikës, Fakulteti i Inxhinierisë Matematike e Fizike, si dhe dokumentacionin në Dosjen e Vlerësimit të Brendshëm (DVB) e përbërë nga 141 dokumenta që shoqëronin këtë raport.

Në kuadër të hartimit të raportit, grupi ka vepruar me ndarje pune, detyrash dhe përgjegjësisht të përcaktuara qartë për secilin anëtar. Të dhënat e vëna në dispozicion përmes DVB u diskutuan dhe u verifikuan gjatë takimeve vlerësuese të zhvilluara 13 – 14 Qershor 2024, në kujdesin e koordinatorit teknik të ASCAL. Institucioni kishte marrë të gjitha masat për realizimin me sukses të takimeve, në përputhje me agjendën e vizitës.

Raporti i përgatitur përmbledh rezultatet e shqyrtimit të dokumentacionit të DVB, si dhe të informacionit të mbledhur dhe diskutuar gjatë takimeve me përfaqësuesit e Institucionit.

Me datë 19.09.2024, GVJ dorëzojë pranë IAL-së nëpërmjet sistemit AMS Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm për këtë program studimi. Me datë 30.09.2024, IAL solli komentet e saj dhe i vetmi koment që i drejtohej GVJ-së kishte të bënte me numrin e studentëve, duke qenë se tabela më sipër kërkonte pasqyrimin e nr të studentëve të regjistruar për herë të parë, ndërsa IAL kërkon të pasqyrohet edhe numri i studentëve aktivë. GVJ e mori në konsideratë komentin dhe këto të dhëna janë pasqyruar më lart, me qëllim evidentimin e plotë të nr. të studentëve. Ky raport merr formën finale.



I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësive kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Statuti <i>[Ref_001 Statuti i UPT]</i> , Plani strategjik i UPT <i>[Ref_004 Plani Strategjik 2019-2024 UPT]</i> dhe historia e UPT garantojnë plotësimin e këtij kriteri. UPT është i vetmi institucion publik që ofron studime në inxhinieri. FIMF ofron programin Bachelor në Inxhinierinë Fizike <i>[Ref_034 Rregullore Njesia Baze DIF]</i> , <i>[Ref_035 Plani Strategjik Njesia Baze 2019-2024 DIF]</i> , <i>[Ref_036 Plani i Zhvillimit te Strategjise 2019-2024 DIF]</i> , <i>[Ref_038 Rregullore e Programit te Studimit Bch.IF]</i> , i cili kontribuon në përgatitjen e specialistëve që do të punojnë drejt zgjidhjes së problemeve konkrete të projektimit dhe administrimit, në teknologjinë e pajisjeve lazer dhe të fibrave optikë, përdorimin e teknologjisë kompjuterike, zbatimin e projekteve të ndryshme inxhinierike, mirëmbajtjen dhe kontrollin e asistuar të sistemeve inxhinierike, optikën inxhinierike, fotonike, në teknologjinë e matjeve të rrezatimeve optike, të temperaturës, të emisioneve akustike etj. Padyshim që ky është një kontribut i rëndësishëm në zhvillimin e vendit.
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Si edhe programet e tjera të studimit në UPT, ky program është në përputhje të plotë me misionin e UPT, që përgatit specialistë në fushat inxhinierike të gjeologjisë, burimeve minerare, naftës&gazit, mekanike, materiale, tekstil dhe konfeksione, elektroenergjetike, automatizim industrie, makatronikë, elektronike, telekomunikacion, inxhinieri informatike, inxhinieri matematike, inxhinieri fizike, ndërtim, mjedis, hidroteknikë, gjeodezi dhe në ato të arkitekturës dhe urbanistikës <i>[Ref_001 Statuti i UPT]</i> , <i>[Ref_003 Kodi i Etikës i UPT]</i> , <i>[Ref_004 Plani Strategjik 2019-2024 UPT]</i> . Programi i studimit Inxhinierinë Fizike konsiston në zbatimin e njohurive shkencore në fushën e fizikës në zgjidhjen e problemeve konkrete të projektimit dhe administrimit, në përputhje me vizionin dhe misionin e Departamentit të Inxhinierisë Fizike <i>[Ref_034 Rregullore Njesia Baze DIF]</i> , si dhe në përputhje me strategjinë e FIMIF <i>[Ref_031 Rregullore Njesia Kryesore FIMIF]</i> .
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të	Misioni i UPT është përparimi i shkencës, i teknologjisë dhe i arsimit të lartë nëpërmjet integritetit të tyre. UPT promovon dhe rrit rolin e tij në procesin e zhvillimit të shoqërisë, përmes transferimit të teknologjisë

strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.	dhe informacionit, si edhe shërbimeve për territorin dhe komunitetin. Ai promovon kërkimin shkencor bazë dhe të zbatuar si dhe siguron koordinimin dhe zhvillimin e projekteve kërkimore në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar [Ref_001 Statuti i UPT], [Ref_003 Kodi i Etikës i UPT], [Ref_004 Plani Strategjik 2019-2024 UPT]. Duke gjykuar mbi përmbajtjen e programit të studimit Bachelor në Inxhinierinë Fizike, GVJ mendon se është në përputhje me këto parime dhe dokumenta.
Kriteri 4. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	UPT ka 8 njësi kryesore dhe 30 njësi bazë dhe ofron programe studimi te nivelit I, II, III. Si institucion i specializuar në fushën e inxhinierisë dhe teknologjisë, ai posedon infrastrukturë të mjaftueshme në programet e studimit që ofron dhe u kushton studentëve një vëmendje të posaçme. Programet kryesore që ofron FIMIF ofron si pjesë e UPT, kanë formuar breza të shumtë, inxhinierësh fizikanë, inxhinierësh matematicienë etj. FIMIF me personelin akademik, ndihmës akademik dhe administrativ ka kapacitetet e nevojshme për ofrimin e programit të studimit në përputhje me Kodin dhe standardet e cilësisë. Numri i përgjithshëm i personelit akademik në FIMIF gjatë vitit akademik 2023-2024 është 138 nga të cilët 70 janë personel akademik me kohë të plotë, 7 personel ndihmës akademik me kohë të plotë. Për plotësimin e nevojave të mësimdhënies, institucioni ka angazhuar 61 personel akademik me kontratë ose të ftuar. Personeli i angazhuar në programin e studimit Bch. në Inxhinierinë Fizike përbëhet nga 17 personel akademik me kohë të plotë, nga të cilët 1 është me titullin Profesor, 8 janë me titullin Profesor i Asociuar, 6 janë me gradën Doktor dhe 2 janë doktoratura në progres. Ndërkohë për të plotësuar nevojat e mësimdhënies DIF ka angazhuar 17 personel akademik me kohë të pjesshme, nga ku 4 kanë titullin Profesor i Asociuar, 5 mbajnë gradën Doktor dhe 8 janë MSc. Numri i personelit ndihmës akademik është 3 me gradën MSc. Në shërbim të tyre janë edhe 7 personel adiminstrativ. [Ref_VI.ANEKS Tabelat permbledhese per RVB Bch.IF, Tabela 1], [Ref_047 Lista e Personelit Akademik te Angazhuar ne Bch.IF], [Ref_048 CV e Personelit Akademik te Angazhuar ne Programin Bch. IF], [Ref_049 CV e Personelit Akademik dhe Ndhimes Akademik DIF].
Kriteri 5. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të	Programet e studimit në UPT synojnë arsimimin profesional dhe kualifikimin shkencor të studentëve në fushën e inxhinierive dhe teknologjisë [Ref_004 Plani Strategjik 2019-2024 UPT]. Studimet në programin Bachelor në Inxhinierinë Fizike synojnë të sigurojnë njohuritë e nevojshme në: metodologjitë moderne të Fizikës së zbatuar, zgjidhjen e problemeve konkrete të projektimit dhe administrimit, teknologjinë e paisjeve lazer dhe të fibrave optikë, përdorimin e teknologjisë kompjuterike, zbatimin e projekteve të ndryshme inxhinierike, mirëmbajtjen dhe kontrollin e asistuar të sistemeve

programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	inxhinierike, optikën inxhinierike, fotonike, në teknologjinë e matjeve të rrezatimeve optike, të temperaturës, të emisioneve akustike etj. Përmbajtja e programit i pajis studentët me njohuri të mjaftueshme teorike dhe praktike në këtë drejtim, si edhe u jap shprehitë elementare në kërkim shkencor të pavarur për vijimin e mëtejshëm të kualifikimeve dhe studimeve. Bazuar në statutin e institucionit [Ref_001 Statuti i UPT], Rregulloren e universitetit [Ref_002 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT]. Rregulloret e fakulteteve, strategjinë e zhvillimit dhe programet që çdo fakultet ofron, fusha e përgjithshme dhe specifike e programeve të studimit është në përputhje me fushën kryesore të UPT. Programi i studimit BSc. në Inxhinierinë Fizike, është në të njëjtin profil që ka njësia kryesore, sikurse në njësi analoge në vend dhe Europë. Institucioni zbaton me përpikmëri çdo udhëzim apo akt nënligjor të publikuar dhe DIF gjithashtu ka bërë propozimin e kodit të programit në Inxhinierinë Fizike, sipas udhëzimit përkatës, dhe është në pritje të përgjigjes zyrtare nga organet përkatëse. Programi i përket nivelit 6 të EQAF ose KSHK (Korniza Shqiptare e Kualifikimeve).			
Konkluzione	GVJ konstaton se stitucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, fushën e veprimtarisë, si dhe në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit e me fushat e drejtimeve akademike të tij. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit janë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësive kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe	UPT, si i vetmi universitet publik inxhinierik, ka një traditë dhjetra vjeçare pune (ku deri në vitin 1991 ishte pjesë e Universitetit të Tiranës,

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Safa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.asc.al

mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	i vetmi universitet në vend). UPT koordinon punën në fushën e inxhinierisë dhe teknologjive. Ndaj ai vazhdimisht mbikëqyr mbarëvajtjen e programit dhe ndërton e mban marrëdhënie të bashkëpunimit brenda institucionit përmes ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre <i>[Ref_001 Statuti i UPT], [Ref_002 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT], [Ref_007 Organigrama e UPT].</i>
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	UPT është i përfshirë në rrjete të ndryshme akademike si: UNICA (Network of Universities from the Capitals of Europe), CMU (Community of Mediterranean Universities), BUA (Balkan Universities Association), BSUN (Black Sea Universities Network), RMEI (Réseau Méditerranéen des Ecoles d'Ingénieurs), AUF (Agence Universitaire de la Francophonie). UPT ka pranuar dhe firmosur Magna Charta Universitatum së bashku me 903 universitete nga 87 vende të botës <i>[Ref_010 Marrëveshjet Institucionale UPT], [Ref_011 Marrëveshjet me Industrinë dhe Institucione UPT].</i> UPT ka marrëdhënie dhe memorandume bashkëpunimi me mbi 50 universitete të huaja, nga 28 vende të botës, të shtrira në 3 kontinente. Ndër to përmendim: Ghent University, Norwegian University of Science & Technology, Erasmus University Rotterdam (IHS), Louisiana State University, Politecnico di Milano, Università degli Studi di Firenze, Aristotle University of Thessaloniki, Università degli Studi di Genova, Dalian University of Technology, Politecnico di Torino, National Chiao Tung University, Istanbul Technical University, Université de Technologie de Compiègne, Università IUAV di Venezia, École Spéciale des Travaux Publics du Bâtiment et de l'Industrie etj. <i>[Ref_010 Marrëveshjet Institucionale UPT], [Ref_011 Marrëveshjet me Industrinë dhe Institucione UPT].</i> UPT ka marrëdhënie bashkëpunimi me kompani prestigjioze në vend e në rajon, si: Konfindustria, Bankers Petroleum Albania, Deloitte, Lufthansa Industry Solutions, Albpetrol, KESH sh.a. HEC Vau-Dejës, HEC Ashta, Telekom Albania, Digitalb sh.a., Alufloor, Alumil Albania, Opel Noshi, Hyundai Auto Albania, Ford Albanian Motor Company etj <i>[Ref_010 Marrëveshjet Institucionale UPT], [Ref_011 Marrëveshjet me Industrinë dhe Institucione UPT].</i> FIMIF si pjesë e UPT, bashkëpunon me të gjithë partnerët e UPT dhe me institucionet politikëbërëse në vend. Ndërkohë, vetë FIMIF ka bashkëpunim të ngushtë me institucione të së njëjtës fushë në vend <i>[Ref_010 Marrëveshjet Institucionale UPT] [Ref_128 Lista e Institucioneve Bashkepunuese per Praktikat Profesionale FIMIF].</i>

Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.	Përveç këtyre, DIF në 05.03.2024 ka nënshkruar një marrëveshje të rëndësishme bashkëpunimi me eksperimentin CMS të CERN-it [Ref_062 Marrëveshje Bashkëpunimi me CERN]. Planet mësimore rishikohen dhe përmirësohen vazhdimisht, për t'u shërbyer më mirë nevojave të tregut. Në funksion të zhvillimit të praktikave profesionale, FIMIF dhe në veçanti DIF, ka bashkëpunime të ngushta me institucione të arsimit të lartë, [Ref Shtese_Lista e Institucioneve Praktikat Mesimore_BSc.Ing.Fizike], [Ref_128 Lista e Institucioneve Bashkëpunuese per Praktikat Profesionale FIMIF], [Ref_VI.ANEKS Tabelat permbledhese per RVB Bch.IF, Tabela 5], [Ref_010 Marrëveshjet Institucionale UPT], si dhe Akademinë e Shkencave [Ref_009 Marrëveshje me Akademinë e Shkencave UPT].			
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Interesi për të nënshkruar dhe zbatuar marrëveshje bashkëpunimi ka qenë i dukshëm, si nga ana e FIMIF, ashtu edhe nga ana e partnerëve. Jo vetëm që studentët kryejnë praktikat pranë kompanive, por edhe punonjës të këtyre kompanive vijnë të marrin pjesë në leksione të hapura në departament. Në mënyrë të veçantë njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte për përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione apo biznese, në funksion të realizimit të programit të studimit. I gjithë ky proces bashkëpunimi ka qenë në qendër të analizave për përfitimet nga ky bashkëpunim [Ref. 133 Përfitimet nga marreveshjet me te trete, Ref_VI.ANEKS Tabelat permbledhese per RVB Bch.IF, Tabela 5].			
Konkluzione	GVJ konstaton se Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, ka siguruar marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësiwe përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre dhe ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj. UPT ka nënshkruar marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, praktikave të punës etj. Njësia përgjegjëse për programin e studimit harton periodikisht raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1 Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi i studimit Bachelor në Inxhinierinë Fizike është në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr. 80/2015 për “Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe akteve nënligjore në fuqi. Ai organizohet në module dhe vlerësohet me kredite sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Një student që ndjek këtë program studimi grumbullon 60 kredite në vit, nëse ai rezulton kalues në të gjitha lëndët. Programi ofrohet me 180 ECTS, me kohëzgjatje normale të parashikuar 3 (tre) vite akademike. Detyrimi përmbyllës për marrjen e diplomës shlyhet në trajtën e provimit të formimit apo me punim diplome, sipas zgjedhjes së studentit. Programi i studimit bazohet mbi Rregulloren e Programit dhe është i detajuar sipas planit mësimor, i cili zbërthen çdo modul në orë dhe kredite. Ndarja e peshës së kategorive për veprimtaritë formuese është në përputhje me kërkesat ligjore për programet e studimit të ciklit të parë (bachelor), përkatësisht: Lëndë Bazë – 20%, Lëndë Karakterizuese – 53.34%, Lëndë Ndërdisciplinore – 13.33%, Lëndë Plotësuese – 10%, Detyrime Përmbyllëse – 3.33% <i>[Ref_038 Rregullore e Programit të Studimit Bch.IF]</i> .
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashi-	Programi i studimit Bachelor në Inxhinierinë Fizike synon të prodhojë specialistë që shfrytëzojnë si inxhinierë njohuritë themelore që ofrojnë fusha të ndryshme të Fizikës, pra, që aplikojnë këto njohuri për të zgjidhur probleme e situata inxhinierike. Po ashtu, studentët aftësohen në përdorimin e teknologjisë kompjuterike. Në përfundim të programit të studimit inxhinieri i ardhshëm pajiset me njohuri për: metodologjitë moderne të Fizikës së zbatuar; zgjidhjen e problemeve konkrete të projektimit dhe administrimit; teknologjinë e paisjeve lazer dhe të fibrave optikë; zbatimin e projekteve të ndryshme inxhinierike, mirëmbajtjen dhe kontrollin e asistuar të sistemeve inxhinierike; optikën inxhinierike, fotonike, në teknologjinë e matjeve të rrezatimeve optike, të temperaturës, të emisioneve akustike etj; monitorimin e mjedisit etj; gjë që shpesh kërkon përdorimin e teknologjive kompjuterike. Në rregulloren e programit të studimit shtjellohen dhe kompetencat e fituara nga ky program. Këto njohuri bazë thellohen më tej gjatë studimit në pro-

kueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	gramet master shkencor. Njohuritë, aftësitë dhe kompetencat e përfituara nga studenti detajohen për çdo lëndë në programet e tyre [Ref_031 Rregullore Njesia Kryesore FIMIF], [Ref_038 Rregullore e Programit të Studimit Bch.IF], [Ref_044-046 Programet Lendore (Syllabus) Bachelor IF 21-24].
Kriteri 3. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	Planet dhe programet mësimore përcaktojnë qartë ndarjen e komponenteve mësimore në mësim në auditor (leksione, ushtrime, laboratore, etj), studim individual, praktika mësimore apo prodhuese, projekte e tezë diplome. Lëndët bazë (Analizë Matematike A e B, Algjebër e Gjeometri, Kimi, Fizikë e Përgjithshme A e B) kanë 34 kredite ose 18.8%; lëndët karakterizuese (Fizikë e Përgjithshme C e D, Fizikë Tektike, Elektroteknikë, Bazat e Elektronikës, Elementë të Telekomunikacionit, Fizikë Kompjuterike, Matje Elektronike, Optikë, Bazat e Automatikës, Fizikë Atomike e Bërthamore, Bazat e Mekanikës Kuantike, Shkenca dhe Teknologjia e Materialeve, Parime dhe Zbatime të Rrezeve Laser, Dozmietri, Karakterizim i Materialeve, Fizikë e Trupit të Ngurtë) marrin 94 kredite ose 52.2%, lëndët ndërdisiplinore/integruese (Statistikë, Ekonomi e Menaxhim, Analizë Matematike C e D, Teknologji Mekanike) kanë 26 kredite ose 14.4%, lëndët plotësuese (Informatika A, Gjuha e Huaj dhe Komunikimi) kanë 20 kredite ose 11.1% dhe teza e diplomës ka 6 kredite ose 3.3% [Ref_038 Rregullore e Programit të Studimit Bch.IF].
Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	Praktika profesionale ka 3 kredite. Ajo realizohet në bashkëpunim me institucionet me të cilat UPT/FIMIF ka marrëveshje bashkëpunimi. Studentët kanë detyrimin e kryerjes 100% të orëve të praktikës mësimore. Gjatë kryerjes së praktikës mësimore, pedagogu përgjegjës mban lidhje me kompaninë/institucionin ku ajo kryhet. Në përfundim të praktikës studenti përgatit një relacion për punën e kryer, i cili vlerësohet nga komisioni i ngritur në departament. Vlerësimi bëhet me notë. Në rastet kur studenti për arsye objektive nuk shlyen detyrimet për praktikën mësimore, Departamenti, mbështetur në kërkesën e studentit (depozituar në Departament) mund t'i jape të drejtën për rikryerjen e praktikës mësimore deri në fund të vitit akademik. Në përfundim të kursit të plotë të programit të studimit Bachelor në Inxhinierinë Fizike, studentët kanë të drejtë të diplomohen në fushën e Inxhinierisë Fizike. Studimet e ciklit të parë "Bachelor në Inxhinierinë Fizike" përmbyllen me Provim të Përgjithshëm përfundimtar ose Punim Diplome (detyrimet përmbyllëse kanë 6 kredite) dhe në përfundim të tyre lëshohet diplomë "Bachelor në Inxhinierinë Fizike". Studenti nuk mund të mbrojë tezën e diplomës/provimin final pa shlyer më parë të gjitha detyrimet dhe pa fituar numrin e krediteve të parashikuara në planet mësimore të programit përkatës të studimit. [Ref_038 Rregullore e Programit të Studimit Bch.IF].

Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	<i>UPT nuk është IAL me status të veçantë.</i>
Kriteri 6. Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Programi i studimit Bachelor në Inxhinierinë Fizike është program i vetëm në llojin e tij i ofruar në vendin tonë. Planet dhe programet mësimore janë hartuar sipas modelit të “Universitetit të Torinos” dhe atij të “Universitetit Politeknik të Milanos”. [Ref_010 Marrëveshjet Institucionale UPT], [Ref_011 Marrëveshjet me Industrinë dhe Institucione UPT]
Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Universiteti Politeknik i Tiranës me shkresën nr 132/8 të datës 31/03/2023 i ka propozuar MAS [Ref_091 Udhëzim i MAS per Kodifikimin e PS], listën e kodeve të programeve që ofron sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të përcaktuara në Udhëzimin e MAS. Në këtë shkresë dërgohet tabela përëmbledhëse me të dhënat për programet e studimit të ofruara nga UPT, të organizuara sipas fakulteteve, lista me programet e studimit, llojin e programeve, kohëzgjatjen e tyre, gjuhën dhe kodin e propozuar në përputhje me fushën e detajuar të studimit. Programi BSc në Inxhinierinë Fizike ka kodin 63BA 0719 S. [Ref_090 Kodifikimi i Programeve ne UPT].
Kriteri 8. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	N/A
Konkluzione	<i>GVJ konkludoi se: Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialiteteve, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të</i>

	nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale. Në të janë të përcaktuara qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/modulet sipas kategoritve dhe me ngarkesën përkatëse në kredite. Programi i studimit Bachelor në Inxhinierinë Fizike është program i vetëm në llojin e tij i ofruar në vendin tonë. Planet dhe programet mësimore janë hartuar sipas modelit të "Universitetit të Torinos" dhe atij të "Universitetit Politeknik të Milanos". Programi i studimit shoqërohet me kordin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Programi i studimit BSc. në Inxhinierinë Fizike, ofrohet nga Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike. FIMIF-i, mbështetur në kornizën ligjore në fuqi, ka organizimin e vet të brendshëm në njësi bazë (departamentet dhe Qendra e Gjuhëve të Huaja) dhe ato ndihmëse (sekretaria mësimore, dega e financës dhe dega e Sigurimit të Cilesisë dhe Këshillimit të Karrierës dhe Alumni). FIMIF ka strukturë akademike në përputhje të plotë me Udhëzimin Nr. 27, datë 29.12.2017 "Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë", pika 6. Përgjegjës për zhvillimin e programit të studimit është departamenti ndërsa të gjitha njësitë e tjera bazë dhe strukturat e tjera kontribuojnë në realizimin me sukses të tij. Secila njësi bazë është përgjegjëse për lëndë/ grup-lëndësh të caktuara të cilat mbulohen nga personeli respektiv. Drejtuesi i departamentit është autoriteti drejtues akademik i tij dhe e përfaqëson atë [Ref_031 Rregullore Njësia Kryesore FIMIF], [Ref_048 CV e Personelit Akademik të Angazhuar në Programin Bch. IF], [Ref_049 CV e Personelit Akademik dhe Ndihmes Akademik DIF]. Departamenti monitoron në mënyrë të vazhdueshme realizimin e të gjitha veprimtarive mësimore e shkencore për programin e studimit dhe aktivitetet e tjera në funksion të tij [Ref_034 Rregullore Njësia Baze DIF]. Të gjitha proceset e vendim-marrjes në funksion të programit të studimit që ka nevojë për miratim, diskutohen gjerësisht në departamente dhe më pas në dekanat ku miratohen [Ref_059 Shembull Mbledhje Departamenti DIF]. P.sh. miratimi i ndryshimeve të propozimeve në përmbajtje të programit.

	kriteret e pranimit, metoda të mësimdhënies apo realizimi i praktikave profesionale jashtë institucionit etj <i>[Ref_043 Miratim KPS per Ndryshim te Planit Mesimor Bch. IF 2022-2023]</i>. Departamenti i Inxhinierisë Fizike (DIF) zhvillon veprimtarinë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në përmbushje të standarteve të cilësisë në mësimdhënie dhe kërkim shkencor. DIF është pjesë e FIMIF. Në përputhje me “Ligjin Nr 80/2015 për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, DIF vepron si njësi bazë mësimore-kërkimore në FIMIF të Universitetit Politeknik të Tiranës. Në këtë kuadër, njësia kryesore (Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike) dhe njësia bazë (Departamenti i Inxhinierisë Fizike) përmbushin detyrimet ligjore për vlerësim dhe akreditim të programit Bachelor në Inxhinierinë Fizike.
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	FIMIF përmbush të gjitha detyrimet ligjore e nënligjore në fuqi në lidhje me numrin e personelit akademik, kualifikimet, ngarkesën, numrin e lëndëve të zhvilluara dhe përputhshmërinë e lëndës me përgjegjësin e saj <i>[Ref_044-046 Programet Lendore (Syllabuse) Bachelor IF 21-24]</i>, <i>[Ref_048 CV e Personelit Akademik te Angazhuar ne Programin Bch.IF]</i>, <i>[Ref_VI. ANEKS Tabelat permbledhese per RVB Bch.IF]</i>. Bazuar në planin mësimor të çdo viti akademik, fakulteti angazhon personel akademik me kohë të pjesshme dhe të ftuar, <i>[Ref_VI.ANEKS Tabelat permbledhese per RVB Bch.IF]</i> por peshën kryesore e zë personeli akademik efektiv i cili realizon përqindjen më të madhe të ngarkesës totale të programit të studimit mbi 70% <i>[Ref_VI. ANEKS_Tabelat permbledhese per RVB Bch.IF]</i>. Numri i përgjithshëm i personelit akademik në FIMIF gjatë vitit akademik 2023-2024 është 138 nga të cilët 70 janë personel akademik me kohë të plotë, 7 personel ndihmës akademik me kohë të plotë. Për plotësimin e nevojave të mësimdhënies, institucioni ka angazhuar 61 personel akademik me kontratë ose të ftuar. Personeli akademik i programit të studimit Bachelor në Inxhinierinë Fizike në vitin akademik 2023-2024 përbëhet nga 17 personel akademik me kohë të plotë, nga të cilët 1 është me titullin Profesor, 8 janë me titullin Profesor i Asociuar, 5 janë me gradën Doktor i Shkencave dhe 2 janë në proces doktoreture. Për të plotësuar nevojat e mësimdhënies DIF ka angazhuar 17 personel akademik me kohë të pjesshme, nga të cilët 4 kanë titullin Profesor i Asociuar, 5 mbajnë gradën Doktor i Shkencave dhe 8 janë MSc. Numri i personelit ndihmës akademik është 3, me gradën MSc <i>[Ref_VI. ANEKS Tabelat permbledhese per RVB Bch.IF]</i>.
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për pro-	Programi i studimit Bachelor në Inxhinierinë Fizike ka përcaktuar një koordinator të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me

gramin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	objektivat e tij. Koordinator i programit të studimit dhe Këshilli i programit të studimit informojnë vazhdimisht departamentin/drejtuesin e departamentit dhe koordinon me strukturat përgjegjëse aktivitetet për zhvillimin e programit të studimit, në përputhje me rregulloren e njësive bazë dhe kryesore [Ref_039 Vendimi per Emerimin e KPS te Bch. IF] .			
Konkluzione	<i>GVJ nga vizita në institucion dhe shyrtime i dosjes së vetëvlerësimit konkludoi se: Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin, si edhe angazhon personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj. Ajo ka caktuar një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Njësia bazë përgjegjëse për këtë program studimi është DIF/FIMF. Ajo disponon të gjithë informacionin e nevojshëm për organizimin e programit, për strukturën dhe përmbajtjen e tij. Ky informacion qarkullon, ruhet dhe arkivohet në bazë të rregullores për Qarkullimin dhe Arkivimin e Dokumentacionit të brendshëm në UPT. Rregulloret përkatëse, rregullorja e programit të studimit, plani mësimor, programet e lëndëve dhe informacione të tjera të nevojshme për zhvillimin e programit të studimit mund të gjenden në faqen zyrtare të UPT/FIMIF. [Ref_002 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT], [Ref_031 Rregullore Njësia Kryesore FIMIF], [Ref_032 Plan Strategjik Njësia Kryesore 2019-2024 FIMIF], [Ref_037 Miratimi i Hapjes se Programit te Studimit Bch.IF] [Ref_038 Rregullore e Programit te Studimit Bch.IF], [Ref_040-042 Plani Mesimor Bch.IF 21-24]. Një kopje e dokumentacionit të mësipërm gjendet edhe në njësinë bazë. Ndarja e lëndëve/moduleve sipas veprimtarive formuese është bazuar dhe ka respektuar kërkesat e VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të

	Lartë", e ndryshuar.
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Programi i studimit e përmban planin mësimor, i cili jep informacion bazë rreth lëndëve që zhvillohen dhe strukturës së tyre. Ai buron nga kurrikula e programit të studimit dhe pasqyron periudhën kohore të zhvillimit të secilit prej moduleve të programit të studimit në vitin akademik. Plani mësimor rifreskohet çdo vit dhe reflekton ndryshimet respektive [Ref_040-042 Plani Mesimor Bch.IF 21-24]. Në planin mësimor të programit të studimit dhe në programet e lëndëve paraqiten të dhëna të detajuara lidhur me emërtimin e moduleve të grupuara dhe të renditura në semestra, numrin e krediteve për çdo modul dhe raportin e orëve (leksione seminare, laboratorë), detyrimet sipas moduleve (seminare, detyra kursi, projekte, laboratorë, praktikë) dhe mënyrën e kontrollit të dijeve të çdo moduli. Ndarja e orëve mësimore në auditor në orë për leksione, seminare, ushtrime e laboratorë për çdo disiplinë, përcaktohet në planin mësimor të programit të studimit, në bazë të krediteve të secilit komponent mësimor dhe orëve që i alokohen çdo krediti, të miratuar nga Senati Akademik i UPT-së [Ref_002 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT]. Programet e lëndëve janë përshtatur në përputhje me VKM Nr. 41, datë 24.1.2018, e ndryshuar duke pasqyruar të gjithë elementët që parashikohen në shtojcën e këtij vendimi [Ref_044 Programet Lendore (Syllabuse) Bachelor IF 21-22].
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Rregulloreja e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies në UPT (neni 19) jep informacioni mbi kriteret e përgjithsme të pranimit të studentëve në ciklin e parë të studimeve [Ref_002 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT]. Ndërsa Kreu VI-të i kësaj rregullore përmban gjithë informacionet e nevojshme lidhur me transferimet, njohjen e krediteve dhe ekuivalentimin e lëndëve. Nenet 9, 10 dhe 11 të Rregullores së programit të studimit Bachelor në Inxhinierinë Fizike përmbajnë edhe kriteret specifike për kriteret e pranimit dhe regjistrimit në këtë program, si edhe kuotat e pranimit. [Ref_038 Rregullore e Programit të Studimit Bch.IF], [Ref_065 Miratimi i Kuotave të Pranimit të Studenteve 2023-2024], [Ref_088 Raporti i Verifikimit të Kapaciteteve Pritese për Kuotat 22-23].
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të	Dosja e plotë e programit të studimit përmban informacionet e nevojshme për programet e secilës lëndë: leksionet, praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara [Ref_040-042 Plani Mesimor Bch.IF 21-24], [Ref_044-046 Programet Lendore(Syllabuse) Bachelor IF 21-24]. Programet lëndore

gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	janë në përputhje të plotë me VKM nr. 41, elementet sipas përcaktimeve në Aneksat e RVB [Ref_VI. ANEKS_Tabelat permbledhese per RVB_Bch.IF, Tabelat 1-24, Tabela 14]. Programet e lëndëve përmbajnë (në formë të përmbledhur): të dhënat e përgjithshme për lëndën (viti akademik, njësia bazë përgjegjëse për zhvillimin e lëndës, struktura e lëndës sipas ndarjeve të bëra në planin mësimor, emri i titullarit të lëndës dhe i stafit mësimdhënës), njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti, rezultatet e të nxënit, njohuritë dhe aftësitë që përfton studenti nga përvetësimi i lëndës, konceptet dhe termat bazë mbi të cilat ndërtohet lënda, forma e kontrollit që do të përdoret, parakushtet e hyrjes në provim, mënyra e vlerësimit përfundimtar, literatura bazë dhe ajo ndihmëse. Përmbajtja e lëndës është e ndarë në leksione dhe ushtrime/seminare, e detajuar në tematika që zhvillohen sipas javëve mësimore; po kështu jepet përmbajtja e punëve laboratorike, praktikave lëndore, temat e detyrave/projekteve të kursit.			
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	Në fillim të çdo viti akademik personeli akademik motivohet për të propozuar ndryshime në program sipas hapësirave dhe afateve të lejuara nga rregullorja e FIMIF. Procedurat e rishikimit të programit të studimit në masën jo më shumë se 20% jepen të detajuara në Nenin 16 të Rregullores së Zhvillimit Kurrikular të UPT [Ref_002 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT]. Plani mësimor hartohet/rishikohet nga KPS-ja, miratohet paraprakisht nga departamenti, kontrollohet dhe miratohet nga dekanati i njësisë kryesore, vlerësohet për plotësimin e standardeve nga Drejtoria e Kurrikulave dhe miratohet nga SAUPT para fillimit të vitit përkatës akademik [Ref_043 Miratim KPS per Ndryshim te Planit Mesimor_Bch. IF 2022-2023], [Ref_VI. ANEKS_Tabelat permbledhese per RVB_Bch.IF, Tabela 11].			
Konkluzione	GVJ konkludon se: FIMF dhe DIF disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit. Ai përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve, për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara. Përmbajtja e tij është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4	
Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënës dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Emërtimi i programit të studimit Bachelor në Inxhinierinë Fizike është unik në vendin tonë. Ky program ofrohet vetëm nga DIF/FIMIF në Universitetin Politeknik të Tiranës, i përshtatur nga programe analoge të Universitetit të Milanos dhe atij të Torinos. Përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe e praktikave janë të tilla që ofrojnë njohuri bashkëkohore për studentët dhe mundësojnë marrjen e njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme si dhe punësimin [Ref_038 Rregullore e Programit të Studimit Bch.IF], [Ref_092 Sondazhe mbi Tregun e Punës dhe Kompanitë UPT]. Emërtimi i lëndëve që përmban ky program studimi, kategorizimi dhe shpërndarja e lëndëve dhe zhvillimi i praktikave që e shoqërojnë atë, janë të tilla që u mundësojnë studentëve të këtij programi studimi marrjen e njohurive dhe aftësive në fushën e inxhinierisë fizike. Ndërthurja e njohurive teorike (leksione, etj) me ato praktike (ushtrime, laboratore, praktika mësimore, etj) ofron një bazë të detajuar në Fizikën e aplikuar [Ref_040-042 Planit Mesimor Bch.IF 2021-2024], [Ref_044-046 Programet Lendore (Syllabuse) Bachelor IF 2021-2024] dhe i jep të diplomuarit në Inxhinierinë Fizike kompetenca profesionale të domosdoshme për vazhdimin e studimeve në programet e studimit të ciklit të dytë. Diploma Bachelor në Inxhinierinë Fizike nuk jep mundësi për të ushtruar një profesion të rregulluar në fushën e Fizikës apo në fusha të përafërta me të, por synon t'u ofrojë studentëve perspektiva të mira për integrimin në industri.
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënës.	Duke qenë i fushës së inxhinierisë, programi i studimit synon të mundësojë aplikimin në praktikë nga studenti të njohurive të fituara në kurset teorike. Kjo realizohet nëpërmjet seancave të ushtrimeve, laboratorëve, detyrave dhe projekteve, praktikave lëndore dhe ato profesionale, si dhe provimit të formimit. Ndarja e krediteve të lëndëve sipas aktiviteteve formuese të saj (leksione, ushtrime, laboratore, detyra&projekte, praktika) bën të mundur ruajtjen e përpjesëtimeve të drejta ndërmjet aktiviteteve teorike dhe aktiviteteve praktike [Ref_002 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT, Neni 7]. Programi i studimit në Inxhinierinë Fizike ka objektiva të shprehura qartë, në funksion të përvetësimit të dijeve dhe formimit të kompetencave profesionale të studentëve që lidhen me programin [Ref_044-046 Programet Lendore (Syllabuse) Bachelor IF 2021-2024]. Objektivi

	kryesor i tij është t'u japë studentëve njohuri shkencore themelore në fushën e inxhinierisë dhe më specifike në atë të Inxhinierisë Fizike. Shpërndarja e lëndëve është bërë e tillë që lëndët, njohuritë, aftësitë dhe shrehitë që fitohen të jenë në vijimësi të njëra tjetrës. [Ref_040-042 Plani Mesimor Bch.IF 2021-2024], [Ref_044-046 Programet Lendore (Syllabuse) Bachelor IF 2021-2024]. Në pjesën më të madhe të lëndëve inxhinierike aplikohen detyra kursi, laboratore të cilat synojnë të zhvillojnë aftësitë komunikuese të studentëve dhe nxisin që ata të përvetësojnë procesin e kërkimit dhe të aftësimit profesional. Ndërtimi i planit mësimor është bërë duke respektuar piramidën e dijeve, pra disiplinat paraardhëse të shërbejnë si bazë për marrjen e njohurive në disiplinën pasardhëse. Disiplinat në planin mësimor, sasia e krediteve dhe e orëve të vëna në dispozicion për secilën prej tyre bëjnë të mundur që në përfundim të programit të studimit të jenë arritur objektivat formuese të këtij programi të studimit dhe rezultatet e të nxënit.
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	Programi i studimit Bachelor në Inxhinierinë Fizike është mbështetur kryesisht në modelet e universiteteve teknike italiane dhe specifikisht Politeknikut të Milanos dhe Torinos. Programi i studimit Bsc. në Inxhinierinë Fizike, në strukturën e tij është në përputhje të plotë me VKM Nr 41. datë 24.01.2018, "Për elementët e programit të studimit", ku pësha dhe ngarkesa e veprimtarive formuese, e shprehur në kredite është në përputhje të plotë me veprimtaritë formuese të parashikuara për programet e studimit të ciklit të parë, të parsqyruara në shtojcën Nr 1, të kësaj VKM-je [Ref_040-042 Plani Mesimor Bch.IF 2021-2024], [Ref_044-046 Programet Lendore (Syllabuse) Bachelor IF 2021-2024].
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Në programin e studimit Bsc. në Inxhinierinë Fizike, ndarja sipas veprimtarive formuese është në përputhje të plotë me (VKM Nr 41. datë 24.01.2018, "Për elementët e programit të studimit". Ndarja e veprimtarive formuese e cila jepet e detajuar në planin mësimor [Ref_040-042 Plani Mesimor Bch.IF 2021-2024], [Ref_044-046 Programet Lendore (Syllabuse) Bachelor IF 2021-2024] dhe e përcaktuar në programet e lëndëve dhe moduleve dhe një raport teori – praktikë në vlerat 50:50 krijojnë mundësinë për një formim të plotë të studentëve, sipas drejtimit dhe profilizimit dhe objektivave formues të programit, gjë e cila u mundëson atyre transferimin e studimeve në institucione të tjera. Ngjashmëria midis këtij programi studimi dhe programeve të tjera jashtë vendit mundësojnë transferimin e studimeve dhe mobilitetin e punësim të studentëve. Tregues i transferimit të studimeve drejt programit të studimit Bachelor në Inxhinierinë Fizike dhe punësimit në përfundim të studimeve, janë numri i transferimeve në këtë program [Ref_VI.ANEKS_Tabelat permbledhese per RVB Bch.IF, Tabela 21] dhe numri i të punësuarve në përputhje me diplomën

	<i>[Ref_VI.ANEKS_Tabelat permbledhese per RVB Bch.IF, Tabel 23], [Ref_087 Database Alumni te Diplomuarit ne IF (2021-2023)], [Ref_110 Databaza Alumni UPT].</i>
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	Programet e lëndëve/modulet e programit të studimit përditësohen vazhdimisht në departament nga titullarët e lëndës përkatëse, të cilët në fillim të viti të ri akademik paraqesin DIF programin e lëndës të përditësuar për atë vit akademik. Programet e lëndëve përmbajnë literaturën bazë dhe atë ndihmëse të rekomanduar për studentët. Literatura bazë e rekomanduar është e aksesueshme nga studenti në librari, bibliotekë apo në njësinë bazë, në formën e shtypur apo në format elektronik. Bazohet në literaturën më të re të detyruar dhe ndihmëse, shumica nga 5 vitet e fundit <i>[Ref_002 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT], [Ref_040-042 Plani Mesimor Bch.IF 2021-2024], [Ref_044-046 Programet Lendore (Syllabuse) Bachelor IF 2021-2024].</i> Një ndër burimet e marrjes dhe shfrytëzimit të literaturës më të fundit është Biblioteka Shkencore e UPT dhe ajo e FIMIF. Gjithashtu stafi dhe departamentet kërkojnë në buxhetin e FIMIF të blejnë literaturën përkatëse të lëndëve të tyre. UPT ka edhe bibliotekën elektronike, e cila ofron informacion shumë të vlefshëm për stafin akademik. Edhe eksperiencat dhe bashkëpunimet ndërkombëtare, si dhe mobilitet e stafit akademik të FIMIF, në kuadrin e projekteve ndërkombëtare, kanë ndikuar në pasurimin dhe përmirësimin e programeve të lëndëve <i>[Ref_025 Rregullore Buletini i Shkencave Teknike UPT], [Ref_026 Rregullore e Bibliotekës Shkencore UPT], [Ref_027 Informacion mbi Bibliotekat në UPT], [Ref_077 Biblioteka e FIMIF], [Ref_078 Biblioteka online COBISS FIMIF], [Ref_106 Shkëmbimet e literaturës 2017-2020 UPT], [Ref_123 Bibliotekat në UPT ne sherbim te FIMIF].</i>
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Programi i studimit Bachelor në Inxhinierinë Fizike transmeton tek studentët njohuri themelore të sektorëve të ndryshëm të Fizikës së Zbatuar. Në përfundim të programit të studimit inxhinieri i ardhshëm ka marrë njohuri bazë për: metodologjitë moderne të fizikës së zbatuar, zgjidhjen e problemeve të projektimit dhe administrimit, teknologjinë e paisjeve lazer dhe të fibrave optikë, përdorimin e teknologjisë kompjuterike, zbatimin e projekteve të ndryshme inxhinierike, mirëmbajtjen dhe kontrollin e asistuar të sistemeve inxhinierike, optikën inxhinierike, fotonike, teknologjinë e matjeve të rrezatimeve optike, të temperaturës, të emisioneve akustike etj. Njohuritë bazë teorike dhe zbatimet praktike ndërthuren mjaft mirë në programin e studimit Bachelor në Inxhinierinë Fizike.
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson	Programi i studimit Bachelor në Inxhinierinë Fizike ndiqet nga dy programe të studimit në nivelin Master i Shkencave në fushën e inxhinierisë fizike, konkretisht Master i Shkencave në Inxhinierinë Fizike,

vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	profili Inxhinier Fizike, Master i Shkencave në Inxhinierinë Fizike, Profili Fizikan Mjekësor Gjithashtu studentë të diplomuar nga ky program kanë ndjekur me sukses studimet në Master Shkencor në Fizikë në UT apo edhe jashtë shtetit. Gjithmonë synohet t'u ofrohet studentëve perspektiva më të mira lidhur me përshtatjen, fleksibilitetin dhe integrimin në tregun e punës [Ref_092 Sondazhe mbi Tregun e Punës dhe Kompanitë UPT]. Një inxhinier fizikan merret me aplikimin dhe përdorimin e energjisë së rinovueshme, përdor pajisjet lazer dhe ato me fibra optike, ka aftësi në përdorimin e pajisjeve të avancuara në spitale dhe laboratorët e klinikave për kryerjen e analizave dhe diagnostikimit mjekësor. Një Inxhinier Fizikan hulumton në fushën e kërkim-zhvillimit teknologjik për optikën inxhinierike, fotonikën, optoelektronikën, nanofotonikën, lazera, shkenca e materialeve. Ai është i aftë në aplikimin e metodave moderne të matjes së rrezatimeve optike, të matjes së emisioneve akustike, të përdorimit të ultratingujve për qëllime industriale dhe mjekësore etj.			
Konkluzione	GVJ nga vizita në institucion dhe shqyrtimi i evidencave të sipërpërmenduar konkludon se: Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Ndaj sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve. Programet e lëndëve /moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara. dhe mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve apo punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Programi i studimit në Inxhinierinë Fizike çdo vit i nënshtrohet një analize mësimore dhe shkencore, e cila shqyrton ecurinë dhe zbatimin e programit si dhe çështje të tjera që lidhen me ecurinë e mëtejshme të studentëve [Ref_060 <i>Analiza Vjetore e Punës Kërkimore-Shkencore 2021-2022 DIF</i>], [Ref_061 <i>Analiza Vjetore e Punës Mesimore 2021-2022 DIF</i>]. Në mënyrë të vazhdueshme organizohen takime të stafit akademik me drejtues të sipërmarrjeve në fushat inxhinierike në optikën inxhinierike, fotonikën, optoelektronikën, nanofotonikën, lazerë, shkenca e materialeve, pyetësorë me ish-studentë të punësuar, etj. Aty merren propozime për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës. [Ref_092 <i>Sondazhe mbi Tregun e Punës dhe Kompanitë UPT</i>].
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	UPT ka një traditë institucionale të komunikimit të pandërprerë me punëmarrësit në tregun kombëtar dhe ndërkombëtar [Ref_010 <i>Marrëveshjet Institucionale UPT</i>]. Rregullorja e UPT nxit e garanton përfshirjen e studentëve në vendimmarrje. Studentët vlerësojnë procesin akademik përmes plotësimit të pyetësorëve drejtuar studentëve [Ref_023 <i>Anketimi Studentor-Pyetësori dhe Raporti UPT</i>], [Ref_024 <i>Plan Veprimi mbi Problematikat e Anketimeve Studentore UPT</i>], [Ref_067 <i>Organizimi i Pyetësorit Studentor FIMIF 22-23</i>]. I gjithë ky proces i realizuar nga Drejtoria e Kurrikulës dhe Standarteve të Cilësisë dhe Studentëve, ndihmon institucionin të përmirësojë cilësinë. Në zbatim të legjislacionit në fuqi FIMF ka ngritur dhe ka funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë, që përfshin studentët dhe bashkëpunëtorë ekspertë të jashtëm (për GVB) [Ref_083-085 <i>Raportimi vjetor 2021-2024 NJSBC FIMIF</i>]. UPT/FIMIF mban kontakte të vazhdueshme me studentët e diplomuar, konsultohet me ta rreth problematikave të programit të studimit, përmirësimit të kurrikulave, për të ndihmuar Departamentin e Inxhinierisë Fizike në përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, të lidhjes së formimit teorik me atë praktik, duke iu referuar edhe eksperiencave të fituara tashmë në punë prej tyre. Informacioni e lidhja me studentët e diplomuar merret përmes pyetësorëve, por edhe takimeve, konferencave, mbajtjes së lidhjeve të vazhdueshme me Alumni të këtij fakulteti e programi studimi.
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesion-	FIMIF mban bashkëpunim me institucionet partnere. Prioritet i jepet bashkëpunimit me universitete të tjera, OJF, administratën publike dhe institucione të tjera. DIF, në zbatim të marrëveshjeve me institucione publike e private, përmirëson, përditëson programin e studimit në përputhje me kërkesat e nevojat e tregut, në përputhje me kërkesat e institucioneve publike dhe private, duke përfshirë përfaqësues të tyre në mësimdhënie, në leksione të hapura sipas fushës së studimit të këtij program. [Ref_009 <i>Marrëveshje me Akademinë e Shkencave UPT</i>],

istësh, shoqata, urdhra profesionale (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	[Ref_010 Marrëveshjet Institucionale UPT], [Ref_011 Marrëveshjet me Industrinë dhe Institucione UPT], [Ref_062 Marrëveshje Bashkëpunimi me CERN].			
Konkluzione	GVJ bazuar në takimet në institucion dhe shqyrtimi i DVV konkudon se: Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës. UPT nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit. FIMF/DIF përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata dhe institucione publike e private.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënës, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikatat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarat, punët laboratorike, detyrat e kursit/etsetë, projektet, praktikatat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve studenteve të PS Bachelor në Inxhinierinë Fizike janë leksionet, seminarat, punët laboratorike, detyrat (ushtrime, detyra e kursit dhe projektet), dhe praktikatat mesimore etj., të detajuara në planin mësimor dhe programet e lëndëve. Këto dokumente hartohen dhe miratohen duke u mbështetur në aktet nënligjore përkatëse (VKM Nr. 41, datë 24.1.2018) si dhe Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular dhe Mesimdhënies në UPT, Neni 25/[Ref_002 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT]. Ato harmonizohen midis tyre [Ref_040-042 Plani Mesimor Bch IF 21-24], [Ref_044-046

	Programet Lendore (Syllabuse) Bachelor IF 21-24] siç parashikohet në rregulloren mësimore të programit të studimit [Ref_038 Rregullore e Programit të Studimit Bch.IF]. Senati Akademik i UPT-së, miraton në fund të çdo viti akademik, planet mësimore të çdo programi studimi, të kërkuar nga njësitë kryesore të UPT-së, deri në masën 20% [Ref_043 Miratim KPS per Ndryshim te Planit Mesimor_Bch. IF 2022-2023].
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Personeli akademik respekton dhe i përgjigjet në vijimësi diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit Inxhinierinë Fizike në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti. Përdorimi i këyre metodave synon të lehtësojë të kuptuarit, të përmirësojë angazhimin dhe të nxisë mendimin kritik të studentëve. Është aplikuar edhe “e-Learning” duke shfrytëzuar teknologjinë elektronike si kompjuter, pajisje mobile, etj. Kështu arrihet personalizimi i mësimi për studentët. Studentit i vihen në dispozicion versionet elektronike të prezantimeve të leksioneve në power-point, linke të ndryshme me pjese eksperimentale, teste përgatitore, forume, etj [Ref_071 Prezantim Leksioni në Power Point]. Shumica e moduleve të programit, sidomos ato profesionale, përmbajnë detyrime për përgatitjen e detyrave të kursit në grup, apo të relacioneve të puneve të laboratorit, të cilat i aftësojnë studentët për përthithjen dhe zbatimin e informacionit teorik si dhe aftësinë e të punuarit në grup.
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.	UPT mbështet vazhdimisht personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike; kjo dëshmohet edhe nga marrëveshjet e shumta të bashkëpunimit të nënshkruara me institucionet homologe brenda dhe jashtë vendit [Ref_010 Marrëveshjet Institucionale UPT], [Ref_011 Marrëveshjet me Industrinë dhe Institucione UPT]. Objekti kryesor i këtyre marrëveshjeve përfshin: shkëmbimin e personelit akademik për procesin mësimor dhe veprimtari kërkimore; nxitjen dhe realizimin e projekteve të përbashkëta kërkimore-shkencore; organizimin e konferencave, trajnimeve, seminareve, etj.; shkëmbimin e materialeve akademike dhe literaturës shkencore. FIMIF mbështet financiarisht kualifikimin në universitete homologe europiane me qëllim përmirësimin e aftësive didaktike dhe shkencore. UPT i ofron personelit akademik burime dhe hapësira për të eksperimentuar me teknika të reja dhe metodologji të ndryshme mësimdhënieje. Një pjesë e auditorëve mësimore janë pajisur me projektorë. Gjithashtu në dispozicion të stafit akademik dhe studentëve janë dhe laboratorët që disponon FIMIF [Ref_079 Labororet në FIMIF dhe Departamentet e saj], [Ref_080 Model_Relacion_Pune Laboratori_Hyrje IF], [Ref_100 Evidenca mbi laboratorët në UPT].

Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie në Inxhinierinë Fizike është i kualifikuar sipas profilit të lëndës që zhvillon, i përket kategorisë Profesor, Lektor dhe asistent-lektor, si dhe ka një angazhim të konsiderueshëm në punën kërkimore shkencore [Ref_VI. ANEKS Tabelat përmbledhëse për RVB Bch IF], [Ref_047 Lista e Personelit Akademik të Angazhuar në Bch. IF], [Ref_048 CV e Personelit Akademik të Angazhuar në Programin Bch. IF], [Ref_049 CV e Personelit Akademik dhe Ndihmës Akademik DIF]. Njësia bazë planifikon ngarkesën mësimore mbështetur në shkallën e kualifikimit, të eksperiencës dhe fushën e kompetencës të çdo anëtarit të personelit akademik [Ref_002 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT, Neni 26]. Punësimi i personelit akademik efektiv apo me kontratë bëhet konform Ligjit Nr 80/2015, Neni 64, pika 1, Neni 57, pika 2, si dhe procedurave përkatëse për rekrutimin e stafit akademik [Ref_019 Procedura Punësimi Staf Akademik dhe Administrativ në UPT], [Ref_072 Procedura e Punësimit në FIMIF-DIF], [Ref_055 Model Rekrutimi Staf Akademik_PAE], [Ref_056 Model Rekrutimi Staf Ndihmës Akademik], [Ref_057 Model Rekrutimi Staf Akademik PAK]. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie zhvillon ushtrime, punë laboratorie dhe kursa që nxisin studentët të pyesin, të kërkojnë zgjidhje alternative, dhe të vlerësojnë në mënyrë kritike informacionin. Në ushtrime zgjidhen shembuj të përshtatshëm që nxisin mendimin analitik. Diskutimi, rrahja e mendimeve, debati përdoren gjerësisht si mënyra të mësimdhënies. Bisedat me studentët konturuar në mjedis mësimor që promovon respektin dhe mirëkuptimin ndërmjet studentëve dhe mësimdhënësve. Edhe në rastet kur ishin shfaqur probleme të komunikimit mes pedagogëve dhe studentëve, ndërhyrja e departamentit dhe dekanatit kishte qenë e menjëhershme dhe efektive. Studentët u shprehën se ndihën të lirshëm t'i kontaktojnë pedagogët në adresën e tyre elektronike dhe se merrnin përgjigje në kohë. Këto forma dhe metoda të mësimdhënies, mbështetur në këto mënyra komunimi, ndihmojnë në ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes pedagogëve dhe studentëve.
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.	Pedagogët diskutojnë me studentët në lidhje me elementë të veçantë të paraqitjes së materialit dhe të përmirësimeve eventuale për metodat e mësimdhënies [Ref_053 Procedurë Konsultimi për Provimin e Diplomës në Bch. IF], [Ref_054 Udhëzues për Provimin e Formimit Final Bch. IF]. Çdo fund semestri DSBC organizon pyetësorë me studentët dhe vlerësimet dhe sugjerimet e marra pasqyrohen në vazhdimësi. Edhe titullari i lëndës dhe stafi mësimdhënës, në përfundim të procesit mësimor, japin mendime në lidhje me zhvillimin e lëndës. Sjellim shembullin e ndryshimit të krediteve të lëndës “Algjeber” nga

	6 në 8 ECTS bazuar në mendimin e studenteve [Ref_043 Miratim KPS per Ndryshim te Planit Mesimor Bch. IF 2022-2023], [Ref_002 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT, Neni 13], [Ref_023 Anketimi Studentor Pyetësori dhe Raporti UPT], [Ref_067 Organizimi i Pyetësorit Studentor FIMIF 22-23], [Ref_086 Alumni Pyetësor Zyra e Karrierës FIMIF], [Ref_087 Databazë Alumni të Diplomuarit në IF (2021-2023)], [Ref_110 Databaza Alumni UPT]. Gjithashtu në fund të çdo viti akademik stafi akademik efektiv bën raportin e punës së tij mësimore ku analizojnë ndër të tjera format e mësimdhënies dhe prezanton përmirësimet e mundshme [Ref_060 Analiza Vjetore e Punës Kërkimore DIF], [Ref_061 Analiza Vjetore e Punës Mësimore DIF].
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	Përmirësimi i cilësisë së arsimit në Universitetin Politeknik të Tiranës ndërtohet mbi themelin e fortë të ngritjes së strukturave të nevojshme për të garantuar cilësinë, siç janë Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë [http://upt.al/cilesia-ne-upt] dhe Drejtoria e Kurrikulave [http://upt.al/dega-mesimore]. Këto entitete mbajnë përgjegjësi të drejtpërdrejtë për ndjekjen e kriterëve të hartimit të programeve dhe syllabuseve mësimore, si dhe për menaxhimin e gjithë dokumentacionit të nevojshëm për programet e studimit. Shtylla kryesore e përmirësimit përfshin ngritjen e nivelit të stafit akademik, zhvillimin e infrastrukturës për laboratorë dhe mësimdhënie, dhe sofistikimin e metodave të mësimdhënies, të cilat të gjitha vlerësohen rregullisht nga njësitë bazë dhe studentët [Ref_007 Organigrama e UPT]. DSBC bashkëpunon me dekanët, drejtorët e instituteve, drejtuesit e programeve të studimit, përgjegjësit e departamenteve dhe organizatat studentore të UPT. Detyrat dhe funksionet kryesore të DSBC përcaktohen në Nenin 78 & 79 të Statutit të UPT [Ref_001 Statuti i UPT], [Ref_003 Kodi i Etikës i UPT], [Ref_004 Plani Strategjik 2019-2024 UPT]. Drejtoria e Kurrikulave koordinon, monitoron aktivitetin për hartimin, riorganizimin, rishikimin dhe mbylljen e programeve të studimit, koordinon dhe monitoron zhvillimin e programeve mësimore duke u mbështetur në Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular të UPT-së, koordinon punën me Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë për çështjet mësimore dhe të administrimit të kurrikulës në UPT, koordinon dhe monitoron procesin e pranimeve në të tre ciklet e studimit që ofrohen në UPT, administron kërkesat për verifikime që vijnë nga institucione brenda dhe jashtë vendit, publike dhe/ose private, duke mbajtur një databazë të rregullt për të gjithë ish- studentët e UPT-së. [Ref_002 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT]. Stafi akademik në FIMIF ka autonomi të plotë në hartimin e syllabuseve të lëndëve duke u inkurajuar të implementojnë vazhdimisht

	metodologji të reja mësidhënie të cilat përmirësojnë cilësinë e saj [Ref_040-042 <i>Plani Mësimor Bch.IF 21-24</i>], [Ref_044-046 <i>Programet Lëndore (Syllabuse) Bachelor IF 21-24</i>]. UPT është i angazhuar në ndërtimin dhe aplikimin e strategjive për nxitjen dhe përforcimin e një kulture të lartë cilësore në të gjitha njësitë dhe të gjitha nivelet, duke përfshirë zhvillimin e metodave për vëzhgimin dhe përshtatjen e standardeve akademike dhe përmirësimin e qeverisjes dhe administrimit të institucionit. Kjo është përcaktuar në Planin Strategjik 2019-2024 të UPT [Ref_004 <i>Plani Strategjik 2019-2024 UPT</i>]. FIMIF përqendrohet në zgjerimin e kapaciteteve të tij akademike dhe laboratorike, duke promovuar një atmosferë të mësimit inovativ dhe bashkëpunimin në hulumtime shkencore me partnerë ndërkombëtarë. Kjo theksohet në dokumentin strategjik të FIMIF [Ref_032 <i>Plani Strategjik Njësia Kryesore 2019-2024 FIMIF</i>].			
Konkluzione	<i>Nga vizita në institucion dhe shqyrtimi i dosjes së vetëvlerësimit, GVJ konkludon se: Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit, projektet, praktikat profesionale, orët e hapura, etj. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies. UPT mbështet personelin akademik në përmirësimin e aftësive didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë FIMF/DIF siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre. UPT organizon Drejtorinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe atë të Kurrikulave, të cilat promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies, si edhe mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimin e metodave të reja.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2 Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Mënyra e kontrollit dhe vlerësimit të dijeve në FIMIF kodifikohet në dokumentin "Procedura e kontrollit dhe vlerësimit të dijeve në UPT-FIMIF", e dokumentuar në <i>[Ref_002 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT]</i> dhe në <i>[Ref_044-046 Programet Lëndore (Syllabuse) Bachelor IF 21-24]</i> . Kjo procedurë synon të vendosë rregulla të unifikuara dhe të qarta për kryerjen e kontrollit të dijeve, që ky i fundit të çojë në një vlerësim të drejtë dhe objektiv të performancës së studentit. Kjo rregullore është e disponueshme për të gjithë studentët dhe e aksesueshme në faqen zyrtare të fakultetit: https://fimif.edu.al/ . Nga bisedat me studentët rezulton se ajo njihet nga ata.
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Në fillim të çdo lënde/moduli studentët njihen me programin e lëndës/modulit, i cili përmban të detajuara metodat që do të përdoren për testimin dhe vlerësimin e njohurive, si dhe të aftësive profesionale dhe shkencore, në përputhje të plotë me rregulloret e UPT, FIMIF, dhe ato specifike të programit të studimit. <i>[Ref_040-042 Plani Mësimor Bch. IF 21-24]</i> , <i>[Ref_044-046 Programet Lëndore (Syllabuse) Bachelor IF 21-24]</i> . Kriteret specifike për vlerësimin vendosen nga titullari i lëndës/modulit.
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Përveç provimit përfundimtar dhe përpara tij përdoren disa forma të vlerësimitit të vazhdueshëm, si: detyra kursi, projekte kursi, relacionet e punëve të laboratorit, apo kontrole të pjesshme (kolokuiume). Para provimit studentët informohen mbi numrin e pikëve të grumbulluara gjatë vitit, si edhe kriteret për vlerësimin përfundimtar. Provimi i një lënde mund të jetë me shkrim, me gojë ose një kombinim i të dyjave, bazuar në programin mësimor të lëndës, i cili i është dhënë studentit që në fillim të lëndës/modulit. <i>[Ref_008 Guida studentore UPT]</i> , <i>[Ref_034 Rregullore Njësia Bazë DIF]</i> , <i>[Ref_030 Historiku i krijimit të FIMIF]</i> , <i>[Ref_031 Rregullore Njësia Kryesore FIMIF]</i> , <i>[Ref_040-042 Plani Mësimor Bch. IF 21-24]</i> , <i>[Ref_044-046 Programet Lëndore (Syllabuse) Bachelor IF 21-24]</i> .
Kriteri 4. Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë	Studentët kanë mundësinë të vlerësojnë format e mësimdhënies, duke dhënë edhe sugjerime për përmirësimin e tyre, që në klasë. Kjo qasje e drejtpërdrejtë dhe interaktive është theksuar në "Udhëzuesin për provimin e formimit në DIF" <i>[Ref_053 Procedure Konsultimi per Provimin e Diplomës në Bch. IF]</i> , <i>[Ref_054 Udhëzues për Provimin e</i>

periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Formimit Final Bch. IF]. Ky proces vijon me pyetësorët që zhvillohen nga DSBC në fund të çdo semestri, rezultatet e të cilëve analizohen me kujdes dhe përdoren për të ndërmarrë veprime që synojnë përmirësimin e vazhdueshëm të procesit mësimor. [Ref_002 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT, Neni 13] dhe në dokumente si [Ref_023 Anketimi Studentor Pyetësori dhe Raporti_UPT], [Ref_067 Organizimi i Pyetësorit Studentor FIMIF 22-23], [Ref_086 Alumni Pyetësori Zyra e Karrierës FIMIF], [Ref_087 Database_Alumni te Diplomuarit në IF (2021-2023)], [Ref_110 Databaza Alumni UPT]. Në fund të vitit akademik stafi akademik paraqet raporte të detajuara mbi aktivitetin e tyre mësimor, të cilat përfshijnë një analizë të metodave të mësimdhënies të përdorura dhe sugjerime për përmirësime në të ardhmen. [Ref_060 Analiza Vjetore e Punës Kerkimore-Shkencore 2021-2022_DIF], [Ref_061 Analiza Vjetore e Punës Mësimore 2021-2022_DIF]. Kështu garantohet roli aktiv i studentëve në procesin e mësimdhënies/nxënies.
Kriteri 5. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënësve, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënies të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Në Fakultet pamë mjete audiovizive (si projektorët) të instaluar në shumë prej auditorëve. Kjo ndihmon përçimin e njohurive në mënyrë interaktive dhe më efektive. Kjo shoqërohet me një numër laboratorësh, të cilët i ofrojnë studentit mundësinë të përvetësojë njohuritë duke i praktikuar ato. [Ref_079 Labororet në FIMIF dhe Departamentet e saj], [Ref_080 Model_Relacion_Punë Laboratori_Hyrje IF], [Ref_100 Evidenca mbi laboratorët në UPT]. Detyrat dhe projektet e kursit, praktika në industri dhe prezantimet e studentëve nxitin autonominë dhe mendimin krijues të studentit. Për tërealizuar këto komponente, studenti duhet të kërkojë në mënyrë të pavarur literaturë shtesë dhe të punojë si individualisht ashtu edhe në grupe. Pedagogët ofrojnë udhëzime të vazhdueshme dhe mbështetje përmes komunikimit të drejtpërdrejtë gjatë orëve të mësimit, orarit të caktuar për takime, konsultimeve të rregullta, si dhe nëpërmjet komunikimit elektronik përmes emailit zyrtar (emër.mbiemër@fimif.edu.al). Kështu krijohet një klimë respekti dhe bashkëpunimi mes pedagogëve dhe studentëve
Konkluzione	GVJ konkludon se: Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e zhvillimit kurrikular të UPT dhe programet e lëndëve dhe bëhen publike dhe njihen nga studentët. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara. FIMF/DIF dhe personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre. Ata mundësojnë përdorimin e metodave të

	shumëllojshme pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënësve, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3	
Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Programet e lëndëve përcaktojnëqartë peshat relative të provimit përfundimtar, provimeve të ndërmjetme apo detyrave të kursit, projekteve të kursit e formave të tjera të vlerësimit të vazhduar (si p.sh. relacionet e punëve të laboratorit apo nivelin e kërkuar të frekuentimit dhe tëplotësimit të detyrimeve) në vlerësimin përfundimtar. Këto programe hartohen nga titullarët e lëndëve në përputhje me rregulloret përkatëse dhe vihen në dispozicion të studentëve në fillim të procesit mësimor. <i>[Ref_034 Rregullore Njësia Bazë DIF], [Ref_040-042 Plani Mësimor Bch.IF 21-24], [Ref_044-046 Programet Lëndore (Syllabuse) Bachelor IF 21-24].</i> Kjo garanton dijeni të plotë të studentëve lidhur me atë çka pritët prej tyre. Në fund të semestrit, para provimit, studentit i bëhen me dije pikët e grumbulluara nga format e kontrollit të vazhdueshëm, të cilat se bashku me piket e grumbulluar në provimin përfundimtar rezultojnë në vlerësimin përfundimtar të studentit.
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	UPT nuk disponon një sistem elektronik për testim dhe vlerësim të performancës së studentëve, një mjet që gjithsesi nuk është jashtëzakonisht efikas në rastin e fizikës. Përndryshe studentët dëshmojnë se ata kanë të drejtën të shohin fletët e provimit dhe të marrin sqarime nga pedagogu për vlerësimin, si edhe të drejtën e ankimimit. Gjithashtu, përmes platformës elektronike të bit-albania <i>[Ref_076 Aksesimi i Sekretarise Mësimore Online nga Studentët], [Ref_114 Infrastruktura dhe Shërbime IT në FIMIF], [Ref_093 Informimi i Studentëve Nëpërmjet Platformave Online]</i> janë të disponueshme vlerësimet e vazhdueshme dhe ato përfundimtare, duke u ofruar kështu studentëve informacion të menjëhershëm mbi rezultatet e tyre.
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në	Vlerësimi përfundimtar behet mbi bazën e kriterëve të përcaktuara në rregulloren e DIF <i>[Ref_034 Rregullore Njësia Bazë DIF, neni 48].</i>

përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Programet e lëndëve kanë të mirëpërcaktuara mënyrat e vlerësimit të lëndëve. Ato kanë të parashikuara detyra kursi, punë laboratorit dhe kontrole të pjesshme nëpërmjet kolokuiumeve, të cilat vlerësohen me pikë dhe merren në konsideratë në vlerësimin përfundimtar.
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënies për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Duke mbajtur parasysh se procesi i nxënies përfshin edhe provimet e detyrimit, gjatë vlerësimit të elementëve të një lende/moduli si provimi i ndërmjetmë, detyra e kursit, laboratorët ose provimi përfundimtar., pedagogët ofrojnë komente konstruktive me shkrim ose me gojë me qëllim që të ndihmojnë studentin të mësojë dhe të sqarojnë paqartësitë e mudshme. Studentëve u komunikohet nota nga komisioni i vlerësimit brenda një kohe prej jo më shumë se 5 ditësh pune nga data e dhënies së provimit <i>[Ref_002 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT, Neni 34, pika 9]</i> . Para hedhjes së rezultateve në fletën e provimit, komisioni informon studentin për rezultatin e vlerësimit dhe i jep atij mundësinë të kërkojë sqarime. Komisioni vlerësues ka detyrimin t'i ofrojë studentit sqarime të hollësishme, duke ballafaquar përgjigjet e dokumentuara të studentit me tezën e zgjidhur, e duke venë në dukje mangësitë dhe sqaruar studentin. <i>[Ref_002 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT, Neni 35]</i> .
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Rregullorja e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies <i>[Ref_002 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT]</i> , Neni 34, pika 7 përcakton qartë veprimet e ndaluara gjatë zhvillimit të provimit, përfshirë edhe kopjimin në provim. Nuk lejohet mbajtja dhe përdorimi i telefonave celularë apo mjeteve të dyshimta elektronike; mbajtja e tyre në provim rezulton në përjashtimin nga provimi. Më tej drejtuesi i njësisë bazë dhe njësisë kryesore procedojnë në përputhje me Kodin e Etikës së UPT-së <i>[Ref_003 Kodi i Etikës i UPT, Neni 6 dhe Neni 9]</i> . Pedagogët e lëndës/modulit të lëndës dhe anëtarët e komisionit të provimit angazhohen për zbatimin e kësaj rregulloreje dhe të Kodit të Etikës, duke parandaluar veprime si plagjiatura dhe kopjimi në provime dhe detyra. Kur vërejnë raste të tilla, ata marrin masat e veta dhe raportojnë të autoritetet përkatëse për ndëshkimet e duhura, duke kontribuar në një mjedis mësimor të drejtë dhe të ndershëm.
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Kontrolli i dijeve të studentëve në FIMIF, DIF kryhet në përputhje të plotë me udhëzimet e përcaktuara në "Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies" <i>[Ref_002 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT, Neni 34]</i> , si dhe me procedurat specifike të DIF për vlerësimin e dijeve. Studenti gjithmonë merr vlerësimin e lëndës/modulit jo më vonë se 5 (pesë) ditë pune nga data e dhënies së provimit. <i>[Ref_040-042 Plani Mesimor Bch.IF 2021-2024]</i> , <i>[Ref_044-046 Programet Lëndore (Syllabuse) Bachelor IF 2021-2024]</i> . Vonesat në komunikimin e rezultateve të vlerësimit e ngarkojnë

	komisionin e provimit me përgjegjësi për mosrespektim të procedurave. Provimet ruhen nga pedagogu përgjegjës në departament të paktën deri në sesionin e ardhshëm të provimeve. Pedagogët garantojnë që përmbajtja e tezës të jetë brenda programit të lendes/modulit dhe pasqyrojnë në tezë ndarjen e pikëve mes pyetjeve. Në fund teza kontrollohet nga përgjegjësi i departamentit. Gjatë korrigjimit pedagogët vlerësojnë me pikë përgjigjen e secilës prej pyetjeve. Kodi i Etikës i imponon pedagogut të mos kërkojë ose pranojë favore, ndërhyrje, ose dhurata për të favorizuar studentë të caktuar në mënyrë të padrejtë. <i>[Ref_003 Kodi i Etikës i UPT, Neni 5, pika 16]</i>
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Para plotësimit të fletës së provimit, komisioni informon studentët për rezultatin e vlerësimit, duke u dhënë atyre mundësinë të kërkojnë sqarime ose të paraqesin ankesa lidhur me vlerësimin. Studentët kanë mundësinë të kërkojnë sqarime lidhur me korrigjimin e provimit të tyre ose të kundërshtojnë vlerësimin e bërë nga komisioni i provimit, siç përcakton neni 34, pika 10 e Rregullores së Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT <i>[Ref_002 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT, Neni 34, pika 10]</i> Komisioni i vlerësimit është i detyruar të ofrojë shpjegime të hollësishme, krahasojë përgjigjet e studentit me tezen e zgjidhur dhe të adresojë çdo ankesë të tij lidhur me korrigjimin apo vlerësimin përfundimtar.
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankesë, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Nëse ndodh që ka mosdakordësi mes vlerësimit të komisionit dhe studentit, edhe pasi ky i fundit ka marrë sqarime të hollësishme në lidhje me vlerësimin e bërë, ose në rast se ndaj studentit janë shkelur rregullat procedurale gjatë zhvillimit të provimit, studenti ka të drejtë të ankohet duke dorëzuar ankesën në sekretarinë e dekanit brenda tre ditëve pune pas shpalljes të rezultateve, siç përcaktohet në <i>[Ref_002 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT, Neni 35]</i> . Ankesa shqyrtohet nga Dekani dhe Zv. Dekani për veprimtarinë mësimore, të cilët mund të thërrasin për sqarime drejtuesin e departamentit përkatës, komisionin e vlerësimit dhe vetë studentin. Pas gjykimit të çështjes, merret vendim i formës së prerë, brenda tri ditëve pune. Kur ankesa është e drejtë, dekani e shpall të pavlefshëm rezultatin e ankimuar dhe vendos që studenti të rivlerësohet ose të rijapë provimin, me të njëjtin komision, të plotësuar edhe me anëtarë të tjerë. Procedura e ndjekur për zgjidhjen e ankesës, si dhe vendimi i marrë, dokumentohet <i>[Ref_002 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT, Neni 35, pika 3]</i> . Nga bisedat me studentët na u referua vetëm një rast kur kishte patur mosmarrëveshje mes një studenti dhe një pedagogu në lidhje me procesin e provimit, por kjo mosmarrëveshje ishte zgjidhur menjëherë nga Dekani i FIMF dhe studenti ndihej i kënaqur që i ishte dhënë drejtësi.

Konkluzione	GVJ konkludon se: Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në programet e lëndëve/moduleve nga titullarët e tyre. Studentët dëshmojnë se ata kanë të drejtën të shohin fletët e provimit dhe të marrin sqarime nga pedagogu për vlerësimin, si edhe të drejtën e ankimit. Platforma elektronike e bit-albania ndihmon shmangien e abuzimit. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me programin dhe bazën ligjore në fuqi. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse. Çdo kërkesë apo ankesë shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura është transparente; gjithçka dokumentohet dhe arkivohet.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Programi i studimit në "Bachelor në Inxhinierinë Fizike" harmonizon një gamë të gjerë dijesh teorike dhe praktike në fushën e inxhinierisë, me një theks të veçantë në Inxhinierinë Fizike [Ref_034 Rregullore Njësia Bazë DIF], [Ref_035 Plani Strategjik Njësia Bazë 2019-2024 DIF], [Ref_036 Plani i Zhvillimit të Strategjisë 2019-2024 DIF], [Ref_038 Rregullore e Programit të Studimit Bch. IF]. Ai synon pajisjen e studentëve me një bazë shkencore solide që ata do ta përdorin dhe aplikojnë në jetën e tyre profesionale. Plani mësimor përmban njohuri të mira e të harmonizuara në fushën specifike të Inxhinierisë Fizike, por edhe në matematikë, informatikë dhe lëndë të ndryshme inxhinierike [Ref_040-042 Plani Mësimor Bch. IF 21-24], [Ref_044-046 Programet Lëndore (Syllabuse) Bachelor IF 21-24]. Ky harmonizim përfshin të mësuarit e të menduarit kritik dhe aplikativ. Gjatë vizitës në institucion ne vërejtëm një mjedis të mirëfilltë akademik që inkurajon përparimin e studentëve dhe bashkëpunimin konstruktiv mes tyre e pedagogëve.
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive	Plani mësimor i programit të Studimit Bachelor në Inxhinierinë Fizike, përveç lëndëve profesionale, përfshin lëndë nga teknologjia e

të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.	informacionit, komunikimi. Të tilla janë Bazat e Informatikës, Gjuha e Huaj, CAD (Vizatim me Ndihmën e Kompjuterit), dhe Ekonomia dhe Menaxhimi i Ndërmarrjeve. Studentët bëhen inxhinierë të mirë nga pikëpamja teknike, por njëkohësisht kanë aftësi komunikimi e të punës në grup. Kjo, bashkë me të kuptuarin e tregut të punës (studentët kanë aftësi analitike që i ndihmojnë për këtë qëllim), garanton suksesin e tyre profesional në të ardhmen.
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse.	Në përfundim të semestrit, pedagogu, bashkë me studentët, bën një analizë për të vlerësuar nëse objektivat e lëndës/modulit janë arritur si dhe për të krahasuar rezultatet e nxënit me pritshmëritë e parashikuara nga rregulloret dhe programet mësimore. Gjetjet e kësaj rrahjeje të mendimeve përfshihen në Raportin e Aktivitetit të tij Mësimor, të cilat diskutohen më pas në mbledhjet e departamentit. Vlerësimet periodike gjatë vitit, provimi përfundimtar, si dhe pyetësorët e studentëve shërbejnë si tregues të rëndësishëm për të matur cilësinë e dijeve të fituara. Rishikimi i programit të studimit bazohet në progresin e studentëve në çdo lëndë ose modul, duke u fokusuar tek nivelit e kompetencave dhe aftësive që ata kanë arritur.
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Procesi mësimor në UPT gërsheton format e mësimi teorik e praktik, ku përfshihen: leksionet, seminarët, ushtrimet, punët laboratorike, konsultimet, praktikat profesionale, detyrat e kursit, projektet e kursit, studiot, projekt – diplomat, etj. me format e kontrollit të dijeve, ku përfshihen: bashkëbisedimet, mbrojtje e punëve laboratorike, mbrojtje e detyrave dhe/ose projekteve të kursit, mbrojtje e praktikave profesionale, provime të ndërmjetme, provimet e lëndës, provimet e formimit, mbrojtje e temave e diplomave etj., siç përcaktohet në dokumentacionin akademik zyrtar, duke përfshirë rregulloret dhe udhëzimet e specifikuara për çdo program studimi <i>[Ref_002 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT, Neni 25]</i> . Mësimdhënia bazohet mbi kompetenca, veçanërisht që kanë një komponente laboratorike, si Fizika e Përgjithshme, Kimia, Informatika, Optika, Parimet dhe Zbatimet e Lazerave, Shkenca dhe Teknologjia e Materialeve etj <i>[Ref_040-042 Plani Mësimor Bch.IF 21-24], [Ref_044-046 Programet Lëndore (Syllabuse) Bachelor IF 21-24]</i> . Studentët shkathtësohen me kryerjen dhe hartimin e relacioneve të punëve të laboratorit, detyrave të kursit apo projekteve, ku qëllimi është testimi i kompetencave të fituara <i>[Ref_040-042 Plani Mesimor Bch.IF 21-24], [Ref_044-046 Programet Lëndore (Syllabuse) Bachelor IF 21-24]</i> . Në bisedat e zhvilluara gjatë vizitës në institucion, studentët na treguan se pedagogët inkurajojnë punën në grup dhe përdorimin e njohurive praktike të fituara. Në detyrat dhe projektet e kursit studentët inkurajohen të analizojnë raste reale, të kryejnë hulumtime dhe




	miniprojekte në mënyrë individuale ose kolektive, të aplikojnë teoritë e mësuar në praktikë, të rrisin aftësinë e tyre për të punuar në grup dhe të formulojnë konkluzione dhe rekomandime për çështje specifike. Ata zhvillojnë aftësi që të kryejnë vetë studime më të thelluara kërkimore e shkencore gjë që do i ndihmojë edhe në drejtim të përgatitjes së punimit së diplomës <i>[Ref_040-042 Plani Mësimor Bch.IF 21-24], [Ref_044-046 Programet Lëndore (Syllabuse) Bachelor IF 21-24]</i>. Temat e detyrave të kursit zgjidhen me kujdes nga pedagogët, që studentët t'i drejtohen literaturës, për t'u njohur me idetë e reja inovative në fushën e Inxhinierisë Fizike dhe më pas t'i aplikojnë ato. Gjithashtu studentët përfshihen në projekte kërkimore dhe studimore <i>[Ref_098 Aktivitete Shkencore dhe Ore të Hapura nga Lektore të Huaj të Ftuar FIMIF], [Ref_127 Aktivizimi i Studenteve në Projekte]</i>.
Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Për të prezantuar zhvillimet e reja të shkencës së Inxhinierisë Fizike si dhe teknologjitë inovative në këtë fushë, jashtë strukturës së programit të studimit janë organizuar nga personeli akademik i brendshëm orë të hapura dhe seminare. Gjithashtu përmes ftesës së profesorëve të huaj është bërë e mundur organizimi i seminarëve dhe trajnimeve të hapura për studentët <i>[Ref_098 Aktivitete Shkencore dhe Lektorë të Huaj të Ftuar FIMIF]</i>. Gjithashtu në FIMIF është bërë tashmë një praktikë e mirë organizimi i Workshop-ve Studentore, ku studentët nën drejtimin e pedagogëve bëjnë referime të ndryshme rreth zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë <i>[Ref_113 Raporti Vjetor i Zyrës së Karrierës FIMIF 21-22,22-23,23-24], [Ref_114 Infrastruktura dhe Shërbime IT në FIMIF]</i>.
Konkluzione	GVJ konkludon se: Programi i studimit garanton thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve. Ai garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit. Aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe programet e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të

	shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.	Një kapitull i Rregullores Mësimore të programit të studimit të ciklit të parë “Bachelor në Inxhinierinë Fizike”, ai i katërt “ <i>Diplomimi i studentëve</i> ” [Ref_038 Rregullore e Programit të Studimit Bch. IF], përcakton kërkesat specifike për diplomimin e studentit: Studimet e ciklit të parë Bachelor në Inxhinierinë Fizike përmbyllen me Provim të Përgjithshëm Përfundimtar (Provim Formimi) ose Punim Diplome dhe në përfundim të tyre lëshohet diplomë “Bachelor në Inxhinierinë Fizike”. Punim diplome mund të kryejnë studentët me mesatare më të lartë ose ata që propozojnë vetë një të tillë [Ref_054 Udhëzues për Provimin e Formimit Final Bch. IF], [Ref_053 Procedurë Konsultimi për Provimin e Diplomës në Bch. IF], [Ref_050 Diploma e Programit Bch. IF], [Ref_052 Supplement Diplome Bch. IF].
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.	DIF ofron mbështetje të plotë për studentët në fuksion të plotësimi të detyrimeve përmbyllëse, si në rastin kur studenti jep provim formimi, ashtu edhe kur ai zgjedh të paraqisë një punim diplome. Për provimin e formimit, studentëve u vihen në dispozicion plani mësimor dhe programet mësimore të lëndëve [Ref_040-042 Plani Mesimor Bch. IF 21-24], [Ref_044-046 Programet Lendore (Syllabuse) Bachelor IF 21-24], si edhe ofron mbështetje me konsultime të rregullta. Në rastin kur studenti zgjedh të paraqisë një punim diplome, ai ndihmohet kryesisht nga udhëheqësi, i cili siguron që të zgjidhet metodologjia e duhur e kërkimit, mjetet analitike, si edhe ndihmon në interpretimin e rezultateve. Studentët nxiten dhe ndihmohen për të përdorur burimet e bibliotekës dhe bazat elektronike të te dhënave për të aksesuar literaturën e nevojshme për hulumtimin e tyre [Ref_077 Biblioteka e FIMIF], [Ref_078 Biblioteka online COBISS FIMIF], atyre u ofrohen paketa të gatshme software dhe, para mbrojtjes, organizohen seminare ku studentët kanë mundësi të prezantojnë punën e tyre para kolegëve dhe personelit akademik për të marrë kritika konstruktive dhe sugjerime për përmirësim. Pedagogu ofron udhëzime specifike për përgatitjen e prezantimit dhe mbrojtjen e detyrimeve përmbyllëse, duke përfshirë këshilla për të folur publik dhe përgjigjen ndaj pyetjeve.

	Përmes këtyre shërbimeve dhe mbështetjes së vazhdueshme, strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik sigurojnë që studentët janë të pajisur mirë për të përballuar sfidat e detyrimeve të tyre përmbyllëse, duke kontribuar në zhvillimin e tyre akademik dhe profesional. Angazhimi i këtyre burimeve dhe mbështetjes është thelbësor për të siguruar cilësinë dhe integritetin e punës së studentëve, duke i përgatitur ata për suksesin në karrierat e tyre të ardhshme.
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Qëllimi i Provimit të Formimit në FIMIF është të testojë njohuritë e fituara në lëndët Fizike dhe Inxhinierike të trajtuara gjatë tre viteve të studimit të ciklit të parë në Inxhinierinë Fizike, duke përfshirë lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës se tyre specifike. Teza e provimit të formimit hartohet dhe vlerësohet nga komisioni i Provimit të Formimit të miratuar nga Dekani i FIMIF. Numri i anëtarëve të komisionit të Provimit të Formimit është jo më pak se 3 (tre) <i>[Ref_064 Shembull i Miratimit të Komisioneve dhe Datave të Diplomimit], [Ref_099 Shembull Procesverbal i Vlerësimit në Provim Formimi dhe Mbrojtje Diplome]</i>. Komisioni i vlerësimit respekton procedurën dhe rregullat përkatëse, të përcaktuara në <i>[Ref_038 Rregullore e Programit të Studimit Bch. IF]</i> dhe <i>[Ref_054 Udhëzues për Provimin e Formimit Final Bch. IF]</i>. Provimi organizohet me shkrim dhe është i sekretuar. Korrigjimi dhe vlerësimi i tezës bëhet nga personi përgjegjës i lëndës së studimit që është dhe anëtar i komisionit të provimit. Nota është mesatarizim i vlerësimit që ka dhënë çdo anëtar i komisionit. Pas përfundimit të provimit, kryetari i komisionit, në prani të të gjithë anëtarëve, njofton secilin student për notën e marrë nga vlerësimi i tezës së Provimit të Formimit. Notat regjistrohen në procesverbalin e mbrojtjes së diplomave. Përgjigjet e studentëve ruhen në arkivën e fakultetit për një periudhë një vjeçare.
Kriteri 4. Personeli akademik/Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Punimi i diplomës të ciklit të parë të studimeve Bachelor në Inxhinierinë Fizike është një projekt ose një përmbledhje punimesh të kryera në fushat e programit përkatës të studimit. Teza e diplomës përmban kërkesa për zgjidhjen/plotësimin e të cilave studenti duhet të përdorë aftësitë e tij për të zgjidhur elementë të veçantë të detyrave projektuese apo problemeve të prodhimit nëpërmjet njohurive të fituara gjatë periudhës së shkollimit, apo për të punuar me literaturën në fushën e Inxhinierisë Fizike. Udhëheqësi i punimit të diplomës përgatit programin e punës së studentit, duke vendosur edhe afatet e përafërta të realizimit të tij. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Udhëheqësi përcakton grafikun e konsultimeve të programuara me studentin, përgjatë të cilave konsultohet dhe kontrollohet puna e bërë sipas programit të miratuar. DIF organizon jo më pak se dy kontrole të ndërmjetme, ku kontrollohet volumi i punës

	së kryer dhe cilësia e saj. Aty mund të rekomandohen edhe ndryshime apo përmirësime të programit të tezës, të cilat nuk përmbysin thelbin e punimit. Para mbrojtjes së punimit të diplomës, udhëheqësi rishikon dhe miraton punimin e kryer nga studenti dhe lejon mbrojtjen e punimit duke firmosur tezën e diplomës <i>[Ref_038 Rregullore e Programit të Studimit Bch. IF, kreu IV]</i> , <i>[Ref_053 Procedure Konsultimi për Provimin e Diplomes në Bch. IF]</i> , <i>[Ref_054 Udhëzues për Provimin e Formimit Final Bch. IF]</i> .
Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Studentët kanë të drejtë të përdorin infrastrukturën që FIMIF vë në dispozicion të procesit mësimor dhe shkencor, mjediset në biblioteka, salla kompjuterësh dhe shërbime të tjera <i>[Ref_031 Rregullore Njësia Kryesore FIMIF]</i> , <i>[Ref_032 Plani Strategjik Njësia Kryesore 2019-2024 FIMIF]</i> , <i>[Ref_033 Plani i Zhvillimit të Strategjisë 2019-2024 FIMIF]</i> , <i>[Ref_002 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT, Neni 70, 1d]</i> . FIMIF vë në dispozicion të studentëve të gjitha mjediset laboratorike dhe pajisjet që ata disponojnë, në shërbim të kryerjes së matjeve, analizave, si dhe asistojnë në punën laboratorike <i>[Ref_079 Labororet në FIMIF dhe Departamentet e saj]</i> .
Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	UPT u përmbahet standardeve akademike të njohura dhe pranura ndërkombëtarisht. Nota e çdo studenti del nga mesatarizimi i vlerësimeve që ka dhënë çdo anëtar i komisionit. Në përfundim të Provimit të Formimit kryetari i komisionit, në prani të anëtarëve, i komunikon çdo studenti notën e vet. Notat regjistrohen në proces-verbalin e Provimit të Formimit, i cili firmoset nga të gjithë anëtarët e komisionit. E njëjta praktike ndiqet edhe në rastin e mbrojtjes së diplomës <i>[Ref_099 Shëmbull Procesverbal i Vlerësimit në Provim Formimi dhe Mbrojtje Diplome]</i> . Në rast se studenti vlerësohet me notë negative, ai mund të rihyjë në provim në sezonin e ardhshëm, pa tejkaluar afatin maksimal të përcaktuar në kornizën ligjore në fuqi. <i>[Ref_038 Rregullore e Programit të Studimit Bch. IF, kreu IV]</i> .
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	UPT u përmbahet standardeve akademike të njohura dhe pranura ndërkombëtarisht. Në përfundim të studimeve UPT e pajis studentin që ka përfunduar të gjitha detyrimet me diplomën përkatëse. Senati Akademik i UPT miraton formën, elementët përbërës dhe modelin e diplomave dhe certifikatave që lëshohen, në përputhje me kornizën ligjore në fuqi <i>[Ref_002 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT, Neni 60]</i> . Çdo formë diplome dhe certifikate, përpara se të lëshohet nga UPT-ja, regjistrohet në regjistrin shtetëror të diplomave dhe të certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, që mbahet në Qendrën e Shërbimeve Arsimore <i>[Ref_050 Diploma e Programit Bch. IF]</i> , <i>[Ref_051 Urdhër Rregjistrimi Diplome Bch. IF]</i> , <i>[Ref_052 Suplement Diplome Bch. IF]</i> . Diploma

	lëshohet nga Universiteti Politeknik i Tiranës deri gjashtë muaj pas përfundimit të studimeve. Deri në pajisjen me diplomë të diplomantëve, universiteti lëshon një vërtetim për diplomën e fituar, të shoqëruar me fletën e notave. Së bashku me diplomën studenti pajiset dhe me suplementin e diplomës. Suplementi i diplomës hartohet në përputhje me kërkesat e Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë. Ai përshkruan, në veçanti, natyrën, nivelin, përmbajtjen dhe rezultatet e studimeve, që janë kryer nga mbajtësi i diplomës, si dhe fushën e punësimit [Ref_002 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT, Neni 61]. Përmbajtja dhe forma e suplementit të diplomës përcaktohen në statutin e UPT-së, në përputhje me udhëzimet e ministrisë përgjegjëse për arsimin e lartë. Suplementi i diplomës lëshohet në gjuhën shqipe dhe angleze [Ref_050 Diploma e Programit Bch. IF], [Ref_051 Urdhër Rregjistrimi Diplome Bch. IF], [Ref_052 Suplement Diplome Bch. IF]. Programi i plotë i studimit Bachelor në Inxhinierinë Fizike në gjuhën shqipe ose anglisht vihet në dispozicion të studentit me kërkesë të tij [Ref_040-042 Plani Mësimor Bch. IF 21-24], [Ref_044-046 Programet Lëndore (Syllabuse) Bachelor IF 21-24]. Ky program nënshkruhet në çdo faqe nga Zv. Dekani për anën mësimore.
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Sekretaria mësimore e FIMIF është struktura kryesore e cila administron dhe ruan dokumentacionin e studentëve për çdo program studimi në FIMIF [Ref_031 Rregullore Njësia Kryesore FIMIF, Neni 43, 44 dhe 45]. Sekretaria Mësimore mban regjistrin themeltar bazë të studentëve me të dhënat personale të tyre, vlerësimet e marra gjatë ndjekjes së programit të studimit, regjistrin e arritjeve akademike, të dhëna mbi diplomën ose diplomat e marra bashkë me suplementin e diplomës etj, regjistrin e lëshimit të diplomave, të formatuara këto sipas standardeve shtetërore. Regjistri plotësohet në formë të shkruar dhe elektronike dhe mbahet në ruajtje të përhershme [Ref_124 Model Rregjistri Elektronik dhe Hard Copy nga Sistemi i Sekretarisë Mësimore]. Regjistri themeltar shkruhet me dorë dhe me kompjuter. Ai nuk ka pa korrigjime dhe nuk ndryshohet për asnjë arsye. Përdorimi dhe përpunimi i të dhënave personale të studentëve bëhet prej Sekretarisë Mësimore në përputhje me ligjin “Për mbrojtjen e të Dhënave Personale në Shqipëri”. Të dhënat e studentëve ruhen përgjithnjë dhe paraqiten sipas kërkesës së të interesuarve.
Konkluzione	GVJ konstaton se: UPT-FIMF ka hartuar rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme

	<i>në funksion të detyrimeve përmbyllëse. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohurive të dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike. Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Ai asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar, si dhe garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin; atij i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar. UPT-FIMF ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet informacione për studentin, nëse kërkohen.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1 Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit,	Stafi akademik dhe ndihmës akademik në FIMIF, i angazhuar në realizimin e programit të studimit, përmbush të gjitha kërkesat ligjore për kualifikimin akademik dhe ndihmës akademik, drejtimin e programit, mbulimin e lëndës/modulit dhe përvojën kërkimore/praktike. Kjo është thelbësore për ruajtjen e cilësisë së arsimit dhe përputhjen me standardet rregullatore. Drejtorja e Burimeve Njerëzore dhe Juridike, si pjesë e strukturës organizative të UPT, është përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore, çështjet juridike dhe sektorin e

drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	protokollit dhe arkivës institucionale. Sipas Organigramës së Universitetit Politeknik të Tiranës, sektori i Burimeve Njerëzore, si pjesë e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Juridike, është përgjegjës për mbledhjen, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave të personelit të angazhuar në programet e studimit <i>[Ref_007 Organigrama e UPT]</i> [http://upt.al/burimet-njerezore]. Përgjegjësitë për çdo funksion janë të përcaktuara edhe në rregulloren e FIMIF dhe në rregulloren e DIF <i>[Ref_031 Rregullore Njesia Kryesore FIMIF]</i>, <i>[Ref_034 Rregullore Njesia Baze DIF si dhe në statutin e UPT]</i>, <i>[Ref_001 Statuti i UPT]</i>. Lidhur me stafin e angazhuar në programin Bachelor në Inxhinierinë Fizike, KPS përditëson çdo vit të dhënat për personelin, duke përfshirë kualifikimet akademike të kërkuara për fakultetin nga stafi akademik dhe asistentët akademikë të përfshirë në programin e studimit. Në fillim të çdo viti akademik, përcaktohet stafi akademik dhe ngarkesa individuale semestrale dhe vjetore e çdo personeli akademik të angazhuar në mësimdhënien e programit Bachelor në Inxhinierinë Fizike. Organizimi i kohës vjetore të punës dhe programimi i saj në veprimtaritë e ndryshme përbërëse, për çdo anëtar të personelit akademik, formalizohet ndërmjet Përgjegjësit të Departamentit dhe anëtarëve të personelit akademik, sipas Udhëzimit të MASR Nr.29, datë 10-09-2018, të ndryshuar. Në të tre vitet e fundit akademike, stafi përgjegjës akademik rezulton sim ë poshtë: - 2023-2024, 32 PAE (1 Prof. Dr., 12 Prof. As., 14 Dr, 5 Msc) dhe 3 PAK (1 Dr, 2 Msc); - 2022-2023, 30 PAE (1 Prof. Dr., 9 Prof. As., 16 Dr, 4 Msc) dhe 5 PAK (1 Prof.As, 2 Dr, 2 Msc); - 2021-2022, 30 PAE (2 Prof. Dr., 8 Prof. As., 17 Dr, 3 Msc) dhe 9 PAK (1 Prof.As., 3 Dr, 5 Msc). <i>[Ref_VI. ANEKS_Tabelat permbledhese per RVB_Bch.IF]</i>, <i>[Ref_049 CV e Personelit Akademik dhe Ndhimes Akademik DIF]</i>, <i>[Ref_048 CV e Personelit Akademik te Angazhuar ne Programin Bch. IF]</i>.
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	Për të realizuar ngarkesën mësimore në programin Bachelor në Inxhinierinë Fizike dhe për të arritur rezultate maksimale dhe angazhim korrekt: Ngarkesa vjetore për anëtarët e Departamentit të Inxhinierisë Fizike (DIF) ndahet ndërmjet mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, duke iu përshtatur kornizës ligjore. Përgjegjësitë e mësimdhënies ndahen sipas ekspertizës, kualifikimeve dhe preferencave mësimore të personelit akademik.

	Respektimi i orëve të mësimdhënies monitorohet përmes vlerësimeve periodike dhe regjistrimeve të pjesëmarrjes. Lëndët dhe modulet perkatese organizohen dhe ndahen prej drejtuesit të departamentit dhe i jepen per te mbuluar ngarkesën mësimore duke respektuar përvojën mësimore dhe kërkimore të personelit në fushën përkatëse si dhe gradën apo titullin akademik duke respektuar prioritetet për punën kërkimore që parashikohet individualisht por edhe në dhe në nivel Grupi Mësimor/Departamenti/Fakulteti apo Universiteti, në fillim të çdo viti akademik. Përsa i përket mbulimit të ngarkesës mësimore, sipa të dhënave rezultojn se: - 2023-2024, 94.4 % e ngarkesës mbulohet nga PAE dhe 5.6 % nga PAK; - 2022-2023, 90.7 % e ngarkesës mbulohet nga PAE dhe 9.3 % nga PAK; - 2023-2024, 86.9 % e ngarkesës mbulohet nga PAE dhe 13.1 % nga PAK. Personeli ndihmës akademik me karakter mësimor-shkencor (laborantët) ndihmojnë në mësimdhënie duke mirëmbajtur laboratorët mësimorë dhe shkencorë. Personeli akademik harton programet e lëndëve, shfrytëzon orët mësimore, kontrollon dijet dhe kryen kërkime për të përmbushur objektivat e programit Bachelor në Inxhinierinë Fizike. Mësimdhënia përfshin edhe personel nga Departamentet e Inxhinierisë Matematikës, Inxhinierisë Kimike, Qendra e Gjuhëve të Huaja dhe fakultetet FTI, FIE, FIM. <i>[Ref_047 Lista e Personelit Akademik të Angazhuar në Bch. IF]</i>. Gjithashtu dëshmi e optimizimit të burimeve njerëzore është dhe krijimi dhe organizimi i grupeve mësimore <i>[Ref_069 Procedure mbi Zgjedhjen e Drejtuesve të Grupeve Kërkimore Shkencore IF]</i>.
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	Për të siguruar qëndrueshmërinë e stafit akademik gjatë periudhës së akreditimit, merren masa për garantimin e kontratave të punës dhe mbulimin e sigurimeve shoqërore e shëndetësore: - Personeli akademik ka kontrata të qarta dhe transparente, në përputhje me ligjet dhe politikat institucionale. - Zbatohen procese vlerësimi të performancës që shpërblejnë përsosmërinë dhe mbështesin zhvillimin e stafit. - Sigurohet mbulimi i plotë i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. <i>[Ref_058 Model Kontrate Individuale e Punës Personel PAE]</i>.
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe	Punësimi i personelit akademik dhe ndihmës-akademik kryhet me konkurrim, përmes thirrjeve të hapura, me qëllim përzgjedhjen e

vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	kandidatëve ekselentë dhe me potencial për të kontribuar në zhvillimin institucional të UPT dhe në impaktin e tij kombëtar e rajonal. Shpallja e thirrjeve bëhet nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Juridike online përmes www.upt.al [https://www.upt.al/vendepune/] në mënyrë që të jenë lehtësisht të aksesueshme nga kushdo. Thirrjet shpallen edhe përmes faqeve zyrtare ëeb të FIMIF dhe publikohen edhe në rrjete sociale. Statuti UPT dhe procedura e rekrutimit të stafit akademik dhe ndihmës akademik ka të përcaktuar kriteret e përgjithëshme ndersa DIF vendosin kriteret specifike për rekrutimin e personelit të ri. Universiteti Politeknik i Tiranës rekrutimin e stafit akademik e bën referuar procedurave e kriterëve të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore, ligji Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, nenet 57, 59, 64 [Ref_001 Statuti i UPT, Neni 42, pika 3] dhe i bën ato publike. [Ref_031 Rregullore Njesia Kryesore FIMIF], [Ref_034 Rregullore Njesia Baze DIF]. Çdo hap i kësaj procedure duke filluar me identifikimin e nevojës për staf prej DIF, miratimin e kriterëve, publikimin, procesin e vlerësimit të kandidatit dhe deri tek vendimi i marrjes në punë janë të dokumentuara në dosjen e personelit në Zyrën e Burimeve Njerëzore të universitetit [Ref_055 Model Rekrutimi Staf Akademik_PAE], [Ref_056 Model Rekrutimi Staf Ndhimes Akademik], [Ref_057 Model Rekrutimi Staf Akademik PAK].
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Personeli ndihmës akademik me karakter mësimor-shkencor (laborantët) është i trajnuar për procedurat e sigurisë laboratorike dhe kërkesat e pajtueshmërisë rregullatore dhe ka rol të rëndësishëm në realizimin e mësimdhënies, veçanërisht në mirëmbajtjen dhe funksionimin e laboratorëve mësimore dhe shkencore. Merren parasysh faktorë të tilla si madhësia dhe kompleksiteti i laboratorëve, numri i studentëve të regjistruar në kurset përkatëse, si dhe aftësitë dhe ekspertizat specifike të personelit ndihmës për të mbështetur aktivitetet laboratorike. Përgjegjësitë e personelit ndihmës akademik përfshijnë: Vendosja dhe mirëmbajtja e pajisjeve laboratorike, mbikëqyrja e sigurisë në laborator, asistenca teknike për studentët dhe pedagogët gjatë aktiviteteve laboratorike dhe menaxhimi i inventarit të laboratorit. Të gjithë këto laboratore rinovohen kohë pas kohe dhe janë të paisura me pajisje elektronike dhe IT, që janë të mjaftueshme për realizimin e plotë të procesit mesimor. Departamenti i Inxhinierisë Fizike zotëron 4 laboratorë, të cilat përdoren për realizimin e seancave laboratorike në programin e studimit Bachelor në Inxhinierinë Fizike, në lëndën e fizikës A+B (Mekanika), Fizikë C (Termodinamikë dhe

	Elektromagnetizëm), Fizikë III (Optikë) etj dhe 2 laboratorë të Fizikës Speciale [Ref_079 Labororet ne FIMIF dhe Departamentet e saj]. Marrëveshjet e bashkëpunimit të FIMIF me kompani apo IAL të tjera ofrojnë mundësi për studentët për realizimin e veprimtarive të ndryshme praktike të parashikuara në programet e lëndëve [Ref_VI. ANEKS_Tabelat permbledhese per RVB_Bch.IF, Tabela 5].
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	UPT dhe FIMIF administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe të gjithë personave të angazhuar në realizimin e programit [Ref_001 Statuti i UPT]. UPT nëpërmjet specialistit të zyrës së burimeve njerëzore menaxhon dokumentacionin personal të punonjësve si dhe plotëson rregjistrin themeltar. Ndjek procedurat për kontratat e punës për të gjithë punonjësit e UPT. Hedh të dhënat e çdo punonjësi në rregjistrin themeltar dhe i përditëson ato sipas cdo viti akademik. Nxjerr të dhëna nga dosjet e personelit kur kërkohen, bazuar në ligjin e mbrojtjes së të dhënave personale [Ref_003 Kodi i Etikës i UPT]. Sekretaria e dekanit të FIMIF-së, mban, ruan dhe administron, në përputhje me rregullat zyrtare, të gjithë dokumentacionin e departamentit si njësi administrative, ashtu edhe ato të stafit akademik që lidhen me procesin mësimor dhe administrative, sipas akteve ligjore dhe nënligjore [Ref_031 Rregullore Njesia Kryesore FIMIF]. Drejtuesi i departamentit plotëson dhe nënshkruan realizimin e ngarkesës mësimore, semestrale dhe vjetore të anëtarëve të departamentit, miraton planet mësimore kalendarike dhe marrëveshjen e punës, miraton tezat e provimeve, organizon aktivitete të ndryshme shkencore ose veprimtari të tjera që lidhen me funksionimin administrativ të departamentit dhe të procesit mësimor si dhe angazhohet për të lidhur marrëveshje me institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit [Ref_034 Rregullore Njesia Baze DIF]. Për sa i përket komunikimit shkresor zyrtar, në Universitetin Politeknik të Tiranës, administrimi i dokumentacionit bëhet nga Sektori i Arkivit dhe Protokollit në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Juridike sipas përcaktimeve në legjislacionin përkatës në fuqi [Ref_031 Rregullore Njesia Kryesore FIMIF].
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin,	Programi të studimit Bachelor në Inxhinierinë Fizike përmban në elementët e planit mësimor realizimin e praktikave profesionale, sepse në këtë program kryhen një numër i konsiderueshëm orësh. Universiteti Politeknik, nëpërmjet ambienteve të veta në të gjitha degët, garanton zhvillimin proceseve laboratorike për studentët. Këto ambiente mund të përdoren edhe për realizimin e një pjese të praktikave mësimore profesionale. FIMIF me të gjitha labororet mundëson një pjesë të praktikave dhe realizimit të diplomave. Nga ana tjetër marrëveshjet e

udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	bashkëpunimit të FIMIF me kompani apo IAL të tjera ofrojnë të tjera mundësi për studentët për realizimin e veprimtarive të ndryshme praktike të parashikuara në programet e lëndëve. Institucioni angazhohet në mënyrë aktive me institucionet e tjera të arsimit të lartë, bizneset dhe kompanitë për të krijuar marrëveshje formale dhe marrëdhënie bashkëpunimi. Kjo është bërë e mundur falë marrëveshjeve që UPT ka me këto subjekte <i>[Ref_128 Lista e Institucioneve Bashkepunuese per Praktikant Profesionale FIMIF], [Ref_010 Marrëveshjet Institucionale UPT].</i>
Kriter 8. Personeli mbikëqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Institucionet bashkëpunuese ofrojnë infrastrukturën e tyre, pajisjet laboratorike të kërkimit shkencor dhe personelin e kualifikuar për të ndihmuar dhe orientuar studentët. Ata mbikëqyrin orët e praktikave profesionale dhe udhëheqin punimet e diplomave. Praktikant profesionale zakonisht zhvillohen në institucione si QFZB, IGJEUM etj. Sipas marrëveshjeve institucionale, personeli që mbikëqyr studentët gjatë praktikave profesionale është i detyruar t'i asistojë dhe t'i ndihmojë ata në kryerjen e detyrave të tyre. Ky personel duhet të kontrollojë raportin përfundimtar të orëve të praktikave dhe të vlerësojë studentët si pjesë e procesit. Roli i personelit mbikëqyrës në mjedisin pritës është të lehtësojë praktikant profesionale për studentët. Personeli mbikëqyrës është përgjegjës për të ndihmuar studentët në përmbushjen e detyrimeve të tyre në lidhje me praktikant e tyre profesionale - Personeli përfshin profesionistë të fushës që kanë ekspertizë dhe përvojë për të udhëhequr studentët në mënyrë efektive. - Personeli ofron mundësi për studentët të fitojnë përvojë praktike, të zbatojnë njohuritë teorike në situata praktike dhe të zhvillojnë aftësi përkatëse brenda fushës së tyre të studimit. - Kjo përfshin qartësimin e pritshmërive, sigurimin e burimeve dhe mbështetjes së nevojshme, si dhe ofrimin e udhëzimeve gjatë gjithë kohëzgjatjes së praktikës. Përveç kësaj, personeli ndihmon studentët në përgatitjen e raporteve ose vlerësimeve përfundimtare që dokumentojnë përvojat dhe rezultatet e tyre të të nxënës. - Pjesëmarrja aktive në procesin e vlerësimit: Personeli mbikëqyrës duhet të marrë pjesë aktive në procesin e vlerësimit sipas marrëveshjeve për praktikant profesionale. Kjo përfshin vlerësimin e performancës së studentëve, ofrimin e komenteve konstruktive dhe kontributin e njohurive për zhvillimin dhe arritjet e tyre gjatë periudhës së praktikës. <i>[Ref_VI. ANEKS Tabelat permbledhese per RVB Bch.IF, Tabela 5], [Ref_010 Marrëveshjet Institucionale UPT].</i>
Konkluzione	<i>GVJ nga vizita në institucion dhe shqyrtimi i DVV, konstaton se: Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe</i>




	angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij. Personeli akademik efektiv mbulon ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. Institucioni garanton dhe të dëshmon qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore duke djekur procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit. DIF garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit. Ky departament mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ. DIF si pjesë e UPT, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve,	Fakulteti i FIMF ka ne dispozicion një godinë në përdorim me sipërfaqe prej 2385 m ² , të ndara sipas nevojave në: 2 Salla e leksionesh, me sipërfaqe 148 m ² dhe 17 salla ushtrimesh/seminarësh me sipërfaqe 759 m ² , me një sipërfaqe totale leksion/seminar 907 m ² . Në ambient disponohet edhe një sallë për biblioteke 81 m ² , dhe aktivitete

grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	promovuese dhe qeverisë studentore me sipërfaqe 28 m². Ambientet laboratorikë janë në harmoni me specifikat e moduleve lëndore, laboratorët për lëndët janë 11 salla me sipërfaqe 450 m², laboratorët për informatikën 2 salla, 88 m². Numri i studentëve aktivë për vitin akademik 2022 – 2023 është 600 studentë. Norma m²/për student 3209 m²/600 student = 5.4 m²/ student. Raporti i sipërfaqes m²/student në ambientet e godinaës ku zhvillon aktivitetin FIMIF (të përmendura më sipër) është 5.4 m²/student sipas normativës 5 m²/student, e përcaktuar për IAL e profileve inxhinierike sipas legjislacionit në fuqi <i>[Ref_102 Hapsirat e reja në dispozicion të FIMIF], [Ref_VI.ANEKS Tabelat permbledhese per RVB Bch.IF], [Ref_079 Labororet ne FIMIF dhe Departamentet e saj], [Ref_105 Vendimi per Akreditimin Institucional UPT], [Ref_104 Evidenca mbi laboratorët në UPT], [Ref_077 Biblioteka e FIMIF], [Ref_126 Akt per Administrimin e Godinave te ish ISP per FIMIF].</i>
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Mjediset e FIMIF që shërbejnë për realizimin e mësimin janë të paisura me mjetet e duhura bazë për një klasë mësimi. Ambientet janë të realizuara me standarte bashkëkohore. Lartësia e katit tavan/dysheme në secilën godinë është rreth 3 m, ka izolim të mirë akustik, dhe me dritë, si dhe të pajisura me sisteme ngrohje-ftohje të centralizuara. Me sisteme ngrohje – ftohje janë pajisur edhe koridoret ndërlidhese të brendshme të fakultetit, duke e bërë efektivisht një ambient komod për qëndrimin dhe mësimdhënjen. Klasat e leksioneve janë të pajisura me videoprojektore fiks në mur si dhe burime të shumëfishta të furnizimit me energji elektrike dhe lidhje me kabëll për internetin. Ajo që mungon në klasa është kompjuteri fiks tek tavolina e pedagogut. Gjithashtu DIF në FIMIF ka në dispozicion edhe 3 ambiente laboratorike që i shërbejnë procesit mësimor por edhe atij kërkimor-shkencor. Të gjithë këto laboratore rinovohen kohë pas kohe dhe janë të paisura me pajisje elektronike dhe IT <i>[Ref_102 Hapsirat e reja në dispozicion të FIMIF], [Ref_VI.ANEKS Tabelat permbledhese per RVB Bch.IF], [Ref_079 Labororet ne FIMIF dhe Departamentet e saj], [Ref_105 Vendimi per Akreditimin Institucional UPT], [Ref_104 Evidenca mbi laboratorët në UPT], [Ref_077 Biblioteka e FIMIF], [Ref_093 Informimi i Studentëve Nëpërmjet Platformave Online].</i>
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e	Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike zotëron 13 ambiente laboratorike në godinën që zhvillon aktivitet, ndër të cilët 2 ambiente për laborator informatike. Specifikat e laboratoreve lidhen me ngushtë me profilin e fakultetit dhe të programeve specifike. Dy ambiente janë laboratore speciale të Inxhinierisë Fizike, 5 laboratore të Fizikës, 2 laboratore për Kiminë, dhe 2 ambiente për laboratore të papërshtatura ende (në përdorim nga FIN). DIF ka 5 (pesë) laboratorë të Fizikës së përgjithshme dhe 2 (dy) laboratorë të Fizikës Speciale

praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	[Ref_079 Labororet ne FIMIF dhe Departamentet e saj]. Këto laboratore përmbajnë paisjet e nevojshme teknike dhe informatike për të zhvilluar labororet dhe praktikat me studentët e DIF por edhe nga të gjithë studentët e UP që e përfshijnë në modulet e tyre të Fizikës. Gjithashtu laboratorët speciale përdoren gjithashtu edhe për kerkime shkencore nga stafi i DIF por mund të përdorem gjithashtu edhe per kerkime shkencore nga stafi i DIF. [Ref_104 Evidenca mbi laboratorët në UPT].			
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Institucioni (UPT) siguron gjithsej 12 laboratore për lëndët e informatikës dhe teknologjisë së informacionit në tërësinë e ambienteve të tij [Ref_104 Evidenca mbi laboratorët në UPT]. Çdo sallë informatike është e pajisur me hapësirë e nevojshme për zhvillimin normal të leksioneve/seminareve. Lendet e teknologjise se informacionit si p.sh informatika baze apo gjuhet e programimit, mbahen nga personel nga Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit, i cili ka në dispozicion plot 7 laboratore modern dhe të pajisur me programe profesionale (gjuhet C, C++, java, Python, sinjalet, rrjetat, sistemet elektronike etj.). Gjithashtu FIMIF në ambjentet që administron ka dy laboratore informatike në të cilët janë instaluar software si Mathlab etj. Njëkohesisht në labororet e DIF [Ref_079 Labororet ne FIMIF dhe Departamentet e saj] janë të instaluar software profesional si; Matlab, Phython etj. shërben jo vetëm për studentët por dhe per zhvillimin e kerkimit shkencor [Ref_114 Infrastruktura dhe Sherbime IT ne FIMIF].			
Konkluzione	GVJ konkludon se: DIF siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi. FIMIF në ambjentet që administron ka dy laboratore informatike në të cilët janë instaluar software si Mathlab etj. Njëkohesisht në labororet e DIF janë të instaluar software profesional si; Matlab, Phython etj. shërben jo vetëm për studentët por dhe per zhvillimin e kerkimit shkencor.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Standardi IV.3

IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	UPT zotëron një literaturë të konsiderueshme, në trajtë fizike dhe digjitale, në dispozicion në bibliotekën shkencore qendrore për studentët e tij, kjo biblioteke është pjesë e korpusit qendror ofron 65570 tituj <i>[Ref_026 Rregullore e Bibliotekës Shkencore UPT]</i>, <i>[Ref_027 Informacion mbi Bibliotekat në UPT]</i>. Të gjitha koleksionet janë të regjistruara në katalogun on-line <i>[Ref_076 Biblioteka online COBISS FIMIF]</i>. Fakulteti i Inxhinierise Matematike dhe Inxhinierise Fizike ka gjithashtu një qender multimediale/ biblioteke të vetën http://www.fimif.upt.al/biblioteka.php të pajisur me afro 347 tituj libra të huaj dhe 73 tituj libra shqip, periodikë në shqip një 3 tituj, doktratura dhe mikroteza 112, fond referencial 21copë, si dhe burime elektronike (bazat elektronike që ofron eIFL). Abonim në MathSciNet për Departamentin e Inxhinierisë Matematike <i>[Ref_077 Biblioteka e FIMIF]</i>.
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimet e literaturës me botime të viteve të fundit.	Njësia përgjegjëse e bibliotekës FIMIF raporton në mënyrë efektive përditësimet e literaturës me botimet e viteve të fundit, duke ofruar informacion dhe burime të vlefshme për të mbështetur veprimtaritë kërkimore dhe shkencore të komunitetit akademik. - Raportimi për përditësimet e literaturës komunikohet në kohën e duhur. - Përdoren mjete të tilla si bazat e të dhënave të citimeve (p.sh., Web of Science, Scopus) dhe motorët e kërkimit akademik (p.sh. Google Scholar) për të identifikuar publikimet e fundit. - Mblidhen informacione mbi botimet e fundit, duke përfshirë titujt, autorët, datat e botimit, abstraktet dhe fjalët kyçe. - Raportohet përditësimi i literaturës tek palët përkatëse, duke përfshirë anëtarët e fakultetit, studiuesit, studentët dhe përdoruesit e tjerë të bibliotekës. - Përditësohet vazhdimisht raportin i përditësimit të literaturës për të pasqyruar publikimet dhe zhvillimet e reja në këtë fushë. - Rishikohet rregullisht formati, përmbajtja dhe metodat e shpërndarjes së raportit për të siguruar efektivitetin dhe rëndësinë e tij. Duke patur parasysh kërkesat e përdoruesve (studentëve dhe stafit akademik) të bibliotekës parashikohet vazhdimisht pasurimi i bibliotekës me libra cilësorë (tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse),

	në gjuhën shqipe dhe gjuhë të huaj, shtimi i kompjuterave me parametra më të mirë, si dhe realizimi i ndërfaqes elektronike të bibliotekës brenda asaj të fakultetit që të pasqyrohet fondi, infrastruktura dhe aktiviteti i saj. <i>[Ref_077 Biblioteka e FIMIF], [Ref_100 Buxheti i Detajuar FIMIF 2023-2024], [Ref_131 Procedure Buxheti Afatmesem dhe Miratim Buxheti 2024].</i>
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Biblioteka shkencore e Universitetit Politeknik ka 75 vende leximi, ndërsa biblioteka shkencore e FIMIF, ndryshe nga ajo qëndrore, është e hapur për studentët dhe stafin e FIMIF. Kjo bibliotekë ka 36 poste leximi dhe konsultimi, si dhe 4 kompjutera <i>[Ref_077 Biblioteka e FIMIF]</i>. Biblioteka dhe ambientet e saj shërbejnë jo vetëm për konsultimin e librave, por edhe si salla leximi apo studimi individual për studentët. Ajo ofron kushte optimale për studim, me ndriçim të përshtatshëm, izolim akustik të mirë dhe shërbim wireless. Shërbimet e bibliotekës janë të disponueshme me kartë anëtarësimi.
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Biblioteka qëndrore është e pajisur me një koleksion të pasur të literaturës shqiptare dhe të huaj. Ajo përmban libra, monografi, revista, akte kongresesh dhe konferencash, manuale, doracakë, dhe më shumë. Përveç ofrimit të librave, biblioteka ofron shërbime të tjera si reprografi ose fotokopjim i autorizuar i pjesëve të librave, si dhe restaurim dhe lidhje librash. Biblioteka mbulon një gamë të gjerë fushash studimi, duke ndihmuar studentët me lëndë të ndërvartura nga fakultete të ndryshme <i>[Ref_026 Rregullore e Bibliotekës Shkencore UPT], [Ref_027 Informacion mbi Bibliotekat në UPT], [Ref_077 Biblioteka e FIMIF]</i>. Qendra Multimediale e FIMIF <i>[http://www.fimif.upt.al/biblioteka.php]</i> disponon një shumëllojshmëri materiale, përfshirë libra, revista, punime shkencore, dorëshkrime, CD-ROM, kaseta audio-vizuale me cikle leksionesh, enciklopedi, fjalorë dhe burime elektronike (bazat elektronike të ofruara nga eIFL).
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Një tjetër burim i rëndësishëm i literaturës i cili është i lidhur me bibliotekat e UPT dhe Biblioteken FIMIF është Sistemi COBISS (Co-operative Online Bibliographic System and Services) <i>[Ref_076 Biblioteka online COBISS_FIMIF]</i>. Ky sistem përfshin një rrjet të gjerë bibliotekash dhe shërben për krijimin e një sistemi katalogimi të përbashkët, ku përdoruesit mund të aksesojnë online secilën bibliotekë dhe të shfrytëzojnë katalogun në distancë. Sistemi COOBIS mund të aksesohet në lidhjen [https://plus.al.cobiss.net/opac7/libraries]. Përmes COBISS, studentët mund të lidhen online edhe me 15 biblioteka universitare, 10 biblioteka publike dhe 3 biblioteka speciale në 11 qytete të Shqipërisë. Sistemi i bibliotekave në dispozicion të studentëve dhe personelit akademik të UPT përfshin edhe Portalin e

	Bibliotekës Digjitale [https://ulibrary.rash.al/]. Përmes këtij portali, mund të shfletohen online artikuj shkencorë, mbi 193 mijë libra akademikë, mbi 50 mijë revista shkencore, mbi 200 milion lajme shkencore si dhe 30 paketa për mësimin e gjuhëve të huaj. Përmes sistemit ILS KOHA [https://koha-community.org/] do të ofrohet një shërbim i plotë dhe i integruar për përdoruesit e BSH. Institucioni ka bërë të mundur që secili student, apo anëtar i stafit akademik, të ketë akses tek portali informatik U-Library (https://ulibrary.rash.al/). Kjo bibliotekë ofron një database shumë të pasur me tekste, revista, periodikë etj, e cila aksesohet me kredencialet personale institucionale të secilit student/pedagog dhe pa pagesë. [Ref_026 Rregullore e Bibliotekës Shkencore UPT].
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Biblioteka qendrore e UPT ofron lidhjen me internetin me kabëll ose edhe wireless, për të mundësuar që studentet të shfrytëzojnë katalogët online apo bibliotekat online që i vihen në dispozicion. Sipas [Ref_027 Informacion mbi Bibliotekat në UPT], ambientet e bibliotekës nuk janë të pajisura me kompjutera fizik për të lehtësuar konsultimin e titujve online. Të gjithë studentët kanë akses të pakufizuar në programet kompjuterike dhe pajisjet teknike të disponueshme në bibliotekë. Në bibliotekën e FIMIF ka shërbim me projektor dhe fotokopje për shfrytëzim. Gjithsesi, studentët mund të përdorin tabletin/laptopin personal apo pajisje tjera për ta bërë të mundur këtë gjë.
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Biblioteka shkencore qendrore e UPT është në dispozicion të studentëve dhe të stafit akademik nëpërmjet infrastruktures së saj, ajo zbaton keto orare: e Hënë - e Premte: 8.00: 19.00, e Shtunë: 8.00: 14.00 [Ref_027 Informacion mbi Bibliotekat në UPT]. Praktikisht, oraret e bibliotekës pasqyrojnë dhe në kushte normale edhe tejkalojnë, oraret e zakonshme të mësimdhënjes në auditor [Ref_026 Rregullore e Bibliotekës Shkencore UPT]. Biblioteka e FIMIF është në dispozicion të studentëve dhe të stafit akademik nëpërmjet infrastrukturës së saj, ajo zbaton këto orare: e Hënë - e Premte: 8.00: 16.00 që perkon me oraret e zakonshme të mësimdhënjes në auditor [Ref_077 Biblioteka e FIMIF].
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli	Nga takimet gjatë vizitës në institucion dhe dokumentacionit të paraqitur në DVV, GVJ konstaton se koordinimi ndërmjet stafit të bibliotekës, njësiteve operative të programit, personelit akademik dhe sallave të studimit është thelbësor për gjurmimin dhe raportimin e kapaciteteve të burimeve fizike dhe online të bibliotekës universitare. Përmirësimi i vazhdueshëm i këtyre burimeve kërkon një përpjekje të përbashkët. Njësitë bazë, të cilat janë përgjegjëse për raportimin e burimeve fizike dhe online, përditësohen nga stafi akademik dhe studentët. Ata raportojnë për kohën e përdorimit të sallës së bibliotekës dhe sasinë e librave të disponueshëm.

akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	- Përfshirja e raporteve të inventarit, statistikave të përdorimit, regjistrave të blerjeve të reja dhe regjistrimeve të përdoruesve është thelbësore për menaxhimin e bibliotekës. - Bashkëpunimi me njësitë përgjegjëse të programit ndihmon në kuptimin e kërkesave specifike për koleksionin e bibliotekës. - Organizohen takime të rregullta për të mbledhur komente mbi përshtatshmërinë dhe rëndësinë e burimeve të disponueshme. Informohet personeli akademik dhe studentët për mënyrat efektive të përdorimit të burimeve të bibliotekës, duke përfshirë materialet fizike dhe online. - Sistemet e menaxhimit të bibliotekës lehtësojnë gjurmimin dhe menaxhimin efikas të burimeve fizike dhe online, duke ofruar përditësime në kohë reale mbi inventarin, qarkullimin dhe përdorimin. - Ofrimi i aksesit në bazat e të dhënave online, blerja e botimeve të reja të teksteve kryesore shkollore dhe rishpërndarja e burimeve sipas ndryshimit të nevojave programore janë prioritete kyçe.			
	<i>GVJ konkludon se: Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin Bachelor në Inxhinierinë Fizike. Departamenti kujdeset që të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit. Biblioteka qendrore është e pajisur me një literature të pasur shqiptare dhe te huaj. Ajo disponon libra, monografi, revista, akte kongresesh apo konferencash. Sherbimet e bibliotekës nuk ndalen vetem tek librat, pasi aty ofrohet Reprografia ose fotokopja e autorizuar e pjeseve të ndryshme të librit. Ofrohet gjithashtu restaurim dhe lidhje librash. Biblioteka përmban tituj për fusha të ndryshme studimi dhe kjo i vjen në ndihmë studentëve të cilët kanë lëndë të ndërvarura nga fakultete të tjera.</i> <i>Sistemi COBISS krijon kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit sepse studentët mund të lidhen online edhe me 15 biblioteka universitare, 10 biblioteka publike dhe 3 biblioteka speciale në 11 qytete të Shqipërisë. Sistemi i bibliotekave në dispozicion të studentëve dhe personelit akademik të UPT përfshin edhe Portalin e Bibliotekës Digjitale [https://ulibrary.rash.al/]. Përmes këtij portali, mund të shfletohen online artikuj shkencorë, mbi 193 mijë libra akademikë, mbi 50 mijë revista shkencore, mbi 200 milion lajme shkencore si dhe 30 paketa për mësimin e gjuhëve të huaj.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Universiteti Politeknik i Tiranës, në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 101, ka detyrimin për të mbajtur në formë të shkruar: a) Regjistrin bazë të studentëve, b) Regjistrin e sukseseve akademike, duke përfshirë dhe dokumentacionin për çdo provim ose detyrë tjetër akademike, c) Regjistrin për diplomimin dhe certifikatën e diplomës. Organizimi dhe detyrat e sekretarisë mësimore janë të përcaktuar në rregulloren e brendshme të Fakultetit të Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike <i>[Ref_031 Rregullore Njësia Kryesore FIMIF]</i>. Sekretaritë mësimore të fakulteteve plotësojnë këto regjistra në formë fizike dhe elektronike <i>[Ref_124 Model Rregjistri Elektronik dhe Hard Copy nga Sistemi i Sekretarisë Mësimore]</i>. Për menaxhimin dixhital të dokumentacionit (përfshirë procesverbalet e detyrimeve, procesverbalet e provimeve, vërtetimet e studentëve etj.), Sekretaria e FIMIF dhe fakultetet e tjera (FGJM, FIE, FAU, FIN dhe FTI) përdorin sistemin SEKRETAR <i>[Ref_076 Aksesimi i Sekretarisë Mësimore Online nga Studentët]</i>. SEKRETAR operon në bazë të parimit "Vetëm Printo dhe Skano". Çdo procesverbal për detyrimet apo provimet gjenerohet automatikisht në përputhje me rregulloren e provimeve dhe planifikimin e mësimi të përshtatshëm. Informacioni i plotësuar në procesverbalet nga pedagogu futet në bazën e të dhënave përmes skanimit të procesverbalit përkatës, duke eliminuar kështu çdo mundësi të gabimeve subjektive në vendosjen e të dhënave. Përgjegjësia për futjen e të dhënave në bazën e të dhënave është plotësisht në dorën e pedagogut që plotëson procesverbalin. Menaxhimi i shpërndarjes së procesverbaleve dhe mbledhja e tyre pasi plotësohen nga pedagogu bëhet nëpërmjet një sistemi inventarizimi që kryhet nëpërmjet lexuesit të barkodeve (theksojmë se çdo procesverbal ka një BarKod unik) <i>[Ref_031 Rregullore Njësia Kryesore FIMIF]</i>, <i>[Ref_124 Model Rregjistri Elektronik dhe Hard Copy nga Sistemi i Sekretarisë Mësimore]</i>, <i>[Ref_076Aksesimi i Sekretarisë Mësimore Online nga Studentët]</i>, <i>[Ref_075 Model Formularesh ne Sherbim te Studentit nga</i>

	<i>Sekretaria], [Ref_114 Infrastruktura dhe Sherbime IT ne FIMIF], [Ref_115 Model Njoftimesh në Faqen Web të FIMIF].</i>
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	UPT dhe FIMIF menaxhojnë dokumentacionin dhe aktivitetet e personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ në përputhje me ligjet dhe rregulloret për mbrojtjen e të dhënave personale <i>[Ref_001 Statuti i UPT]</i>. UPT administron regjistrin bazë të punonjësve dhe ndjek procedurat për kontratat e punës <i>[Ref_003 Kodi i Etikës i UPT]</i>. Sekretaria e dekanit të FIMIF-së, mban, ruan dhe administron, në përputhje me rregullat zyrtare, të gjithë dokumentacionin e departamentit si njësi administrative, ashtu edhe ato të stafit akademik që lidhen me procesin mësimor dhe administrative, sipas akteve ligjore dhe nënligjore. <i>[Ref_031 Rregullore Njesia Kryesore FIMIF]</i>. Përgjegjësi i departamentit plotëson dhe nënshkruan realizimin e ngarkesës mësimore, semestrale dhe vjetore të anëtarëve të departamentit, miraton planet mësimore kalendarike dhe marrëveshjen e punës, miraton tezat e provimeve, organizon aktivitete të ndryshme shkencore ose veprimtari të tjera që lidhen me funksionimin administrativ të departamentit dhe të procesit mësimor si dhe angazhohet për të lidhur marrëveshje me institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit <i>[Ref_032 Plani Strategjik Njesia Kryesore 2019-2024 FIMIF]</i>, <i>[Ref_033 Plani i Zhvillimit të Strategjise 2019-2024 FIMIF]</i>. Për sa i përket komunikimit shkresor zyrtar, në Universitetin Politeknik të Tiranës, administrimi i dokumentacionit bëhet nga Sektori i Arkivit dhe Protokollit në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Juridike sipas përcaktimeve në legjislacionin përkatës në fuqi <i>[Ref_031 Rregullore Njesia Kryesore FIMIF]</i>.
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Për të siguruar akses në materialet e kursit, detyrat, notat dhe burimet akademike për dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e regjistruar në programin e studimit UPT. Specifikisht FIMIF zbaton një sistem të sigurt të vërtetimit të përdoruesit për të verifikuar identitetin e stafit dhe studentëve që hyjnë në sistemin e menaxhimit dhe siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në Inxhinierinë Fizike <i>[Ref_076 Aksesimi i Sekretarisë Mesimore Online nga Studentet]</i>
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	Çdo përdorues ka një kod llogarie dhe një fjalëkalim fillestar unik. Pasi të marrin këto të dhëna, përdoruesit mund të menaxhojnë llogaritë e tyre në mënyrë të pavarur në platformën bit-albania.com. Studentët që regjistrohen në platformën e bit-albania.com kanë një llogari personale me emrin e tyre të plotë siç është regjistruar në regjistrin e sekretarisë. Në seksionin UPT të platformës bit-albania.com, studentët mund të përfitojnë nga një gamë shërbimesh. Ata mund të kontrollojnë gjendjen e tyre aktuale me rezultate (përfshirë pagesën e detyrimeve,

	frekuentimin dhe notat e tyre). Baza e të dhënave azhmonohet në internet pas çdo skanimit të procesverbaleve të detyrimeve apo provimeve, për të siguruar që nuk ka probleme gjatë paraqitjes së studentit në provim. Studentët kanë mundësinë të kontaktojnë në çdo kohë Sekretarinë Mësimore dhe të marrin të gjitha informacionet e tyre në platformën e dedikuar bit-albania.com. <i>[Ref_076 Aksesimi i Sekretarise Mesimore Online nga Studentet]</i>. Universiteti ka integruar platformën "bit-albania.com" për të lehtësuar komunikimin dhe shkëmbimin e informacionit midis stafit akademik dhe studentëve. Në fund të çdo semestri, zhvillohet një anketim studentor përmes kësaj platforme për të marrë komente dhe opinionet e studentëve mbi përmbajtjen e lëndëve dhe metodat e mësimdhënies. Studentët njoftohen me email për fillimin dhe përfundimin e anketimit dhe duhet të përgjigjen pyetjeve të hartuara nga Sektori i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në UPT për secilin pedagog që jep mësim. Mungesa në pjesëmarrje në anketim bllokoi përkohësisht aksesin e studentit në të dhënat e tij si një mënyrë për të inkurajuar pjesëmarrjen e gjerë në këtë proces. Komunikimi interaktiv ndërmjet personelit dhe studentëve realizohet duke përdorur platformën e Microsoft Teams, duke krijuar klasat virtuale për çdo klasë fizike <i>[Ref_116 Udhëzuesi i zhvillimit të mësimin në distancë]</i>. Nëpërmjet "Teams" janë zhvilluar seanca mësimore gjatë pandemisë (mësim online) ndërsa me rikthimin në auditor, platforma është përdorur për komunikime mes palëve, ngarkim detyrash/projektesh, njoftime, informacione etj. Gjithashtu gjithë stafi i FIMIF janë të paisur me adresa emaili zyrtare të formatit "<u>shkronja e parë e emrit</u>".mbiemer@fimif.edu.al, dhe studentët me emaile të formatit <u>emër.mbiemer@fimif.edu.al</u>
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Sistemi i menaxhimit ofron një pasqyrë të aktiviteteve akademike dhe administrative në kohë reale. Ky sistem përfshin shifrat e regjistrimit, regjistrimet e kurseve, frekuentimin e studentëve, ngarkesën e fakultetit, shpenzimet buxhetore dhe detyrat administrative. Përmes këtij sistemi gjenerohen raporte individuale bazuar në kritere dhe parametra specifike. Raportet krijojnë një mbulim të gjerë të aspekteve të veprimtarisë akademike dhe administrative, duke përfshirë performancën e studentëve, produktivitetin e fakultetit, transaksionet financiare dhe të tjera. <i>[Ref_093 Informimi i Studentëve Nëpërmjet Platformave Online]</i>. Paneli për monitorimin në kohë reale, platforma "<u>bit-albania.com</u>" (seksioni UPT) kryhen një sërë shërbimesh ndaj studentit. Ai konsultohet në çdo moment me gjendjen aktuale të rezultateve të tij (shlyerjen e detyrimeve, gjendjen e frekuentimit si dhe notat perkatese). <i>[Ref_076 Aksesimi i Sekretarise Mesimore Online nga Studentet]</i>.

Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Informacionet në lidhje me programin e studimit, stafin akademik dhe aktivitetet e ndryshme publikohen në faqen e internetit (https://www.upt.al/) në seksionin fakultete dhe institute), UPT publikon te dhenat e pergjithshme për të gjitha fakultetet dhe institutet e saj, linku pastaj të çon tek faqja e secilit fakultet. Faqja zyrtare web e UPT ka seksionin e gjuhës së huaj (anglisht). FIMIF ka faqen e saj web ku publikon te gjitha informacionet me karakter publik për informimin e studenteve dhe te stafit https://fimif.edu.al/. Aty jepet informacion i plotë në lidhje me programet e studimit të ofruara nga fakulteti, jepen profile tpër anëtarët e stafit akademik. Çdo profil përfshin emrin e anëtarit të stafit, titullin, sfondin arsimor, fushat e ekspertizës, interesat kërkimore, publikimet dhe informacionin e kontaktit. Në faqen web jepn aktivite dhe ngjarje të ndryshme të organizuara nga universiteti, departamentet akademike, organizatat studentore. Kjo mund të përfshijë seminare, konferenca, ngjarje kulturore, projekte të shërbimit në komunitet dhe aktivite të tjera. Faqja mbahet e përditësuar rregullisht. Tek kjo faqe listohen aktivitetet, orari, programet e studimit, organika e secilit departament etj [Ref_093 Informimi i Studentëve Nëpërmjet Platformave Online].			
Konkluzione	GVJ konkludon se: FIMIF si pjesë e UPT, disponon një sistem strukturuar të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit. Ky sistem administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit dhe siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve duke garantuar monitorimin në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe duke mundësuar raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Referuar Ligjit për Arsimin e lartë 80/2015, Institucioni çdo vit miraton tarifat e shkollimit për çdo cikël studimi, referuar specifikisht VKM e miratuar nr. 638 dt 22.07.2015 i ndryshuar. Tarifa e studimit miratohet me vendim të Bordit të Administrimit, pasi është marrë mendimi paraprak i Senatit Akademik të UPT, për çdo program studimi, mbi bazën e propozimeve të njësive kryesore, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Autoriteti që është përgjegjës për raportimin financiar në Universitetin Politeknik të Tiranës është Administratori. Në varësi të tij gjendet administratori i njësive kryesore (në nivel fakulteti), që është autoriteti administrativ përgjegjës për mirëfunksionimin financiar dhe administrativ të saj <i>[Ref_001 Statuti i UPT, Neni 21]</i>. Administratori harton në mënyrë periodike raportin financiar të institucionit i cili paraqitet për miratim si pjesë e raportit vjetor pranë Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit <i>[Ref_100 Buxheti i Detajuar FIMIF 2023-2024], [Ref_131 Procedure Buxheti Afatmesem dhe Miratim Buxheti 2024], [Ref_129 Evidence te Ardhurash dhe Investimesh 21-24 FIMIF]</i>. Në këtë analizë financiare pasqyrohen kostot financiare mesatare për student në nivel universiteti. Nëpërmjet planifikimit të buxhetit për çdo vit pasardhës, i cili realizohet në mënyrë periodike, si rregull në përfundim të vitit, kjo strukturë ndër të tjera harton edhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të vitin pasardhës si dhe harton buxhetin afat mesëm, i cili mbulon një periudhë tre vjecare, cka jep mundësinë për një plan mbështetjeje financiare për të paktën një cikël të plotë studimi. Vlerësohet efektiviteti i planit të mbështetjes financiare në fund të ciklit të studimit. Vlerësohet nëse qëllimet financiare janë përmbushur, burimet janë përdorur në mënyrë efektive dhe objektivat janë arritur <i>[Ref_100 Buxheti i Detajuar FIMIF 2023-2024], [Ref_129 Evidence te Ardhurash dhe Investimesh 21-24 FIMIF]</i>.
Kriteri 2. Plani i financimit të njësive bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të	Fakulteti i Inxhinierise Matematike dhe Inxhinierise Fizike ka hartuar dhe aprovuar planin e tij strategjik për periudhën 20-24 <i>[Ref_032 Plani Strategjik Njesia Kryesore 2019-2024 FIMIF], [Ref_033 Plani i Zhvillimit te Strategjise 2019-2024 FIMIF]</i> i cili është pjesë integrale e planit strategjik të <i>[Ref_004 Plani Strategjik 2019-2024 UPT]</i>. Në planin strategjik të FIMIF bëhet një analizë e detajuar e gjendjes aktuale dhe asaj strategjike, duke e ndarë këtë të fundit në një planifikim afatshkurtër dhe në një planifikim afatgjatë. Institucioni mbështet stafin akademik në ngritjen e tyre profesionale duke i mbështetur në

procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	pjesëmarrjet e tyre në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare apo në lidhje të marrëveshjeve bashkëpunimi me universitete të tjera ndërkombëtare [Ref_005 Rregullore e Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik të UPT], [Ref_010 Marrëveshjet Institucionale UPT], [Ref_063 Procedure Mbeshtetje Stafit per Kerkim Shkencor DIF], [Ref_097 Pjesëmarrja në Projekte dhe Trajnime, Mobilitete të Stafit Akademik dhe Studentëve FIMIF]. Universiteti Politeknik i Tiranës nuk harton një plan financiar të dedikuar një programi studimi specifik, por ky plan vjen si pjesë integrale e planit financiar të njesise kryesore dhe si rregull përmban financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij [Ref_100 Buxheti i Detajuar FIMIF 2023-2024], [Ref_131 Procedure Buxheti Afatmesem dhe Miratim Buxheti 2024], [Ref_129 Evidence te Ardhurash dhe Investimesh 21-24 FIMIF].
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Me qëllim ruajtjen e transparencës, dhe qëndrueshmërisë financiare brenda institucionit universitar, kryhen audite periodike, vlerësime dhe dokumentime të financimit dhe efektivitetit financiar. Organigrama e UPT e ka të specifikuar qartë pozicionin dhe varësinë e autoritetit të auditimit të brendshëm, i cili është nën varësinë e bordit të administrimit [Ref_007 Organigrama e UPT]. Statusi organizativ, qëllimi, misioni, objektivat e punës, përgjegjshmëria dhe përgjegjësitë e njësive së auditimit të brendshëm përcaktohen në Kartën e Auditit të Brendshëm të Universitetit Politeknik të Tiranës, e cila miratohet nga Bordi i Administrimit [Ref_001 Statuti i UPT]. Raporti financiar i cili realizohet në mënyrë periodike, përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare. Ky raport paraqitet prej Administratorit të universitetit pranë Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit. UPT, publikon çdo vit raportin e vet për veprimtarinë financiare të universitetit dhe e ve atë në dispozicion të publikut. Të dhënat mbi veprimtarisë financiare prokurimet dhe buxhetet, bëhet publike përmes programit të transparencës në faqen zyrtare të UPT, përmes lidhjes [http://www.upt.al/rrethnesh/programi-i-transparences] dhe në portalin [https://u-transparenca.al/].
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë	Universiteti Politeknik UPT, ka përgjegjëse dhe funksionale Drejtorinë Ekonomike, struktura e posaçme për menaxhimin financiar të tij dhe

përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	zbatimin e politikës financiare, bazuar në Ligjin 80/2015, Ligjin Nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë “dhe Udhëzimin Nr. 2 datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”. Drejtoria Ekonomike ndjek zbatimin e të gjitha procedurave financiare të lidhura me planifikimin dhe realizimin e buxhetit në UPT (https://upt.al/dega-finance). Përmes kësaj drejtorie, UPT analizon treguesit e monitorimit për zbatimin e politikës financiare dhe ndjek ecurinë financiare me qëllim realizimin e objektivave të fakulteteve. Dokumenti i analizës financiare të bërë prej universitetit në fund të çdo vit, miratohet e më pas protokollohet e ruhet në arkivën e vetë universitetit, në respektim të akteve ligjore dhe nënligjore për arkivë–protokollin. Vlen për t'u theksuar se kjo analizë bazohet mbi propozimet e bera nga njesite kryesore dhe ato baze si dhe parashikimet e projekt-buxhetit afatmesem, pra ai nuk përshkruan vetëm periudhën korente, por ka edhe një natyrë krahasuese për shumicën e zërave të buxhetit me periudhat ushtrimore të shkuara, cka do të thotë se të jep mundësinë për të gjykuar mbi raportet financiare të tre viteve të kaluara akademike dhe të planifikojë ndërhyrje të posacme dhe diversifikimin eventual të financimit të secilit program studimi për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij <i>[Ref_100 Buxheti i Detajuar FIMIF 2023-2024], [Ref_131 Procedure Buxheti Afatmesem dhe Miratim Buxheti 2024], [Ref_129 Evidence te Ardhurash dhe Investimesh 21-24 FIMIF]</i>.
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësive bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.	Universiteti Politeknik i Tiranës (UPT) ka burime financiare dhe kapacitete menaxhimi të qëndrueshme. Analizimi i treguesve të zbatimit të politikave financiare kryhet në mënyrë të vazhduar nga Drejtoria Ekonomike. Mesatarisht, rreth 66% e buxhetit financohet nga shteti dhe rreth 34% gjenerohet nga UPT. Buxheti vjetor i UPT ka pësuar një rritje të vazhdueshme prej 8-10% në vit gjatë viteve të fundit. Nga të ardhurat e gjeneruara vetë nga UPT, 53% burojnë nga tarifat e shkollimit. <i>[Ref_VI.ANEKS Tabelat permbledhese per RVB Bch.IF, Tabela 18]</i>. Në këto të ardhura, peshë të rëndësishme zënë shërbimet për të tretë. Këto shërbime përfshijnë konsulenca dhe ekspertiza që ofrohen përmes personelit të UPT dhe përmes infrastrukturës laboratorike dhe shkencore që institucioni disponon. Personeli akademik i UPT mbulon fusha ekspertize të lidhura me planifikimin e territorit, projektimin, mbikëqyrjen, kolaudimin, kryen oponenca teknike për projektet e veprave të ndërimit, analiza inxhinierike e laboratorike, shërbime konsulencash të kërkimit e zhvillimit, programe të studimit të vazhduar dhe shërbime të tjera për të cilat UPT disponon <i>[Ref_117 Tipologjia e shërbimeve ndaj të tretëve, UPT]</i>.

	Burimet e financimit të Universitetit Politeknik të Tiranës, si institucion publik, janë të percaktuara në statutin e tij, nën 25, pika 1, që përfshijne: Te ardhura nga buxheti i shtetit si dhe te ardhura te siguruar nga universiteti që përfshijne tarifat studentore, të ardhurat nga shërbime të tjera që ofron institucioni si dhe te ardhura te perfituara nga aktivitete te ligjshme, ne perputhje me statutin e ketij te fundit [Ref_VI. ANEKS_Tabelat permbledhese per RVB_Bch.IF, Tabela 18], [Ref_100 Buxheti i Detajuar FIMIF 2023-2024], [Ref_131 Procedure Buxheti Afatmesem dhe Miratim Buxheti 2024], [Ref_129 Evidence te Ardhurash dhe Investimesh 21-24 FIMIF]. Referenca [Ref_VI. ANEKS_Tabelat permbledhese per RVB_Bch.IF, Tabela 18], pasqyron qartë gjendjen financiare dhe kolonat e saj të institucionit, duke evidentuar një gjendje luhatjeje rreth një pike ekuilibri. Është e qartë se duhet të krijohen lehtësira të mëtjeshme ligjore në mënyrë që UPT, si dhe Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike të bëhen pjesë e zixhirit të ekonomisë, duke mundësuar kështu rritjen e të ardhurave, rritjen e investimeve, përmirësimin e infrastruktures, rritjen e cilësisë dhe thithjen e më shumë studentëve për drejtimet e studimit teknike, në mënyrë të veçantë edhe studentë të huaj.
Konkluzione	GVJ konkludon se: UPT harton një raport financiar të kostove të njëjësive të tij bazë dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi. Plani i financimit të te FIMIF përmban financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë. Kryerja e auditimeve periodike, vlerësimeve dhe dokumentacionit të financimit dhe efektivitetit financiar është thelbësor për ruajtjen e transparencës, dhe qëndrueshmërisë financiare brenda institucionit universitar. Organigrama e UPT e ka të specifikuar qartë pozicionin dhe varësinë e autoritetit të auditimit të brendshëm, i cili është nën varësinë e bordit të administrimit. UPT raporton nëpërmjet Drejtorisë Ekonomike deri në nivelin e FIMF dhe fakulteteve të tjerë, mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës. UPT garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të FIMF dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale programit Bachelor në Inxhinierinë Fizike. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të

	<i>posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	UPT dhe FIMIF si pjesë e tij, ka hartuar dhe zbaton politika dhe procedura që rregullojnë veprimtarinë e institucionit dhe studentëve në programin e studimeve Bachelor në Inxhinierinë Fizike, bazuar në legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore, Duke synuar mbulimin e plotë të cikleve të studimit, UPT ka hartuar një sërë dokumentash bazë. - Në Statutin e UPT, kreu VI – <i>Studenti i UPT</i> dhe kreu VII – <i>Organizimi i studimeve në UPT</i>, i dedikohen plotësisht studentit dhe organizimit të studimeve [Ref_001 Statuti i UPT]. - Rregullorja e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies në UPT, i dedikohet tërësisht zhvillimit dhe menaxhimit të programeve të studimit dhe të procesit mësimor, nga hyrja deri në dalje (diplomim) [Ref_002 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT]. - Në Planin Strategjik 2019-2024 të UPT, kreu IV – <i>Menaxhimi i procesit të mësimdhënies në UPT</i>, i dedikohet mësimdhënies për studentët [Ref_004 Plani Strategjik 2019-2024 UPT]. Në nivel fakulteti (FIMIF), për menaxhimin e programit të studimit Bachelor në Inxhinierinë Fizike, është hartuar dhe zbatohet, -Rregullorja e programit të studimit në Bachelor në Inxhinierinë Fizike [Ref_038 Rregullore e Programit të Studimit Bch.IF]. Në mbarëvajtjen e programit të studimit, ndikojnë hartimi dhe zbatimi i strategjive në nivel fakulteti (FIMIF) dhe departamenti (DIF). [Ref_032 Plani Strategjik Njësia Kryesore 2019-2024 FIMIF], [Ref_033 Plani i Zhvillimit të Strategjisë 2019-2024 FIMIF],

	<i>[Ref_035 Plani Strategjik Njësia Bazë 2019-2024 DIF], [Ref_036 Plani i Zhvillimit të Strategjisë 2019-2024 DIF].</i> Për kontrollin dhe zbatimin e rregulloreve dhe strategjive të mësipërme, në UPT janë ngritur dhe funksionojnë struktura të posaçme, si Drejtoria e Kurrikulave, Drejtoria e Komunikimit dhe Kordinimit, Drejtoria e Sigurimit të Brendëshëm të Cilësisë <i>[Ref_007 Organigrama e UPT]</i>. Në nivel fakulteti (FIMIF), hallkat përgjegjëse për mbarëvajtjen e procesit mësimor janë Sekretaria mësimore, Sigurimi Cilësisë, <i>[Ref_029 Organigrama FIMIF]</i>. Për t'u ardhur në ndihmë sidomos studentëve të rinj, UPT ka hartuar gjithashtu edhe Guidën e studentit <i>[Ref_008 Guida studentore UPT]</i> e cila rinovohet çdo vit. Megjithatë vihet re një renie e vazhdueshme e numrit të studentëve të regjistruar në këtë program studimi, gjë e cila ul mundësinë e përzgjedhjes së studentëve me rezultate të larta duke ndikuar në këtë mënyrë në cilësinë e tyre.
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Kriteret e pranimit janë të përgjithshme dhe të zbatueshme për çdo kandidat që aplikon në një program studimi në UPT dhe bazohet në legjislacionin në fuqi dhe në rregulloret e brendshme të tij. Kriteret vendosen mbështetur në një analizë periodike të gjendjes aktuale, duke synuar përthithjen e kandidatëve me rezultate të larta. Për çdo vit akademik, kriteret e pranimit në programin e studimit Bachelor në Inxhinierinë Fizike, propozohen nga Departamenti i Inxhinierisë Fizike (DIF) <i>[Ref_002 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT]</i>. <i>[Ref_038 Rregullore e Programit të Studimit Bch.IF]</i>. Ato më pas, miratohen në Dekanatin e FIMIF dhe në senatin akademik SAUPT <i>[Ref_002 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT Neni 19, Neni 20]</i>, <i>[Ref_118 Procedurë Miratimi e Kriteve të Pranimit të Studentëve]</i>. Kriteret e pranimit shpallen nga UPT dhe vihen në dispozicion të Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe të portalit Rrjeti Akademik Shqiptar. Regjistrimi i studentëve në programin e studimeve Bachelor në Inxhinierinë Fizike kryhet pranë Sekretarisë Mësimore të FIMIF duke zbatuar renditjen sipas listave të publikuara të studentëve fitues, nëpërmjet një procesi transparent dhe jo diskriminues. Procesi i mësipërm garanton barazi dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë në programin e studimit Bachelor në Inxhinierinë Fizike. Ai mundëson një konkurrencë të drejtë, bazuar në vlerat individuale të çdo kandidati për student. Publikimi i procedurës së pranimit në faqen web të UPT (http://upt.al) dhe atë të FIMIF (http://fimif.edu.al) <i>[Ref_115 Model Njoftimesh në Faqen Web të FIMIF]</i>, shërben gjithashtu për garantimin e barazisë dhe drejtësisë në ofrimin e shërbimeve ndaj studentit.

Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.	Kriteret për përzgjedhjen e studentëve në programin e studimit Bachelor në Inxhinierinë Fizike hartohen nga DIF dhe miratohen në dekanatin e FIMIF, e më pas në Senat (SAUPT) <i>[Ref_088 Raporti i Verifikimit të Kapaciteteve Pritëse për Kuotat 22-23], [Ref_118 Procedurë Miratimi e Kriterëve të Pranimi të Studentëve]</i>. Kriteret e pranimi në programin e studimit Bachelor në Inxhinierinë Fizike, hartohen dhe bëhen publike një vit përpara se ato të hyjnë në fuqi. Kjo u mundëson maturantëve një orientim më të drejtë për zgjedhjet e tyre. Kriteret e pranimi shpallen nga UPT në faqen web të tij, <i>[http://upt.al/bashkepunime/aktivitete/1584-njoftim-kriteret-e-pranimi-ne-programet-e-studimit-te-ciklit-te-pare-dhe-programet-e-integruara-te-studimit-te-ciklit-te-dyte-te-ofruara-nga-fakultetet-e-upt-se-per-vitin-akademik-2023-2024]</i> Për të siguruar një bashkëpunim të ngushtë me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse, kriteret e pranimi vihen gjithashtu në dispozicion të Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe në portalin e Rrjetit Akademik Shqiptar. Duke synuar një aksesim sa më të shpejtë të këtyre kriterëve nga maturantët, ato u bëhen të njohura maturantëve edhe përmes aktiviteteve të ndryshme të informimit me ta (Panairt Work & Study) <i>[Ref_113 Raporti Vjetor i Zyrës së Karrierës FIMIF 21-22, 22-23, 23-24]</i>. Megjithatë GVJ konstaton mungesën e moduleve / lëndëve në gjuhë të huaj në këtë program studimi çka e bë të pa mundur regjistrimin e studentëve të huaj.
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimi dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Kriteret e pranimi në programin e studimit Bachelor në Inxhinierinë Fizike, propozohen nga DIF, pas analizimit të kushteve konkrete dhe duke synuar përthithjen e kandidatëve me rezultate sa më të larta. Pas propozimit nga DIF, këto kritere miratohen në Dekanatin e FIMIF e më pas, në senat SAUPT. <i>[Ref_088 Raporti i Verifikimit të Kapaciteteve Pritëse për Kuotat 22-23], [Ref_118 Procedure Miratimi e Kriterëve të Pranimi të Studentëve] [Ref_002 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT, Neni 19, Neni 20]</i>. Kriteret e pranimi shpallen nga UPT dhe vihen në dispozicion të Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe në portalin e Rrjetit Akademik Shqiptar. Njohja e plotë apo e pjesshme e krediteve të studentëve që vijnë me transferim nga programe të tjera studimi brenda ose/dhe jashtë UPT-së u mundësohet studentëve sipas Rregullores së Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies e UPT <i>[Ref_002 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT, Kreu VI]</i>. Në fillim të çdo viti akademik, pranë DIF, ngrihet një komision <i>ad-hoc</i> për ekuivalentimin dhe njohjen e lëndëve/krediteve për programin e studimit Bachelor në Inxhinierinë Fizike <i>[Ref_039 Vendimi për Emërimin e KPS të Bch.IF], [Ref_069 Procedurë mbi Zgjedhjen e Drejtuesve të Grupeve</i>

	Kërkimore Shkencore IF]. Ky komision shqyrton dokumentacionin e studentit dhe kryen ekuivalentimet përkatëse. Të gjitha strukturat e UPT dhe fakultetit FIMIF që kanë lidhje direkte me informimin dhe pranimin e studentëve të rinj, si zyrat e karrierës, sekretaritë mësimore dhe zyrat e financës, kanë të publikuara oraret e pritjes së studentëve me qëllim plotësimin e nevojave të tyre. Të angazhuar plotësisht në informimin dhe pranimin e studentëve të rinj, janë sigurisht departamenti DIF, si dhe i gjithë stafi akademik i FIMIF [Ref_113 Raporti Vjetor i Zyrës së Karrierës FIMIF 21-22,22-23,23-24]. Kriteret, procedurat e pranimin dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku, në faqen web të UPT [https://upt.al] dhe FIMIF [https://fimif.edu.al/info]. Guida e studentit është gjithashtu një instrument i rëndësishëm për informimin e studentëve për përparimin e tyre gjatë studimeve [Ref_119 Broshura dhe Guida Informuese për Studentët FIMIF], [Ref_008 Guida studentore UPT]. Ndihmë në procesin e informimit dhe orientimit të studentëve japin edhe strukturat e këshillimit të karrierës, të cilat operojnë në nivel UPT dhe fakulteti (Specialisti Karrierës) [Ref_112 Rregullore e Këshillimit të Karrierës FIMIF], [Ref_022 Rregullore për Këshillin Studentor UPT].
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Përmes Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe në bashkëpunim me grupet e informimit të maturantëve pranë fakulteteve, UPT në çdo fillim viti (periudha Shkurt – Mars), përpara se maturantët të plotësojnë formularët e aplikimit për studime në universitet, organizon takime promovuese me kandidatët për studentë, pranë mjediseve të shkollave të mesme në shkallë vendi. [Ref_112 Rregullore e Këshillimit të Karrierës FIMIF], [Ref_113 Raporti Vjetor i Zyrës së Karrierës FIMIF 21-22,22-23,23-24]. Këto aktivitete realizohen në bashkëpunim me Drejtoritë Arsimore përkatëse dhe në to jepet një informacion i detajuar për çdo program studimi që ofron FIMIF, përfshirë edhe programin e studimit Bachelor në Inxhinierinë Fizike. Për të informuar publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit Bachelor në Inxhinierinë Fizike, organizohen gjithashtu edhe takime pranë Qendrave Rinore. Këto takime shoqërohen me shpërndarjen e broshurave dhe fletëpalosjeve informuese, përgatitur nga FIMIF, në bashkëpunim me DIF [Ref_119 Broshura dhe Guida Informuese për Studentët FIMIF]. UPT mban lidhje të vazhdueshme me Drejtoritë Arsimore Rajonale dhe Zyrat Arsimore për të ndarë me to,

	informacionin në lidhje me aktivitetet informuese për maturantët kandidatë për studentë të ardhshëm të UPT. Aktivitetet e sipërpërmendura gjejnë pasqyrim edhe në faqen web të UPT [https://upt.al] dhe FIMIF [https://fimif.edu.al/info], [Ref_093 Informimi i Studentëve Nëpërmjet Platformave Online].
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	Si një ndër insitucionet elitare të arsimit të lartë publik në vend, UPT operon në përputhje me aktet nënligjore në fuqi dhe aktet e brendshme të veta, në të cilat parashikohen politikat për përrthithjen, mbështetjen dhe promovimin e studentëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara. [Ref_002 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT] . Kriteret specifike për programin e studimit Bachelor në Inxhinierinë Fizike përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit, Kreu V, Neni 42 [Ref_034 Rregullore Njësia Bazë DIF] . Pranimi në programin Bachelor në Inxhinierinë Fizike është i mundur për çdo kandidat, i cili ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm ose zotëron një diplomë tjetër studimi të fituar jashtë vendit, të vlerësuar nga ministria përgjegjëse për arsimin e lartë, si ekuivalente me të dhe që plotëson kriterin/kriteret shtetërore, në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. Rregulloret e mësipërme janë hartuar në përputhje me aktet ligjore në fuqi për arsimin e lartë dhe maturën shtetërore.
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	Në propozimin e kuotave të pranimit të studentëve të rinj, ato për transferim studimesh apo program të dytë studimi, UPT ndjek një politikë të tillë, sipas të cilës 10% e kuotave maksimale të alokuara për çdo program studimi u lihet në dispozicion kategorive të veçanta të studentëve, të tilla si ato që u përkasin kandidatëve nga trojet shqipfolëse jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë, shtetasve të huaj, ato që vinë nga shtresat në nevojë dhe kandidatëve me aftësi të veçanta [Ref_065 Miratimi i Kuotave të Pranimit 2023-2024] , [Ref_088 Raporti i Verifikimit të Kapaciteteve Pritëse për Kuotat 22-23] , [Ref_118 Procedurë Miratimi e Kriteve të Pranimit të Studentëve] .
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	Ndërkohë për studentët me rezultate të larta apo ato që vijnë nga shtresa në nevojë, në zbatim të politikave mbështetëse të Qeverisë Shqiptare, sigurohet mbështetja me bursa. Studentët që ndjekin programin e studimit Bachelor në Inxhinierinë Fizike, mbështeten gjithashtu financiarisht nga Qeveria Shqiptare, pas përfshirjes së këtij programi studimi në listën e programeve kombëtare me interes kombëtar. [Ref_125 VKM nr.386 datë 01.06.2022] , [Ref_101 Të Dhëna mbi Studentët e Trajtuar Financiarisht] .
Konkluzione	GVJ konkludon se: UPT dhe FIMIF si pjesë e tij, ka hartuar dhe zbaton politika dhe procedura që rregullojnë veprimtarinë e institucionit dhe studentëve në programin e studimeve Bachelor në Inxhinierinë Fizike.

	Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit. UPT dhe FIMIF publikojnë përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimit Bachelor në IF. UPT bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj, por GVJ konstaton mungesën e lëndëve në gjuhë të huaj, gjë e cila e vështirëson regjistrimin e studentëve të huaj në këtë program studimi. Kriteret e pranimit në programin e studimit Bachelor në Inxhinierinë Fizike, propozohen nga DIF, pas analizimit të kushteve konkrete dhe duke synuar përthithjen e kandidatëve me rezultate sa më të larta, megjithatë GVJ konstaton se numri i maturantëve që aplikojnë për këtë program studimi dhe numri i studentëve të regjistruar është në rënie të vazhdueshme, gjë e cila ul mundësinë e përzgjedhjes së studentëve me rezultate të larta duke ndikuar në këtë mënyrë në cilësinë e tyre. Pas propozimit nga DIF, këto kritere miratohen në Dekanatin e FIMIF e më pas, në senat SAUPT. Kriteret e pranimit shpallen nga UPT dhe vihen në dispozicion të Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe në portalin e Rrjetit Akademik Shqiptar. Përpara fillimit të çdo viti akademik, FIMIF informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit Bachelor në Inxhinierinë Fizike. UPT harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara apo edhe kandidatëve nga shtete të tjera. UPT gjithashtu harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për universitetin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e	Për programin e studimit Bachelor në Inxhinierinë Fizike, kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin, janë të përcaktuara në Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT [Ref_002 Rregullore e

përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT, Nenet 37 & 38]. Këto kritere e procedura janë publike dhe në faqen web të UPT (http://upt.al/kushtet-e-kalimit-ne-vitin-pasardhes). Platforma BIT-ALBANIA e ofruar nga RASH (https://upt.Bit-Albania.rash.al/login dhe https://bit-albania.com/upt6.php), që gjithashtu shfrytëzohet nga studentët, u mundëson atyre akses të plotë mbi kriteret dhe procedurat e përparimit akademik dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. Në FIMIF funksionon Zyra e Këshillimit të karrierës [Ref_112 Rregullore e Këshillimit të Karrierës FIMIF] e cila, përmes specialistit të saj, ofron gjithë informacionet e nevojshme për përparimin akademik të studentëve. Përveçse me kërkesë të drejtpërdrejtë të studentit, këto kritere dhe procedura bëhen publike edhe në takimet periodike informuese që organizon specialisti i kësaj zyre [Ref_113 Raporti Vjetor i Zyres se Karrieres FIMIF 21-22,22-23,23-24]. Në procesin e informimit të studentëve për kriteret e procedurat e përparimit të tyre akademik dhe kalimit nga një vit në tjetrin, një ndihmesë të veçantë jep edhe Koordinator i Programit të Studimit, i cili është një anëtar i DIF, i caktuar nga Drejtuesi i Njesisë Bazë dhe që është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit të studimit Bachelor në Inxhinierinë Fizike [Ref_034 Rregullore Njësia Bazë DIF]. Një informacion i gjerë dhe i larmishëm studentëve u ofrohet edhe në Guidën Studentore [Ref_119 Broshura dhe Guida Informuese për Studentët FIMIF], [Ref_008 Guida studentore UPT]. Si rregull, në fillim të çdo viti akademik DIF organizon takime informuese me studentët e rinj të programit të studimit Bachelor në Inxhinierinë Fizike. Në këto takime, studentët informohen gjithashtu në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të tyre dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Kriteret dhe procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme edhe për programin e studimit Bachelor në Inxhinierinë Fizike, përcaktohen në mënyrë të hollësishme në Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT [Ref_002 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT], si dhe në Rregulloren Mësimore të Programit të Studimit të Ciklit të Parë, në Inxhinierinë Fizike [Ref_038 Rregullore e Programit të Studimit Bch.IF]. Këto kritere e procedura janë të publikuara dhe mund të aksesohen nga studentët e programit të studimit Bachelor në Inxhinierinë Fizike në faqen web të UPT (http://upt.al/transferime) si dhe në faqen web të FIMIF(https://fimif.edu.al/info/regjistrimettransferime) [Ref_115 Model Njoftimesh në Faqen Web të FIMIF]. Informacion në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme, ofrohen gjithashtu edhe nga strukturat e tjera të FIMIF si: Zv. Dekani për anën mësimore, Sekretaria Mësimore, Zyra

	e Karrierës, etj. Këto struktura kanë të shpallura oraret e pritjes dhe informimit të studentëve. Në lidhje me kriteret dhe procedurat e mësipërme, studentët e programit të studimit Bachelor në Inxhinierinë Fizike, mund të gjejnë një informacion të gjerë e të larmishëm edhe në broshurat dhe guidat informuese, të përgatitura nga FIMIF <i>[Ref_119 Broshura dhe Guida Informuese për Studentët FIMIF]</i>.
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve përcaktohen në mënyrë të hollësishme në Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT <i>[Ref_002 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT]</i>. Këto kriteret e procedura janë të publikuara dhe mund të aksesohen nga studentët e programit të studimit Bachelor në Inxhinierinë Fizike në faqen web të UPT (http://upt.al/sesionet-e-provimeve) si dhe në faqen web të FIMIF (https://fimif.edu.al/info) <i>[Ref_115 Model Njoftimesh në Faqen Web të FIMIF]</i>. FIMIF ka hartuar dhe zbaton një procedurë të veçantë për vlerësimin e dijeve <i>[Ref_054 Udhëzues për Provimin e Formimit Final Bch.IF]</i>. Ky dokument mund të aksesohet nga studentët në faqen web të FIMIF (https://fimif.edu.al/info). Në fillim të çdo semestri, pedagogët që mbulojnë lëndët e programit të studimit Bachelor në Inxhinierinë Fizike, u ofrojnë studentëve një informacion të përditësuar mbi kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive në këtë program studimi, duke prezantuar përpara tyre syllabuset e lëndëve që ato mbulojnë <i>[Ref_044-046 Programet Lëndore (Syllabuse) Bachelor IF 21-24]</i>. Informacionin e mësipërm, studentët e programit të studimit Bachelor në Inxhinierinë Fizike, mund ta sigurojnë edhe online, përmes Sekretarisë Mësimore të FIMIF <i>[Ref_076 Aksesimi i Sekretarisë Mësimore Online nga Studentët]</i>. Si rregull, në fillim të çdo viti akademik DIF organizon takime informuese me studentët e rinj të programit të studimit Bachelor në Inxhinierinë Fizike. Në këto takime, studentët informohen në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të tyre në programin e studimit Bachelor në Inxhinierinë Fizike.
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Në Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT, përshkruhen kriteret e përgjithshme dhe procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit <i>[Ref_002 Rregullorja e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies e UPT, Kreu VIII]</i>. Këto kriteret e procedura janë të aksesueshme dhe në faqen web të UPT (http://upt.al/diplomimi). DIF ka hartuar dhe zbaton një procedurë të veçantë për diplomimin e studenteve Bachelor në Inxhinierinë Fizike, me anë të provimit të formimit <i>[Ref_054 Udhëzues për Provimin e Formimit Final Bch.IF]</i>. Kjo procedurë është e aksesueshme, si për stafin akademik, ashtu edhe për studentët në faqen web të FIMIF (https://fimif.edu.al/info/). Sekretaria Mësimore dhe Zyra e Karrierës

	së FIMIF informon gjithashtu studentët në lidhje me këto kritere dhe procedura. DIF tregon një kujdes të veçantë në informimin e studentëve të programit të studimit Bachelor në Inxhinierinë Fizike, mbi kritetet që duhen përmbushur për provimin e formimit dhe këtë e realizon përmes stafit të tij, faqes web të FIMIF dhe takimeve periodike me to. Këto kritere janë publike e të aksesueshme në çdo kohë, por ky komunikim i DIF me studentët intensifikohet përgjatë semestrit të parë të vitit të tretë. Para provimit të formimit, secili nga pedagogët e angazhuar me mësimdhënie në programin e studimit Bachelor në Inxhinierinë Fizike, zhvillon konsultime për lëndën e tij [Ref_053 Procedurë Konsultimi për Provimin e Diplomës në Bch. IF].
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Njësi strukturore mbështetëse, që ka për mision mbështetjen e Njësive Kryesore dhe Njësive Bazë të UPT është Drejtoria e Komunikimit dhe Koordinimit [Ref_007 Organigrama e UPT]. Kjo drejtori planifikon dhe organizon veprimtari në fushën e bashkëpunimit me palët e interesuara, të marrëveshjeve dhe projekteve të përbashkëta në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, në koordinim me strukturat dhe organet e UPT-së (http://upt.al/sherbimi-i-rrjetit). Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, kjo drejtori harton dhe publikon Guidën Studentore të UPT (http://upt.al/bashkepunime/aktivitete/1456-njoftim-publikohet-guida-studentore-2021-2022), për t'u ardhur në ndihmë studentëve, sidomos atyre të viteve të para [Ref_008 Guida studentore UPT]. Për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit Bachelor në Inxhinierinë Fizike, takime informuese periodike organizon edhe Zyra e Karrierës FIMIF [Ref_113 Raporti Vjetor i Zyrës së Karrierës FIMIF 21-22, 22-23, 23-24]. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, UPT dhe FIMIF si pjesë e tij, informojnë kandidatët për studentë dhe gjithë të interesuarit mbi programet e studimit që ofrohen nga UPT, duke organizuar dhe marrë pjesë në aktivitete të ndryshme si Work & Study, Open Day, Ditët e Maturantëve, etj [Ref_119 Broshura dhe Guida Informuese për Studentët FIMIF].
Konkluzione	GVJ konkludon se: Për programin e studimit Bachelor në Inxhinierinë Fizike, kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin, janë të përcaktuara në Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT. Për programin e studimit Bachelor në Inxhinierinë Fizike, kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme, përcaktohen në mënyrë të hollësishme në Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT si dhe në Rregulloren Mësimore të Programit të Studimit të Ciklit të Parë, në Inxhinierinë Fizike. Kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të

	studentëve përcaktohen në mënyrë të hollësishme në Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT. Këto kritere e procedura janë të publikuara dhe mund të aksesohen nga studentët e programit të studimit Bachelor në Inxhinierinë Fizike në faqen web të UPT si dhe në faqen web të FIMIF. DIF informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit Bachelor në Inxhinierinë Fizike. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, UPT dhe FIMIF publikojnë udhëzues të posaçëm dhe organizojnë takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit Bachelor në Inxhinierinë Fizike.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Politikat e informimit të vazhdueshëm të studentëve janë thelbësore për UPT dhe realizohen përmes një larmie formash e mënyrash, si njoftime të ndryshme në faqen web të tij (http://upt.al & http://fimif.edu.al), njoftime në mjediset e fakulteteve, komunikim i drejtpërdrejtë me Përgjegjësit e Departamenteve, takime periodike me pedagogët e angazhuar në programet e ndryshme të studimit, kontakteve të vazhdueshme me pedagogët përgjegjës të grupeve mësimore etj. UPT ka struktura të veçanta, tilla si Sektori i Komunikimit me Publikun apo Sektori i Procesit Mësimor [Ref_007 Organigrama e UPT], të cilat ofrojnë një informacion të vazhdueshëm e të hollësishëm mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programeve të studimeve që ofrohen në Fakultetet e tij. Struktura, organizimi dhe kohëzgjatja e programit të studimit Bachelor në Inxhinierinë Fizike janë të pasqyruara qartë në Rregulloren e këtij programi studimi [Ref_038 Rregullore e Programit të Studimit Bch.IF]. Në fillim të çdo viti akademik DIF organizon takime informuese me studentët e rinj të programit të studimit Bachelor në Inxhinierinë Fizike. Sekretaria Mësimore dhe Zyra e Këshillimit të Karrierës të FIMIF janë struktura ndihmuese për studentët. Për çdo grup mësimor, DIF cakton një pedagog përgjegjës, i cili në cilësinë e një koordinatori, është në kontakt e komunikim të vazhdueshëm me studentët, duke u njohur me çdo shqetësim, mendim apo sugjerim të tyre [Ref_039 Vendimi për

	Emërimin e KPS të Bch.IF]. Detyra e këtyre pedagogëve përgjegjës është informimi i vazhdueshëm i studentëve mbi organizimin dhe mbarëvajtjen e procesit mësimor si dhe diskutimi e shqyrtimi i çdo kërkesë apo sugjerimi të tyre. Në organikën e FIMIF ka edhe një specialist për Alumni dhe Karrierën [Ref_112 Rregullore e Këshillimit të Karrierës FIMIF], [Ref_113 Raporti Vjetor i Zyrës së Karrierës FIMIF 21-22,22-23,23-24], me detyrë kryesore, këshillimin e studentëve për programet e studimit. Specialisti i Karrierës organizon takime të rregullta informimi me studentët, duke respektuar një kalendar të caktuar, i cili bëhet publik. Ndihmesë në informimin e studentëve për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit Bachelor në Inxhinierinë Fizike, jep edhe Guida Studentore, e cila përditësohet përpara çdo viti të ri akademik [Ref_119 Broshura dhe Guida Informuese për Studentët FIMIF], [Ref_093 Informimi i Studentëve Nëpërmjet Platformave Online], [Ref_115 Model Njoftimesh në Faqen Web të FIMIF].
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Në javën e parë të çdo semestri, secili nga pedagogët e angazhuar me mësimdhënie në programin e studimit Bachelor në Inxhinierinë Fizike, informon studentët në lidhje me lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese. Ky informacion që pasqyrohet në trajtë të detajuar edhe në syllabusin e lëndës/modulit, u vihet në dispozicion studentëve [Ref_040-042 Plani Mësimor Bch.IF 21-24], [Ref_044-046 Programet Lëndore (Syllabuse) Bachelor IF 21-24]. Gjithashtu në faqen web të FIMIF (https://fimif.edu.al/info/bachelor), studentët mund të gjejnë informacion të hollësishëm mbi programin e tyre të studimit, si përmes planit mësimor, ashtu dhe rregullores së programit të studimit [Ref_038 Rregullore e Programit të Studimit Bch.IF]. Në faqet web të UPT dhe FIMIF (http://upt.al & http://fimif.edu.al), në hapësirën dedikuar studentëve, gjendet informacion mbi orarin mësimor, orarin e provimeve, kalendarin e vitit akademik, bibliotekën e fakultetit, infrastrukturën dhe shërbimet IT, etj [Ref_115 Model Njoftimesh në Faqen Web të FIMIF], [Ref_074 Model Orari Mësimor], [Ref_073 Model Orar Provimesh Semestral], [Ref_066 Struktura e Procesit Mësimor 23-24], [Ref_114 Infrastruktura dhe Shërbime IT në FIMIF]. Informacion dhe dokumentacion apo udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese, gjenden gjithashtu edhe në Broshurat apo Guidat Informuese të cilat përditësohen në fillim të çdo viti akademik [Ref_119 Broshura dhe Guida Informuese për Studentët FIMIF]. Ndihmë në këtë proces informimi jep edhe specialisti i karrierës përmes takimeve informuese me studentët [Ref_113 Raporti Vjetor i Zyrës së Karrierës FIMIF 21-22,22-23,23-24]. Për çdo informacion, studentët mund të kontaktojnë

	në mënyrë të drejtpërdrejtë ose përmes emailit me pedagogët përgjegjës, Sekretarinë Mësimore, Përgjegjësin e Departamentit apo Zv. Dekanin për anën mësimore etj.
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	UPT ka në fokusin e vet bashkëpunimin me industrinë, biznesin, kompanitë dhe institucionet. Bashkëpunimet mbështeten në marrëveshje të institucionalizuara që ky universitet ka nënshkruar ndër vite. Kështu, që nga viti 2016 e në vazhdim, UPT ka nënshkruar 13 marrëveshje me universitete vendase; 57 marrëveshje me universitete të huaja; 55 marrëveshje me kompani që operojnë në vendin tonë; 15 marrëveshje me institucione shtetërore [Ref_010 Marrëveshjet Institucionale UPT], [Ref_011 Marrëveshjet me Industrinë dhe Institucione UPT], [Ref_009 Marrëveshje me Akademinë e Shkencave UPT], [Ref_062 Marrëveshje Bashkëpunimi me CERN]. Në kuadër të këtyre marrëveshjeve mundësohet realizimi i praktikave mësimore të studentëve, të cilat mund të shërbejnë si pikënisje për punësimin e mëtejshëm të tyre pas diplomimit. DIF mbështet aktivisht zhvillimin e aftësive praktike të studentëve, duke u fokusuar në zhvillimin sa më efikas të praktikave profesionale për ta. DIF nxit dhe mbështet krijimtarinë e studentëve, në partneritet të plotë me biznesin dhe mbi bazën e shanseve të barabarta. Në UPT operon Zyra e Këshillimit të Karrierës [Ref_007 Organigrama e UPT]. Misioni i saj është të orientojë, inkurajojë dhe mbështesë studentët dhe të diplomuarit me mundësi për zhvillimin e tyre vetiak e profesional, përmes informimit, këshillimit, trajnimit dhe udhëzimit të vazhdueshëm. Zyra e Këshillimit të Karrierës është e shtrirë në nivel fakulteti. [Ref_113 Raporti Vjetor i Zyrës së Karrierës FIMIF 21-22,22-23,23-24]. Në mënyrë të vazhdueshme, në faqen web të UPT (http://upt.al/bashkepunime/aktivitete) apo atë të FIMIF (http://fimif.edu.al) publikohen njoftime dhe mundësi për punësime, internship-e, trajnime për studentët etj. Informacion gjendet gjithashtu edhe në Suplementin e Diplomës “Bachelor në Inxhinierinë Fizike” [Ref_052 Supplement Diplome Bch. IF] me të cilën studenti pajiset në përfundim të studimeve. Praktika profesionale, që studentët e programit të studimit Bachelor në Inxhinierinë Fizike realizojnë në përfundim të studimeve, është gjithashtu një tjetër mundësi për njohjen e tregut të punës. Staf i akademik i DIF është i angazhuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në lehtësimin e punësimit të studentëve, kjo falë lidhjeve që ai ruan me sektorë të ndryshëm të industrisë.
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e	UPT dhe FIMIF u ofron studentëve të ciklit të parë një mbështetje të plotë e të vazhdueshme përmes shërbimeve të ndryshme universitare. Për një informim sa më të gjerë e të përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe

procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	shërbimet në funksion të realizimit të tij, çdo grup mësimor studentësh asistohet nga pedagogu përgjegjës, i caktuar nga DIF dhe nga KPS [Ref_034 Rregullore Njësia Bazë DIF], [Ref_039 Vendimi për Emërimin e KPS të Bch.IF]. Në javën e parë të mësimi, pas regjistrimit të tyre, studentët e programit të studimit Bachelor në Inxhinierinë Fizike, pajisen me një email personal (emër.mbiemer@fimif.edu.al), përmes të cilit ato mund të komunikojnë me pedagogët e lëndëve, koordinatoren e programit të studimit apo me drejtues të DIF dhe FIMIF. Një informacion i gjerë e i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij, gjendet edhe në faqet web të UPT dhe FIMIF (http://upt.al & http://fimif.edu.al) [Ref_115 Model Njoftimesh në Faqen Web të FIMIF]. Studentët kanë gjithashtu mundësi të marrin informacion nga Zyra e Karrierës, Sekretaria Mësimore, Dekanati i FIMIF dhe DIF [Ref_113 Raporti Vjetor i Zyrës së Karrierës FIMIF 21-22,22-23,23-24], [Ref_076 Aksesimi i Sekretarisë Mësimore Online nga Studentët]. Një rol të veçantë për një ndihmesë të vazhdueshme të studentëve të programit të studimit Bachelor në Inxhinierinë Fizike luan edhe DIF. Kjo ndihmesë konsiston p.sh., në orientimin që anëtarët e DIF u ofrojnë studentëve në drejtim të thellimit të njohurive në fusha të caktuara, në përcaktimin e lëndëve me zgjedhje apo edhe në kalimet apo transferimet e tyre nga një program studimi në një tjetër.
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Informacioni për studentët e programit të studimit Bachelor në Inxhinierinë Fizike mundësohet përmes platformës së sekretarisë mësimore Bit-Albania e cila ofrohet me mbështetjen e Rrjetit Akademik Shqiptar (https://bit-albania.com/upt6.php). Kjo platformë është lehtësisht e aksesueshme nga studentët edhe në distancë, nëpërmjet përdorimit të “user name” (emër.mbiemer@fimif.edu.al) dhe “password”, me të cilin ato janë pajisur që në javën e parë, pas regjistrimit në këtë program studimi [Ref_076 Aksesimi i Sekretarisë Mësimore Online nga Studentët]. Në kuadër të situatës së krijuar nga pandemia globale COVID-19, në FIMIF u aplikua mësimi online nëpërmjet platformës Microsoft TEAMS [Ref_116 Udhëzuesi i zhvillimit të mësimi në distancë]. Që prej asaj kohe, kjo platformë vazhdon të funksionojë nëpërmjet një sistemi menaxhimi të brendshëm në FIMIF. Kjo platformë, e cila shërbeu si një mjet mjaft efikas për realizimin e mësimi online, vazhdon të përdoret për nevoja të ndryshme komunikimi në distancë, jo vetëm nga studentët e programit të studimit Bachelor në Inxhinierinë Fizike, por edhe nga studentët e tjerë të FIMIF e UPT.

Konkluzione	GVJ konkudon se: UPT ndjek një politikë të informimit të vazhdueshëm të studentëve dhe këtë e realizon përmes një larmie formash e mënyrash, të cilat ofrojnë një informacion të vazhdueshëm e të hollësishëm mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programeve të studimeve që ofrohen në Fakultetet e tij. Struktura, organizimi dhe kohëzgjatja e programit të studimit Bachelor në Inxhinierinë Fizike janë të pasqyruara qartë në Rregulloren e këtij programi studimi. Studentët informohen në lidhje me lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese. Ky informacion ju pasqyrohet në trajtë të detajuar edhe në syllabusin e lëndës/modulit, i cili ju vihet në dispozicion në javën e parë të çdo semestri dhe gjithashtu ju vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. UPT dhe FIMIF informojnë studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës. Informacioni për studentët e programit të studimit Bachelor në Inxhinierinë Fizike mundësohet përmes platformës së sekretarisë mësimore Bit-Albania e cila ofrohet me mbështetjen e Rrjetit Akademik Shqiptar.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4 Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	Statistikat vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit Bachelor në Inxhinierinë Fizike menaxhohen nga Sekretaria Mësimore e FIMIF [Ref_ VI. ANEKS Tabelat përmbledhëse për RVB Bch.IF, Tabela 21, Tabela 23]. Ky informacion ruhen në formë të shkruar (hard copy) dhe në formë elektronike, në regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave, sipas mënyrës së përcaktuar në udhëzimet përkatëse të MAS [Ref_124 Model Rregjistri Elektronik dhe Hard Copy nga Sistemi i Sekretarisë Mësimore]. Ruajtja dhe përpunimi i të dhënave personale të studentëve, bazohet në parimin e konfidencialitetit, në përputhje me kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale [http://www.pp.gov.al/web/ligj_mbrojtja_e_te_dhenave_personale_40.pdf].

	Statistikat vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit Bachelor në Inxhinierinë Fizike, pasqyrohen edhe në Raportin e përvitshëm të analizës vjetore të FIMIF <i>[Ref_061 Analiza Vjetore e Punës Mësimore DIF]</i>
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Informacioni në lidhje me statistikën vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit Bachelor në Inxhinierinë Fizike, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të tij apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet ky program studimi, menaxhohet nga Sekretaria Mësimore e FIMIF <i>[Ref_124 Model Rregjistri Elektronik dhe Hard Copy nga Sistemi i Sekretarisë Mësimore]</i>. Këto të dhëna ruhen në formë të shkruar (hard copy) dhe në formë elektronike, në regjistrin e lëshimit të diplomave dhe çertifikatave, sipas mënyrës së përcaktuar nga udhëzimet e MAS. Statistikat vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për këtë program studimi <i>[Ref_VI. ANEKS_Tabelat përmbledhëse për RVB_Bch.IF]</i> pasqyrohen edhe në Analizën Vjetore të Punës Mësimore të DIF <i>[Ref_061 Analiza Vjetore e Punës Mësimore DIF]</i>. Sektori i Statistikës dhe Informacionit në UPT <i>[Ref_007 Organigrama e UPT]</i> disponon gjithashtu, statistika vjetore për numrin e studentëve dhe të të diplomuarve për çdo program studimi, për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve. Këto të dhëna pasqyrohen në raportet vjetorë përkatëse të UPT.
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Të dhënat statistikore të studentëve në programin e studimit Bachelor në Inxhinierinë Fizike, menaxhohen në formë elektronike përmes sistemit të brendshëm të informacionit Bit-Albania. Këto të dhëna janë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar <i>[Ref_076 Aksesimi i Sekretarisë Mësimore Online nga Studentët]</i>, <i>[Ref_093 Informimi i Studentëve Nëpërmjet Platformave Online]</i>. Ruajtja dhe përpunimi i të dhënave personale të studentëve bazohet në parimin e konfidencialitetit dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale [http://www.pp.gov.al/web/ligj_mbrojtja_e_te_dhenave_personale_40.pdf].
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson	Informacioni që lidhet me ecurinë e studentëve të programit të studimeve Bachelor në Inxhinierinë Fizike, që nga pranimi deri në diplomimin e tyre, bazuar në Ligjin të Arsimit të lartë nr.80/2015, Neni 101, mbahet nga Sekretaria Mësimore e FIMIF. Këto të dhëna ruhen në formë të shkruar (hard copy) dhe në formë elektronike, në regjistrat përkatës, sipas mënyrës së përcaktuar nga udhëzimet e MAS <i>[Ref_124 Model Rregjistri Elektronik dhe Hard Copy nga Sistemi i Sekretarisë Mësimore]</i>.

dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	Mësimore]. Pas kontrollit periodik të përvitshëm pranë sekretarisë mësimore dhe sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit, DIF vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit që lidhet me studentët dhe me veprimtarinë e tyre [Ref_132 Per Kontrollin e Sekretarisë Mesimore FIMIF]. Këto të dhëna, më tej bëhen pjesë e Analizës vjetore të punës mësimore nga DIF [Ref_061 Analiza Vjetore e Punës Mesimore DIF]. Platforma Bit-Albania e ofruar nga RASH, mundëson gjithashtu menaxhimin e përparimit të studentëve gjatë gjithë programit të studimit, përfshirë regjistrimin e tyre, transferimet e mundshme, faturimet, pagesat, organizimin e mësimdhënies, grupet mësimore, transkriptet e notave etj.
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Në zbatim të Udhëzimit të MAS, UPT harton Raportin Vjetor, ku ndër të tjera, vlerësohet veprimtaria mësimore dhe shkencore, si dhe ecuria e programeve që ofrohen. Ky raport hartohet bazuar në evidencat dhe raportet e njësive kryesore/bazë. Këto raporte janë pjesë e analizës vjetore që fillon nga stafi akademik, departamentet, fakulteti dhe UPT [Ref_120-122 Raporti Vjetor Mësimor FIMIF 20-23], [Ref_061 Analiza Vjetore e Punës Mësimore DIF], [Ref_094-096 Raporti Vjetor Kërkimor FIMIF 20-23], [Ref_060 Analiza Vjetore e Punës Kërkimore DIF]. Përveç vlerësimit të veprimtarisë mësimore dhe shkencore dhe ecurisë së programeve të studimit, këto raporte pasqyrojnë edhe profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve. Shkalla e cilësisë së punësimit të studentëve (gjurmimi i studentëve) realizohet përmes studimit periodik të tregut, në nivel UPT-je dhe Departamenti (DIF) [Ref_092 Sondazhe mbi Tregun e Punës dhe Kompanitë UPT]. Ky gjurmim i studentëve evidentohet në regjistrin përkatës që mbahet dhe përditësohet nga specialisti i karrierës dhe alumnes pranë FIMIF [Ref_113 Raporti Vjetor i Zyrës së Karrierës FIMIF 21-22,22-23,23-24].
Konkluzione	GVJ konkludon se: Statistikat vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit Bachelor në Inxhinierinë Fizike, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të tij apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet ky program studimi, menaxhohen nga Sekretaria Mësimore e FIMIF. Ruajtja dhe përpunimi i të dhënave personale të studentëve, bazohet në parimin e konfidencialitetit dhe në përpunime me kërkesat e legjisllacionit për mbrojtjen e të dhënave personale. , UPT harton Raportin Vjetor, ku ndër të tjera, vlerësohet veprimtaria mësimore dhe shkencore, si dhe ecuria e programeve që ofrohen. Ky raport hartohet

	bazuar në evidencat dhe raportet e njësive kryesore/bazë. Këto raporte janë pjesë e analizës vjetore që fillon nga stafi akademik, departamentet, fakulteti dhe UPT.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Statuti i UPT parashikon qartë përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse dhe këshilluese. Sipas Nenit 49 të Statutit të UPT [Ref_001 Statuti i UPT], studentët kanë përfaqësuesit e tyre në Senatin Akademik të UPT, të zgjedhur nga studentët me votim. Ata gjithashtu kanë përfaqësues në Këshillin e Etikës, Këshillat e Programeve të Studimit [Ref_003 Kodi i Etikës i UPT], [Ref_113 Raporti Vjetor i Zyrës së Karrierës FIMIF 21-22,22-23,23-24], [Ref_022 Rregullore për Këshillin Studentor UPT], [Ref_103 Aktivitetet sportive të studentëve UPT], dhe komisionet e përherëshme të Senatit Akademik të UPT. Studentët janë të përfshirë në vlerësimin e brendshëm të programeve të studimit dhe në vlerësimin instituciona [Ref_IV.Urdhër për Ngritjen e Grupit të Vlerësimit të Brendshëm_GVB_Bch. IF].
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	FIMIF dhe DIF garantojnë që përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme. Studentët e programit të studimit Bachelor në Inxhinierinë Fizike kanë mundësi që nëpërmjet përfaqësuesëve të tyre në organizmat përkatës, të shprehin mendime dhe propozime mbi të gjitha problematikat që kanë interes si për fakultetin (FIMIF), ashtu edhe për universitetin (UPT). Mendimet dhe propozimet e tyre u adresohen planeve mësimore dhe programeve të studimit, rregulloreve të studimeve apo çështjeve që lidhen me jetën sociale studentore dhe aktivitetet e tyre shkencore [Ref_113 Raporti Vjetor i Zyrës së Karrierës FIMIF 21-22,22-23,23-24], [Ref_VI. ANEKS_Tabelat përmbledhëse për RVB_Bch.IF, Tabela 22]. Për të rritur pjesëmarrjen e studentëve në këto procese, ata janë përfshirë gjithashtu në grupet e vlerësimit të brendshëm të programeve të studimit si dhe të vlerësimit institucional [Ref_IV.Urdhër për Ngritjen e Grupit të Vlerësimit të Brendshëm_GVB_Bch. IF].

	Një tregues i qartë i përfshirjes së studentëve në kërkimin shkencor, është pjesëmarrja e tyre në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare. UPT mbështet krijimin e Këshillave Studentore dhe aktivitetet e organizuara prej tyre <i>[Ref_001 Statuti i UPT, Neni 51], [Ref_022 Rregullore për Këshillin Studentor UPT]</i>. Këshillat Studentorë janë organizime të pavarura të studentëve, brenda UPT, të cilat nuk zhvillojnë veprimtari politike dhe ekonomike. Aktivitetet e Këshillave Studentorë financohen nga UPT. Këto këshilla promovojnë pjesëmarrjen e studentëve dhe koordinojnë përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të UPT. Këshillat e studentëve shprehin mendime dhe propozime për të gjitha problematikat me karakter të përgjithshëm në nivel universiteti, përfshirë planet dhe programet e studimeve, rregulloret për veprimtaritë mësimore, të drejtën për të studiuar, cilësinë e shërbimeve, përcaktimin e tarifave të shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët, bilanci vjetorë paraprake të shpenzimeve ose ndarjen e burimeve financiare, zhvillimin e veprimtarive të ndryshme kulturore, artistike, sportive etj.
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributit të tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	Programi i studimit Bachelor në Inxhinierinë Fizike është hartuar në përputhje dhe zbatim të bazës ligjore në fuqi. Të tilla janë edhe të gjitha ndryshimet e bëra në të. Në versionin e tij aktual, ky program është riformatuar dhe riorganizuar në përputhje të plotë me “VKM. Nr. 41, datë 24.1.2018. Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, si dhe në përshtatje me nevojat e tregut të punës. Në të gjitha rastet e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit Bachelor në Inxhinierinë Fizike, DIF ka garantuar përfshirjen në proces të studentëve të këtij programi. Kjo është siguruar përmes mbledhjeve të përbashkëta në departament, pyetësorëve të ndryshëm etj. Gjatë hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit, DIF ka treguar një kujdes të veçantë ndaj ngarkesës akademike të studentëve <i>[Ref_040-042 Plani Mësimor Bch.IF 2021-2024], [Ref_044-046 Programet Lëndore (Syllabuse) Bachelor IF 2021-2024]</i>. Studentët e programeve bachelor për të kaluar në vitin e dytë mjafton të kenë marrë 30 kredite ECTS, ndërsa për të kaluar në vitin e tretë u mjaftojnë minimalisht 80 kredite ECTS, pavarësisht se ku i kanë marrë ato <i>[Ref_002 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT, Neni 37]</i>. Përbajtja e planit mësimor të programit të studimit Bachelor në Inxhinierinë Fizike, shmang procedurat burokratike gjatë përparimit të studentit, duke mundësuar njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme të tyre. Kjo shihet më së miri në procedurat për ekuivalentimin dhe njohjen e lëndëve dhe krediteve për studentët që transferohen (vijnë nga jashtë universitetit ose/dhe lëvizin brenda FIMIF duke ndryshuar PS), si edhe studentëve që marrin pjesë në projektet Erasmus+ <i>[Ref_013</i>

	<i>Procedurat për Mobilitetet Erasmus+ UPT], [Ref_097 Pjesëmarrja në Projekte dhe Trajnime, Mobilitete të Stafit Akademik dhe Studentëve FIMIF].</i>
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezulttit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Rregullorja e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT, neni 35 i saj, i garanton studentit të drejtën për ankimim, në rast se ndaj tij janë shkelur rregullat procedurale gjatë zhvillimit të provimit ose nëse ai nuk është dakord me vlerësimin e bërë <i>[Ref_002 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT].</i> Kjo ankesë shqyrtohet nga Dekani i FIMIF, i cili mund të thërrasë për sqarime Drejtuesin e Njesisë Bazë, në këtë rast përgjegjësin e DIF, komisionin e provimit dhe vetë studentin. Kur ankesa është e drejtë, Dekani e shpall të pavlefshëm rezultatin e vlerësimit për të cilin studenti është ankuar dhe vendos që studenti të rivlerësohet ose të rijapë provimin, me të njëjtin komision, të plotësuar dhe me anëtarë të tjerë. Gjithashtu, Neni 48 i kësaj rregulloreje, garanton të drejtën e studentit nëse ai nuk është dakord me vendimmarrjen e komisionit të njohjes dhe ekuivalentimit të krediteve, gjatë procesit të transferimit të studimeve ose ndjekjes së një programi të dytë studimesh. Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve gjatë plotësimit të pyetësorëve për lëndët, në fund të semestrit, si dhe në Anketimin Studentor <i>[Ref_023 Anketimi Studentor – Pyetësori dhe Raporti_UPT].</i>
Konkluzione	<i>GVJ konkludon se: Pjesëmarrja e studentëve në jetën institucionale të UPT është shumë e rëndësishme. Në aktet e veta rregullatore, UPT parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese. Kështu, Statuti i UPT përcakton qartë, në Nenin 49 të tij, përfshirjen e studentëve në jetën institucionale [Ref_001 Statuti i UPT]. Studentët kanë përfaqësuesit e tyre si anëtarë të Senatit Akademik të UPT, të cilët zgjidhen me votim të vetë studentëve. Studentët kanë gjithashtu përfaqësues të tyre, në Këshillin e Etikës dhe në Këshillat e Programeve të Studimit. FIMIF dhe DIF garantojnë që përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme. Studentët e programit të studimit Bachelor në Inxhinierinë Fizike kanë mundësi që nëpërmjet përfaqësuesëve të tyre në organizmat përkatës, të shprehin mendime dhe propozime mbi të gjitha problematikat që kanë interes si për fakultetin (FIMIF), ashtu edhe për universitetin (UPT). FIMIF garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</i>

	Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6	
Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Duke pasur në focus shërbimin ndaj studentëve dhe informimin e tyre, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve, në UPT operojnë tashmë dy drejtori [Ref_007 Organigrama e UPT] - Drejtorja e Kurrikulave në përbërje të së cilës janë dy sektorë në shërbim të studentëve: - Sektori i Kurrikulave, - Sektori i Procesit Mësimor. - Drejtorja e Komunikimit dhe Koordinimit që ofron shërbimin e karrierës dhe ALUMNIT Procedurat e ndjekura prej këtyre dy njësive në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve janë në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të vetë universitetit. Gjithashtu edhe në FIMIF është ngritur dhe funksionon Zyra e Karrierës dhe Alumnas, detyra kryesore të cilës është të informojë dhe këshillojë studentët përgjatë gjithë studimeve të tyre [Ref_029 Organigrama_FIMIF].
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	UPT ndjek një politikë të vazhdueshme informimi të studentëve përmes të gjitha formave të mundshme, duke përfshirë njoftime të ndryshme në faqet web të UPT dhe FIMIF. (http://upt.al & http://fimif.edu.al) [Ref_115 Model Njoftimesh në Faqen Web të FIMIF], njoftime në mjediset e fakultetit, komunikimin direkt me pedagogoet, përgjegjësit e departamenteve etj. Sekretaritet mësimor të çdo Fakulteti dhe Zyra e Këshillimit të Karrierës janë struktura ndihmuese për studentët [Ref_007 Organigrama e UPT], [Ref_029 Organigrama_FIMIF]. Gjatë gjithë periudhës së studimeve, studentit i jepet mundësia të komunikojë me pedagogët, jo vetëm në auditor, por edhe përmes postës elektronike. (Në javën e parë të mësimit, pas regjistrimit të tyre, studentët e programit të studimit Bachelor në Inxhinierinë Fizike, pajisen me një email personal emër.mbiemer@fimif.edu.al.)

	Përvoja pozitive e fituar në zhvillimin e mësimi online gjatë periudhës së pandemisë <i>[Ref_116 Udhëzuesi i zhvillimit të mësimi në distancë]</i>, ka bërë që platforma Microsoft TEAMS, të vazhdojë të funksionojë nëpërmjet një sistemi menaxhimi të brendshëm në FIMIF, duke u kthyer në një mjet mjaft efikas për nevoja të ndryshme komunikimi në distancë. Në funksion të informimit, këshillimit, ndjekjes e përparimit të studentëve dhe asistimit të tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit, FIMIF ka si pjesë përbërëse të tij: • Këshillin e Programit të Studimit <i>[Ref_002 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT, Neni 4 & 5], [Ref_039 Vendimi per Emërimin e KPS të Bch IF]</i>. • Sekretaria Mësimore e FIMIF <i>[Ref_124 Model Rregjistri Elektronik dhe Hard Copy nga Sistemi i Sekretarisë Mësimore], [Ref_076 Aksesimi i Sekretarisë Mësimore Online nga Studentët], [Ref_075 Model Formularësh në Shërbim të Studentit nga Sekretaria]</i> • Zyra e Karrierës dhe ALUMNA në FIMIF <i>[Ref_112 Rregullore e Këshillimit të Karrierës FIMIF]</i>. Të gjitha strukturat e UPT që janë të lidhura drejtpërdrejt me informimin e studentëve, si zyrat e karrierës, sekretaritë mësimore dhe zyrat e financës, kanë të publikuara oraret e pritjes së studentëve për të plotësuar nevojat e tyre.
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Zyra e Karrierës pranë UPT <i>[Ref_007 Organigrama e UPT]</i> së bashku me Zyren e Karrierës pranë FIMIF <i>[Ref_029 Organigrama_FIMIF]</i>, i mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me përmbushjen e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës <i>[Ref_113 Raporti Vjetor i Zyrës së Karrierës FIMIF 21-22,22-23,23-24]</i>. UPT ofron shërbime për integrimin optimal të të diplomuarve në tregun e punës dhe ndërmerr nisma për krijimin e vendeve të reja për punë të kualifikuar. Në këtë kuadër, DIF ruan lidhje kulturore, profesionale dhe personale me të diplomuarit. Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe ALUMN-it vepron si urë lidhëse midis studentëve dhe tregut të punës, duke krijuar kontakte me punëdhënësit potencialë për të promovuar studentët dhe kërkuar mundësi të reja punësimi. FIMIF mbështet aktivisht zhvillimin e aftësive praktike të studentëve, duke fokusuar në zhvillimin efikas të praktikave profesionale. Ai nxit dhe mbështet krijimtarinë e studentëve në partneritet të plotë me biznesin, duke siguruar shanse të barabarta dhe zgjerimin e internshipit. UPT është gjithmonë i hapur për aktivitete të përbashkëta me industrinë.

Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Zyra e Karrierës përmes njoftimeve në faqet web të UPT dhe FIMIF (http://upt.al & http://fimif.edu.al) [Ref_115 Model Njoftimesh në Faqen Web të FIMIF] dhe përmes materialeve informuese të afishuara në mjediset e universitetit njofton vazhdimisht studentët për mundësi për aplikime në lidhje me punësimin e tyre (http://upt.al/bashkepunime/aktivitete). Të gjitha strukturat e UPT, personeli akademik, ndihmës mësimorë shkencorë dhe personeli administrativ angazhohen për zbatimin e politikës për integrimin në punësim të studentëve. UPT disponon të dhëna, për punësimin e studentëve të vet, me të cilët mban kontakte të vazhdueshme. Për ngritjen e rrjetit Alumni ka filluar puna përmes një pyetësoi për të identifikuar studentët e diplomuar në UPT dhe për të ndjekur zhvillimin e karrierës së tyre. Deri më sot është krijuar një databazë me mbi 200 të diplomuar që kanë shprehur interes për të qenë pjesë e rrjetit Alumni në UPT [Ref_111 Databaza Alumni UPT]. Në këtë kuadër edhe në FIMIF është ngritur shoqata Alumni/ae e Fakultetit të Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike [Ref_086 Alumni Pyetësor Zyra e Karrierës FIMIF], [Ref_087 Database Alumni të Diplomuarit në IF (2021-2023)].			
Konkluzione	<i>GVJ konkludon se: UPT ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përpunje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit Procedurat e ndjekura prej këtyre njësive në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve janë në përpunje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të vetë universitetit.</i> <i>Gjithashtu edhe në FIMIF është ngritur dhe funksionon Zyra e Karrierës dhe Alumnas, detyra kryesore të cilës është të informojë dhe këshillojë studentët përgjatë gjithë studimeve të tyre. UPT dhe FIMIF kanë ngritur dhe kanë bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit duke i ofruar studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës. Kjo zyrë ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

				X
--	--	--	--	---

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1

Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Qëllimi kryesor i programit të studimit është harmonizimi i punës në auditor me punën individuale të studentit duke shfrytëzuar gjithë materialet e vëna në dispozicion nga pedagogët si dhe materialet që ofron biblioteka (fizike dhe online). FIMIF e zhvillon këtë program studimi në përputhje me standardet e vendosura nga UPT dhe ato shtetërore të cilësisë. Gjithashtu, për të rritur kapacitetet didaktike të stafit akademik, UPT përdor një udhëzues për personelin akademik për metodat e ndryshme dhe inovative të mësimdhënies <i>[Ref_002 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT]</i> .
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	Programi i studimit Bachelor në Inxhinierinë Fizike ofrohet nga Departamenti i Inxhinierisë Fizike pranë FIMIF, dhe ky departament ka përgjegjësinë e plotë lidhur me realizimin e procesit mësimor monitorimin e cilësisë së mësimdhënies. Kjo detyrë drejtohet nga Përgjegjësi i DIF. Në nivel institucioni puna për vlerësimin e aftësive mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik drejtohet nga NjSBC. Vlerësimi i lektorëve nga studentët realizohet nëpërmjet sondazhit që kryhet rregullisht nga UPT. Në fillimin e vitit akademik, çdo anëtar i personelit akademik kryen parashikimin e ngarkesës vjetore e cila vlerësohet dhe miratohet nga përgjegjësi i Departamentit dhe Dekanati. Ndërsa në fund të vitit raportohet sërish analiza mësimore e cila integrohet në analizën mësimore kërkimore të njësisë bazë dhe të njësisë kryesore <i>[Ref_002 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT]</i> , <i>[Ref_060 Analiza Vjetore e Punës Kërkimore-Shkencore DIF]</i> , <i>[Ref_061 Analiza Vjetore e Punës Mësimore DIF]</i> .
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve,	Nëpërmjet pyetësorit të vlerësimit të lektorëve të lëndëve të programit të studimit Bachelor në Inxhinierinë Fizike, garantohej përfshirja e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies. Ky pyetësor plotësohet në fund të çdo semestri. Pyetësori është anonim dhe gjithë procesi drejtohet dhe monitorohet

përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	nga NJSBC. Garantimi i ankimit të rezultatit të provimit bazohet në procedurën e përcaktuar në rregullore. <i>[Ref_023 Anketimi Studentor - Pyetësi dhe Raporti UPT], [Ref_067 Organizimi i Pyetësorit Studentor FIMIF 22-23], [Ref_083-085 Raportimi vjetor 2021-2024 NJSBC FIMIF], [Ref_031 Rregullore Njesia Kryesore FIMIF], [Ref_034 Rregullore Njesia Baze DIF].</i>
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Çdo anëtar i personelit akademik informohet me anë të postës elektronike në lidhje me rezultatet e tij për këtë anketim. Rezultatet e anketimit i dërgohen të grupuara sipas njësive përkatëse edhe drejtuesve të njësive bazë dhe njësive kryesore. Bazuar në historikun e vlerësimeve të personelin akademik, përgjegjësit e njësive bazë analizojnë rezultatet e ankimit dhe diskutojnë në departament problematikat e identifikuar për përmirësimin e tyre në të ardhmen. Publikimi i raporteve të analizës së pyetësorëve për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies kryhet nga ana e NJSBC, duke i vënë kështu rezultatet e vlerësimit në dispozicion si të personelit akademik ashtu edhe të studentëve apo dhe gjithë instancave të tjera të interesuara <i>[Ref_067 Organizimi i Pyetësorit Studentor FIMIF 22-23], [Ref_083-085 Raportimi vjetor 2021-2024 NJSBC FIMIF], [Ref_031 Rregullore Njesia Kryesore FIMIF], [Ref_034 Rregullore Njesia Baze DIF].</i>
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	NJSBC luan një rol të rëndësishëm në promovimin e shembujve të praktikave të mira, nxitjen dhe inkurajimin e personelit akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies. Ajo njofton zyrtarisht drejtuesit e institucionit për rezultatet përfundimtare. Rezultatet e përpunuara publikohen dhe në faqen web të UPT <i>[Ref_067 Organizimi i Pyetësorit Studentor FIMIF 22-23], [Ref_083-085 Raportimi Vjetor 2021-2024 NJSBC FIMIF], [Ref_031 Rregullore Njesia Kryesore FIMIF], [Ref_034 Rregullore Njesia Baze DIF].</i>
Konkluzione	<i>GVJ konkludon se: FIMIF harton dhe përditëson në mënyrë të vazhdueshme udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve. Departamenti i Inxhinierisë Fizike është përgjegjës për realizimin e procesit mësimor për programin e studimit Bachelor në Inxhinierinë Fizike dhe përgjegjësi kryesor për monitorimin e cilësisë së mësimdhënies. Garantimi i përfshirjes së studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve mundësohet nëpërmjet pyetësorit të vlerësimit të lektorëve të lëndëve të programit të studimit Bachelor në Inxhinierinë Fizike. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit. FIMIF dhe DIF, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovojnë shembuj të praktikave</i>

	të mira, nxisin personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	UPT në zbatim të Ligjit për Arsimin e Lartë Nr.80/2015, pika 1, ofron shërbime sipas standardeve europiane dhe për tu qasur sa më shumë këtyre standardeve ka në foku hartimin e politikave si dhe ngritjen e strukturave në funksion të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Në mënyrë specifike: Në Statutin e UPT-së <i>[Ref_001 Statuti i UPT]</i> neni 2 “Dispozita të përgjithshme”, sanksionohet garantimi i të drejtës së studentëve dhe stafit akademik për të zhvilluar lirisht dhe në mënyrë cilësore procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies, duke vënë në dispozicion infrastrukturën adekuate për këtë qëllim. Në Nenin 78, Kreu IX në Statutin e Institucionit janë parashikuar strukturat dhe parimet e funksionimit të Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë. Për këtë, funksionon Rrjeti i Cilësisë me përgjegjësinë e ngritjes, zbatimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të sistemit të cilësisë në UPT, mbështetur në Kodin e Cilësisë në Arsimin e Lartë si dhe standardet dhe udhëzimet evropiane për sigurimin e cilësisë në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë. Rrjeti i Cilësisë përbëhet nga: - Njësia Qendrore e Sigurimit të Cilësisë (NJQSC), e ngritur në rektoratin e UPT dhe - Njësitë e Sigurimit të Cilësisë (NJSC) në çdo njësi kryesore të UPT. Në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies UPT ka ngritur strukturat përkatëse të cilat janë Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (DSBC) dhe Drejtoria e Kurrikulave (DK) <i>[Ref_007 Organigrama e UPT]</i>. Duke qenë se njësia përgjegjëse për zhvillimin e programit të studimit është Departamenti i IF-së (Departamenti i Inxhinierisë Fizike), DSBC dhe DK, koordinojnë punën edhe me departamentet e tjera që japin kontribut në zhvillimin e kesaj diplome dhe me qëllim përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies.

Pranë çdo njësie kryesore, me propozim të Dekanit, ngrihet një njësi NJSBC. Kjo përcaktohet edhe në rregulloren e FIMIF [Ref_031 Rregullore Njesia Kryesore FIMIF].

Në Planin Strategjik 2019-2024 [Ref_004 Plani Strategjik 2019-2024 UPT] të UPT-së, kreu IV, UPT synon përmirësimin e kulturës së cilësisë në procesin e edukimit nëpërmjet zbatimit të standarteve më të përparuara, zhvillimin e procedurave për monitorimin dhe rishikimin e cilësisë akademike, rritjen e cilësisë në qeverisje dhe menaxhimin e institucionit, me synim rritjen e cilësisë në të gjitha programet e studimit që ofron. Në Planin Strategjik 2019-2024 [Ref_032 Plani Strategjik Njesia Kryesore 2019-2024 FIMIF], [Ref_033 Plani i Zhvillimit të Strategjise 2019-2024 FIMIF] të Fakultetit të Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike, theksohet rëndësia e respektimit të standarteve për Sigurimin e cilësisë në veprimtarinë akademike dhe administrative të fakultetit.

Krahas dokumentave të mësipërme, në mënyrë të vazhdueshme Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë ka miratuar pyetësorët/procedura të posatshme për sigurimin e brendshëm të cilësisë si:

- “Për procedurën e analizës dhe vlerësimit të pyetësorëve të studentëve për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e cdo programi studimi në Universitetin Politeknik të Tiranës [Ref_083-085 Raportimi Vjetor 2021-2024 NJSBC FIMIF], në të cilën përshkruhet në mënyrë të hollësishme procedura e përmirësimit të programeve të studimit, duke filluar që prej analizimit të rezultateve të pyetësoreve deri në planin e masave që propozohet për përmirësim;
- “Për miratimin e Pyetësorit për Studentët për Vlerësimin dhe Përmirësimin e Cilësisë së Shërbimeve të ofruara prej Stafit Administrativ dhe Ndihmës/akademik në UPT” [Ref_083-085 Raportimi Vjetor 2021-2024 NJSBC FIMIF]. Qëllimi i përdorimit të këtij instrumenti është vlerësimi dhe monitorimi i cilësisë së shërbimeve që studentët marrin gjatë jetës studentore në UPT prej strukturave mbështetëse për programet e studimit.

Veprimtarinë e saj NJSBC-ja e mbështet në Kodin e Cilësisë në Arsimin e Lartë

[<https://www.ascal.al/media/documents/publikime/Kodi-Cilesise-se-Arsimit-te-Larte.pdf>]. Në mënyrë periodike NJSBC-ja raporton dhe informon drejtuesit e njësive bazë dhe kryesore dhe përmes tyre të gjithë stafin e UPT-së mbi rezultatet e monitorimeve dhe vlerësimeve të zhvilluara, me synim marrjen e masave për përmirësimin e vazhdueshëm të performances së institucionit, njësive të tij bazë dhe

	individëve në të ardhmen. Këto raporte krahasohen me standardet e cilësisë të parashikuara në Manualin e Cilësisë të UPT-së. Zbatimi i standardeve të cilësisë nënkupton zbatimin e standardeve akademike, kërkimore, menaxhuese, infrastrukturore, etj me qëllim që të arrihen nivele maksimale në procesin mësimor dhe kërkimor.
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Për të monitoruar sigurimin e brendshëm të cilësisë (më poshtë sigurimi i cilësisë) në të gjitha njësitë përbërëse organizative të UPT <i>[Ref_001 Statuti i UPT, Neni 78]</i> , funksionon Rrjeti i Cilësisë me përgjegjësinë e ngritjes, zbatimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të sistemit të cilësisë në UPT. Rrjeti i Cilësisë përbëhet nga Njësia Qendrore e Sigurimit të Cilësisë (NJQSC), e ngritur në rektoratin e UPT dhe Njësitë e Sigurimit të Cilësisë (NJSC) në çdo njësi kryesore të UPT <i>[Ref_007 Organigrama e UPT]</i> . NJQSC harton standardet institucionale të cilësisë bazuar në Kodin e proceseve vlerësuese <i>[Ref_001 Statuti i UPT]</i> . Këto standarde miratohen nga SAUPT. UPT zhvillon dhe zbaton mekanizma për promovimin dhe zotërimin e një kulture të cilësisë në të gjitha njësitë dhe të gjitha nivelet, zhvillimin e procedurave për monitorimin dhe rishikimin e cilësisë akademike, rritjen e cilësisë në qeverisje dhe menaxhimin e institucionit, me synim rritjen e cilësisë në të gjitha programet e studimit që ofron <i>[Ref_004 Plani Strategjik 2019-2024 UPT, Kreu IV.1]</i> . Një instrument shumë i rëndësishëm në procesin e sigurimit të cilësisë është dhe akreditimi institucional dhe akreditimi i programeve të studimit. Në këto procese janë dy etapa të rëndësishme: vetëvlerësimi (ose vlerësimi brendshëm) dhe vlerësimi i jashtëm. Në vlerësimin e brendshëm krahas stafit akademik përfshihen dhe studentët si pjesë e rëndësishme e këtyre proceseve <i>[Ref_IV. Urdher per Ngritjen e Grupit te Vleresimit te Brendshem_GVB_Bch. IF]</i> . Gjithashtu në vlerësimin e jashtëm një rol të rëndësishëm ka bashkëpunimi me ASCAL dhe specialistët e tij për kryerjen me sukses të akreditimit të PS. Në funksion të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë Departamenti i IF që mbulon programin e studimit Bachelor në Inxhinierinë Fizike operon në koherencë të plotë me procedurat e Fakultetit të Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike (FIMIF), i cili nga ana e tij respekton procedurat që janë përcaktuar nga strukturat e nevojshme në nivel institucioni, në të cilat garantohet dhe përfshirja e stafit dhe studentëve.
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit,	Dy prej instrumentave kryesore të jashtëm për sigurimin e cilësisë në UPT janë Akreditimi Institucional si dhe Akreditimi i programeve të studimit, të cilat janë dhe detyrim ligjor për cdo IAL, Neni 104 Ligji i Arsimit të Lartë nr.80/2015. Në prill 2021, Universiteti Politeknik i Tiranës, ishte objekt i vlerësimit të jashtëm institucional (për herë të dytë) me qëllim vlerësimin e shkallës së përmbushjes së Standarteve Shqiptare Shtetërore të Cilësisë,

vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	që kanë hyrë në fuqi në vitin 2011. Procesi i akreditimit të parë institucional të UPT-së përfundoi me vlerësimin përmeshur kryesisht Standarded Shtetërore të Cilësisë dhe për rrjedhojë Bordi i dha UPT-së akreditim trevjeçar. Procesi i akreditimit të dytë institucional të UPT-së përfundoi me vlerësimin përmeshur plotësisht Standarded Shtetërore të Cilësisë dhe për rrjedhojë Bordi i dha UPT-së akreditim gjashtëvjeçar. <i>[Ref_105 Vendimi per Akreditimin Institucional UPT], [Ref_106 Plotësimi i Rekomandimit për Akreditimin Institucional UPT].</i>
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	Universiteti Politeknik i Tiranës duke patur si qëllim sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të sigurimit të brendshëm të cilësisë ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike. Në Kreun IX të Statutit të UPT-së <i>[Ref_001 Statuti i UPT]</i> përshkruhen qartë procedurat e posaçme për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve që ofrohen. Në mënyrë periodike nëpërmjet NJSBC-së, në fund të çdo semestri përpara sezonit të provimeve, organizohet pyetësori studentor <i>[Ref_083-085 Raportimi Vjetor 2021-2024 NJSBC FIMIF]</i> për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi. Në mënyrë periodike NJSBC-ja raporton dhe informon drejtuesit e njësive bazë dhe kryesore dhe përmes tyre të gjithë stafin e UPT-së mbi rezultatet e monitorimeve dhe vlerësimeve të zhvilluara, me synim marrjen e masave për përmirësimin e vazhdueshëm të performances së institucionit, njësive të tij bazë dhe individëve në të ardhmen. Gjithashtu përfshirja e stafit akademik, ndihmës-akademik, administrative dhe studentëve në proceset e akreditimit shërben për ndërgjegjësimin dhe krijimin e një kulture lidhur me sigurimin e cilësisë <i>[Ref_IV.Urdher per Ngritjen e Grupit te Vleresimit te Brendshem_GVB_Bch.IF]</i>. Këto raporte krahasohen me standardet e cilësisë të parashikuara në Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë. Zbatimi i standardeve të cilësisë nënkupton zbatimin e standardeve akademike, kërkimore, menaxhuese, infrastrukturore, etj me qëllim që të arrihen nivele maksimale në procesin mësimor dhe kërkimor.
Konkluzione	<i>GVJ konkludon se: UPT ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale. UPT ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm dhe përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes</i>

	proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit. Gjithashtu UPT përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Drejtoria e Kurrikulave, si pjesë strukturës së UPT, ka si qëllim monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë, <i>[Ref_007 Organigrama e UPT]</i> [https://upt.al/dega-mesimore]. Hartimi, miratimi, monitorimi dhe përmirësimi i programeve të studimit në UPT është një proces që kryhet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të arsimit të lartë duke pasqyruar edhe ndryshimet përkatëse, si dhe sipas një procedure të mirëpërcaktuar të pasqyruar në rregulloret e institucionit, njësive kryesore dhe njësive bazë <i>[Ref_031 Rregullore Njesia Kryesore FIMIF]</i>, <i>[Ref_034 Rregullore Njesia Baze DIF]</i>. Në UPT, për të patur një menaxhim më të mirë të procesit të hapjes dhe riorganizimit të programeve të studimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të tyre, pranë departamenteve janë ngritur Këshillat e programeve të studimit (KPS) për çdo program studimi që është nën përgjegjësinë e departamentit si dhe janë caktuar koordinatorët e programeve të studimit <i>[Ref_039 Vendimi per Emerimin e KPS te Bch. IF]</i>. Një nga funksionet kryesore të KPS është rishikimi i programit të studimit, mbështetur në nevojat e tregut të punës, zhvillimet në rajon dhe në botë, tendencat e zhvillimit të programeve të studimit të ngjashme në Europë e më tej, propozimet për përmirësim të ardhur nga mësimdhënësit, analizën e procesit mësimor <i>[Ref_120-122 Raporti Vjetor Mesimor FIMIF 20-23]</i>, <i>[Ref_061 Analiza Vjetore e Punes Mesimore DIF]</i> anketimet e studentëve <i>[Ref_067 Organizimi i Pyetesorit Studentor FIMIF 22-23]</i> ndryshimet në infrastrukturën laboratorike, rezultatet e projekteve të ndryshme të mbështetura nga Bashkimi European ose nga vende të tjera

	të lidhura me zhvillim kurrikular në Shqipëri, kërkesa të ardhura nga biznesi ose qeveria, si përgjigje e kërkesave të tregut të punës, etj. Procedura e hapjes, riorganizmit, rishikimit dhe mbylljes së një PS në UPT jepet në Kreun II të Regullores së Zhvillimit Kurrikular dhe mësimdhënies [Ref_002 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT]. Drejtoria e Kurrikulave e Rektoratit, verifikon përputhshmërinë e programit të studimit të rishikuar me standardet e cilësisë, si dhe dokumentacionin shoqërues të propozimit për ndryshim. Drejtoria e kurrikulave harton një raport teknik në lidhje me mangësitë e konstatuara dhe ja përcjell senatit akademik për shqyrtim e miratim. Komisioni i Mësimi të senatit akademik analizon dosjen dhe raportin pranë senatit në lidhje me shkallën e plotësimit të standardeve të cilësisë të programit të studimit të rishikuar. Senati në fund shprehet me vendim për miratimin ose jo të propozimit.
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	Referuar procedurës së sipërcituar raporti i rezultateve të pyetësorëve si dhe rekomandimet e përpiluara prej NJSBC-së iu përcillen Njërive Kryesore të cilat realizojnë më tej një diskutim të gjerë në çdo departament me stafin akademik. Këto raporte bëhen publike në faqen ueb të UPT [https://upt.al/cilesia-ne-upt] Megjithëse ka perpjekje pozitive, transparenca dhe gjithëpërfshirja kërkojnë një angazhim të drejtëpërdrejtë në informimin e studenteve dhe pedagogëve, debat të hapur dhe diskutim me ata. Pavarësisht kësaj Njësitë Kryesore diskutojnë rezultatet respektive duke dhënë propozime përkatëse, të cilat më pas diskutohen në Mbledhjen e Rektoratit. [Ref_083-085 Raportimi Vjetor 2021-2024 NJSBC FIMIF], [Ref_067 Organizimi i Pyetësorit Studentor FIMIF 22-23].
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtëpërdrejtë, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime	Në lidhje me natyrën e programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në Inxhinierinë Fizike, për vlerësimin e realizimit, mbarëvajtjes dhe cilësisë së këtij programi, janë përdorur disa metoda të drejtëpërdrejtë. Këto metoda përfshijnë vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, didaktikës, kurrikulës, procesit të të mësuarit, si dhe vëzhgime në auditor gjatë seminareve dhe laboratorëve. Kryesisht, vlerësimi kryesor realizohet përmes analizës mësimore që bëhet çdo fund viti akademik në nivel stafi, departamenti dhe fakulteti. [Ref_120-122 Raporti Vjetor Mesimor FIMIF 20-23]. Në fillim të vitit akademik Përgjegjësi i Departamentit, në bashkëpunim me stafin akademik kontrollon dhe vlerëson përmbajtjen e syllabuseve. Nderkohe, Përgjegjësi i Departamentit bashkepunon edhe me Përgjegjësat e Departamenteve që japin kontribut në realizimin e programit të studimit në nivelin Bachelor në Inxhinieri Fizike. Syllabuset diskutohen në departament por aprovohen nga titullari i lëndës. Përgjegjësi i Departamentit realizon vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së leksioneve/seminareve etj,

ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	praktikë që verifikon kryerjen e procesit të mësimdhënies nga pikpamja sasiore (Orët leksion, seminare, laboratore) [Ref_031 Rregullore Njesia Kryesore FIMIF]. Për mbylljen me sukses të programit të studimit, studenti i nënshtrohet provimit të formimit. Përgjegjësi i departamentit duhet të bëjë ngritjen e komisioneve për faza të ndryshme të provimit të formimit [Ref_064 Shembull i Miratimit të Komisioneve dhe Datave të Diplomimit], [Ref_099 Shembull Procesverbal i Vleresimit në Provim Formimi dhe Mbrojtje Diplome]. Në nivel njësie kryesore, Dekani duhet të mbikqyri mbarëvajtjen mësimore [Ref_001 Statuti i UPT, Neni13].
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.	Në nivel fakulteti në FIMIF, ekziston pozicioni i specialistit të Karrierës dhe Alumnit. Gjithashtu, FIMIF ka krijuar dhe përditëson rregjistrin e vet të alumnit me qëllim ndjekjen e studentit nga fillimi i studimeve deri në punësim. [Ref_VI.ANEKS_Tabelat përmbledhese për RVB_Bch.IF, Tabela 23]. Për gjurmimin e studentëve të cilët përfundojnë Ciklin e Parë “Bachelor” në Fakultetin e Inxhinierisë Matematike dhe Fizike, është përdorur metoda e intervistimit një për një për të gjithë studentët që u diplomuan në vitin akademik 2021-2022. Janë gjurmuar vetëm studentët që përfundojnë ciklin e parë dhe një pjesë të ciklin e dytë të studimeve sepse studentët që përfundojnë ciklin e parë nuk janë në punë të gjithë për shkak se vazhdojnë të jenë në vazhdimësin e studimeve në “Master Shkencor” dhe “Master Profesional” sipas disiplinave përkatëse dhe një pjesë e madhe janë në punë të padeklaruara. Instrumenti i përdorur është intervistë e strukturuar, e cila përmban në total 16 pyetje. Qëllimi i intervistës është mbledhja e të dhënave që lidhen kryesisht me situatën e punësimit të sapo diplomuarëve dhe ata që janë në vazhdim të studimeve në master. Informacioni është konfidencial dhe përdoret vetëm për qëllim mbledhjen e të dhënave për llogari të Fakultetit Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike. Ky informacion mund të konfirmohet në adresën e e-mail-it r.ramaj@fimif.edu.al dhe fizikisht nëpërmjet plotësimit të instrumentit. Nga të dhënat e mbledhura rezulton se në vitin akademik 2021-2022 janë diplomuar 41 studentë në total. Nga këta 14 studentë në “Bachelor” Inxh. Fizike; Nga 41 studentë të diplomuar, 4 prej tyre është punësuar në përputhje me diplomën dhe 2 janë të punësuar jo përputhje me diplomën. Pjesa tjetër e studentëve që vazhdojnë masterin nuk janë në mardhënie pune ose punojnë me orar të reduktuar për të plotësuar nevojat e tyre jetësore. Për gjurmimin e studentëve të cilët përfundojnë Ciklin e Parë “Bachelor” në Fakultetin e Inxhinierisë Matematike dhe Fizike, është përdorur metoda e intervistimit një për një për të gjithë studentët që u diplomuan në vitin akademik 2022-2023. Janë gjurmuar vetëm

studentët që përfundojnë ciklin e parë dhe një pjesë të ciklin e dytë të studimeve sepse studentët që përfundojnë ciklin e parë nuk janë në punë të gjithë për shkak se vazhdojnë të jenë në vazhdimësin e studimeve në “Master Shkencor” dhe “Master Profesional” sipas disiplinave përkatëse dhe një pjesë e madhe janë në punë të padeklaruara. Instrumenti i përdorur është intervistë e strukturuar, e cila përmban në total 16 pyetje. Qëllimi i intervistës është mbledhja e të dhënave që lidhen kryesisht me situatën e punësimit të sapo diplomuarëve dhe ata që janë në vazhdim të studimeve në master. Informacioni është konfidencial dhe përdoret vetëm për qëllim mbledhjen e të dhënave për llogari të Fakultetit Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike. Nga të dhënat e mbledhura rezulton se në vitin akademik 2022-2023 janë diplomuar 54 studentë në total. Nga këta 23 studentë në “Bachelor” Inxh. Fizike; Nga 54 studentë të diplomuar, 1 prej tyre është punësuar në përputhje me diplomën dhe 15 janë të punësuar jo përputhje me diplomën. Pjesa tjetër e studentëve që vazhdojnë masterin nuk janë në mardhënie pune ose punojnë me orar të reduktuar për të plotësuar nevojat e tyre jetësore.

Për gjurmimin e studentëve të cilët përfundojnë Ciklin e Parë “Bachelor” në Fakultetin e Inxhinierisë Matematike dhe Fizike, është përdorur metoda e intervistimit një për një për të gjithë studentët që u diplomuan në vitin akademik 2023-2024. Janë gjurmuar vetëm studentët që përfundojnë ciklin e parë dhe një pjesë të ciklin e dytë të studimeve sepse studentët që përfundojnë ciklin e parë nuk janë në punë të gjithë për shkak se vazhdojnë të jenë në vazhdimësin e studimeve në “Master Shkencor” dhe “Master Profesional” sipas disiplinave përkatëse dhe një pjesë e madhe janë në punë të padeklaruara. Instrumenti i përdorur është intervistë e strukturuar, e cila përmban në total 16 pyetje. Qëllimi i intervistës është mbledhja e të dhënave që lidhen kryesisht me situatën e punësimit të sapo diplomuarëve dhe ata që janë në vazhdim të studimeve në master. Informacioni është konfidencial dhe përdoret vetëm për qëllim mbledhjen e të dhënave për llogari të Fakultetit Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike. Nga të dhënat e mbledhura rezulton se në vitin akademik 2023-2024 janë diplomuar 7 studentë në total. Nga këta 5 studentë në Bachelor Inxh. Fizike. Të dhëna e mësipërme nuk janë përfundimtare sepse viti akademik 2023-2024 është akoma në proces. Numri total i të diplomuarve i përket vetëm sesionit të dimrit më 29.02.2024, ku mungon sesioni i verës dhe i vjeshtës. Këto të dhëna përditësohen çdo javë në database-ën që disponon Specialistia e Ruajtjes së Cilësisë së Brendshme, Karrierës dhe Alumin-it pranë FIMIF **/Ref_087**

	<i>Database_Alumni te Diplomuarit ne IF(2021-2023)], [Ref_086 Alumni Pyetesor Zyra e Karrieres FIMIF].</i> Një nga format që UPT përdor për të favorizuar punësimin e studentëve është edhe punësimi Brenda Universitetit. Ish studentë ekselentë të UPT punësohen si personel akademik efektiv dhe me kontratë, kur ata plotësojnë kriteret e punësimit të stafit akademik dhe si staf akademik ndihmës dhe administrativ <i>[Ref_072 Procedura e Punësimit ne FIMIF-DIF], [Ref_055 Model Rekrutimi Staf Akademik_PAE], [Ref_056 Model Rekrutimi Staf Ndihmes Akademik], [Ref_057 Model Rekrutimi Staf Akademik PAK].</i> UPT nëpërmjet pjesëmarrjes në projektin GRADUA, ka krijuar një database të rëndësishme të studentëve dhe kompanive. Studentët regjistrohen dhe publikojnë CV në këtë database, duke rritur kështu mundësinë e punësimit. Kompanitë e ndryshme në bazë të kriterëve të tyre përzgjedhin drejtpërdrejtë studentët e regjistruar në sistemin GRADUA <i>[Ref_110 Procedura e Rekrutimit Staf Akademik UPT].</i>
Konkluzione	<i>GVJ konkludon se: UPT përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit. Raportet e vlerësimit përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët. FIMIF dhe DIF në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit 'Bachelor në Inxhinierinë Fizike', përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitutionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera. Gjithashtu FIMIF në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit</i>

	dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Referuar Statutit të UPT-së [Ref_001 Statuti i UPT, Neni 81], [Ref_031 Rregullore Njesia Kryesore FIMIF], në Planin Strategjik 2019-2024 i UPT [Ref_004 Planin Strategjik 2019-2024 UPT, Kreu III], miratuar me vendim Bordi Administrimi nr.28, datë 01.11.2019 parashikohet përfshirja e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. Njëkohësisht në këto dokumente përcaktohen qartë përgjegjësitë dhe detyrat konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit. Për vlerësimin e brendshëm të programeve të studimit dhe kërkimit shkencor apo vlerësimin e brendshëm institucional, ngrihet grupi i vlerësimit të brendshëm, ku merr pjesë edhe një përfaqësues nga organizata studentore. Në rast nevojë, ftohet një përfaqësues ekspert i jashtëm. Grupi i vlerësimit të brendshëm ngrihet nga Dekanati/Drejtoria e njësisë kryesore që mbulon programin e studimit dhe kërkimit shkencor në bashkëpunim me NJSC apo nga Rektorati në bashkëpunim me NJQSC në rastin e vlerësimit të brendshëm institucional [Ref_IV.Urdher per Ngritjen e Grupit te Vleresimit te Brendshem_GVB_Bch.IF]. Grupi i vlerësimit të brendshëm gëzon autonomi funksionale dhe ka akses në të gjitha të dhënat e institucionit. Në UPT, pedagogët janë jo vetëm realizues të procesit mësimor, por edhe si një faktor i rëndësishëm për rritjen e nivelit të cilësisë duke u angazhuar në përpunimin e rregulloreve dhe standardeve të ndryshme të cilësisë.
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe	Me qëllim përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve, Universiteti Politeknik i Tiranës (UPT) ka zhvilluar një politikë të qartë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë. Kjo politikë përfshin procedura periodike të brendshme që synojnë përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programeve të ofruara. Statuti i UPT-së specifikon detajisht procedurat e veçanta për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të ofruara. Funksionet e KPS dhe detyrat e Koordinatorit të programit të studimit si edhe detyra konkrete për njësitë, individët,

garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	studentët, pedagogët dhe palë të tjera të angazhuara për garantimin e cilësisë së programit të studimit përcaktohen në Rregulloren e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies [Ref_002 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT, Neni 4, 5 dhe 6], në Rregulloren e brendshme të FIMIF [Ref_031 Rregullore Njesia Kryesore FIMIF] si dhe në Rregulloret e departamenteve përgjegjëse [Ref_034 Rregullore Njesia Baze DIF] për këtë program studimi. Studentët janë të angazhuar në sigurimin e brendshëm të cilësisë. Angazhimi i studentëve në organet vendimmarrëse lidhet direkt me sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit. Konkretisht studentët kanë përfaqësuesit e tyre në komisionet si më poshtë: ● Përfaqësimin e tyre në senat dhe në organe të tjera vendimmarrëse të institucionit [Ref_001 Statuti i UPT, Neni 49 & 51]. Studentët janë pjesëmarrës edhe në NJQSC/NJSC dhe në KPS [Ref_039 Vendimi per Emerimin e KPS te Bch. IF].
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.	Në nivel Njësie Kryesore për të siguruar dhe garantuar sigurimin e cilësisë të programeve të studimit të ciklit të parë dhe të dytë është ngritur Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës. Dega luan funksionin e Njësies të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në nivel Njësie Kryesore. Për monitorimin në vijimësi të PS, janë ngritur dhe funksionojnë KPS për cdo program studimi. Ndërsa për vlerësimin e sigurimit të cilësisë në PS janë ngritur Grupet e Vlerësimit të Brendshëm, të cilët në përbërje të tyre kanë përveç stafit akademik edhe studentë për cdo PS [Ref_IV.Urdher per Ngritjen e Grupit te Vleresimit te Brendshem_GVB_Bch.IF] Studentet jane pjese e KPS. Tregues i përfshirjes se studentëve është pyetësori i organizuar prej NJQSC-së në fund të cdo semestri për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies për cdo lëndë [Ref_083-085 Raportimi Vjetor 2021-2024 NJSBC FIMIF]. Në këtë proces studentët përfshihen jo vetëm në plotësimin e pyetësorit por edhe si aktorë aktiv në procesin e ngritjes së kulturës së cilësisë duke i angazhuar në fushatat informuese dhe promovuese mbi rëndësinë e përfshirjes së studentëve në politikat e vlerësimit të UPT-së, duke marrë pjesë aktivisht në plotësimin e Pyetësorëve të Studentëve për Vlerësimin e Cilësisë së Mësimdhënies, Sondazhin Kombëtar etj.
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë cdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Gjatë implementimit të instrumentave të drejtpërdrejta dhe tërthorta të përdorur prej strukturave përkatëse me qëllim vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit është respektuar liria dhe etika akademike si dhe Ligji Nr.9887 datë 10.03.20008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale [Ref_003 Kodi i Etikës i UPT]. Vlerësimi i cilësisë së programit të studimit Bachelor në Inxhinierinë Fizike realizohet nga studentët e çdo kursi në mënyrë anonime duke tentuar të ruajë anonimin e tyre edhe pse anketimit kryhet përmes

	përdorimit të sistemit BIT-ALBANIA me numrin e identifikimit që ka çdo student. Kontrolli i procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies ka garantuar bazarinë e plotë midis anëtareve të stafit akademik si dhe midis studentëve. Në FIMIF nuk ka asnjë praktikë ankimimi nga ana e studentëve apo stafit akademik dhe administrativ në shërbim të tyre për diskriminim dhe pabarazi.
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Njësia Bazë, departamentet e FIMIF operon me të njëjtat metodologji dhe instrumenta të NJSBC/NJQSC-së [Ref_083-085 Raportimi Vjetor 2021-2024 NJSBC FIMIF]. Me qëllim përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe përshtatjen e vazhdueshme me kërkesat e tregut e punës nepërmjet ndarjes së eksperiencave midis bashkëpunëtorëve, ekspertëve të jashtëm dhe Alumni, UPT, Fakulteti i Inxhinierise Matematike dhe Inxhinierise Fizike organizojne Panairët e Karrierës. Panairi vjen në ndihmë studentëve në një përfaqje më të mirë ndaj tregut të punës si dhe për mundësi punësimi dhe internshipi. Në këto panairë marrin pjesë subjekte publike dhe kompani private të cilat ofrojnë ndaj studentëve pozicionet e tyre vakante dhe japin ekspertizën dhe mendimet e tyre në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj. Ekspertiza e tyre ka qenë e vlefshme sidomos në përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie, në aspektet e lidhjes së teorisë me praktikën. Mendimi i ekspertëve është tërhequr jo vetëm nëpërmjet angazhimit të tyre në mësimdhënie, por edhe në takime të ndryshme, në leksione të hapura, work-shope, konferenca, etj.
Konkluzione	<i>GVJ konkludon se: UPT parashikon dhe garanton politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë duke përfshirë aktorët e brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit Bachelor në Inxhinierinë Fizike, garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore (DIF dhe FIMIF), përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit respekton integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Universiteti Politeknik i Tiranës, i bën transparente dhe publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit, politikën, strategjinë, organizimin dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për të gjitha programet e studimit, nëpërmjet postimit në faqen zyrtare elektronike (http://upt.al/) të Universitetit (Statuti, Vendime të Senatit Akademik, Vendime të Bordit të Administrimit, Raportet e analizës së rezultateve të pyetësorëve të anketimit të studentëve, aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë etj) si dhe nëpërmjet shkresave zyrtare tek të gjitha Njësitë Kryesore, Njësite Bazë duke krijuar kështu një universitet të hapur e transparent me të gjithë aktorët e brendshëm e të jashtëm të tij.
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.531, datë 11.09.2018 “Për Miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë”, Standarti VI.5, Kriteri.2 është përpiluar Raporti i Analizës së Pyetësorëve të Studentëve për Cilësinë e Mësimdhënies për çdo Lëndë të çdo Programi Studimi [Ref_083-085 Raportimi Vjetor 2021-2024 NJSBC FIMIF]. Këto raporte publikohen online në web-in e UPT [https://upt.al/cilesia-ne-upt]. Informacioni i publikuar në raport respekton lirinë dhe etikën akademike si dhe Ligjin Nr.9887 datë 10.03.20008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Gjithashtu, prej vitit 2018, Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë ka kryer rregullisht edhe anketimin semestral studentor mbi cilësinë në mësimdhënie. Pyetësori i hartuar plotësohet nga studentët për çdo pedagog duke dhënë indikatorë të perceptimit të performancës nga studenti. Rezultatet e pyetësorit për çdo pedagog i përcillen Rektorit së bashku me një analizë statistikore mbi indikatorët. Ndërkohë, përmes rezultateve individuale të personelit akademik, hartohen analiza për të evidentuar pikat e forta dhe problematikat specifike në çdo program studimi. Këto analiza përmblidhen në trajtë raporti dhe i përcillen njësite kryesore dhe atyre bazë për të zhvilluar analiza të mëtejshme e për të vijuar punën mbi përmirësimin e cilësisë. Raportet janë publike dhe të

	aksesueshme online [<i>Ref_083-085 Raportimi Vjetor 2021-2024 NJSBC FIMIF</i>], [https://upt.al/cilesia-ne-upt].
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies UPT e ka bazuar në ngritjen e strukturave përkatëse si Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Drejtorinë e Kurrikulave [<i>Ref_007 Organigrama e UPT</i>] të cilat janë përgjegjëse për respektimin e standardeve të përgatitjes së planeve mësimore, syllabuseve të lëndëve si dhe të gjithë dokumentacionit të programeve të studimit, si dhe në përmirësimin e cilësisë së stafit akademik, përmirësimin e infrastrukturës laboratorike e të mësimdhënies dhe përsosjen e metodave të mësimdhënies, elementë të cilët i nënshtrohen një vlerësimi periodik nga njësitë bazë dhe studentët. Në UPT, për të patur një menaxhim më të mirë të procesit të hapjes dhe riorganizimit të programeve të studimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të tyre, pranë departamenteve janë ngritur Këshillat e Programeve të Studimit (KPS) për çdo program studimi që është nën përgjegjësinë e departamentit si dhe janë caktuar koordinatorët e programeve të [<i>Ref_039 Vendimi per Emerimin e KPS te Bch.IF</i>]. Një nga funksionet kryesore të KPS është rishikimi i programit të studimit, mbështetur në nevojat e tregut të punës, zhvillimet në rajon dhe në botë, tendencat e zhvillimit të programeve të studimit të ngjashme në Europë e më tej, propozimet për përmirësim të ardhur nga mësimdhënësit, analizën e procesit mësimor [<i>Ref_120-122 Raporti Vjetor Mesimor FIMIF 20-23</i>], [<i>Ref_061 Analiza Vjetore e Punes Mesimore DIF</i>] anketimet e studentëve [<i>Ref_067 Organizimi i Pyetesorit Studentor FIMIF 22-23</i>] ndryshimet në infrastrukturën laboratorike [<i>Ref_079 Labororet ne FIMIF dhe Departamentet e saj</i>] rezultatet e projekteve të ndryshme të mbështetura nga Bashkimi European ose nga vende të tjera të lidhura me zhvillim kurrikular në Shqipëri [<i>Ref_097 Pjesëmarrja në Projekte dhe Trajnime, Mobilitete të Stafit Akademik dhe Studentëve FIMIF</i>], [<i>Ref_098 Aktivitete Shkencore dhe Ore të Hapura nga Lektore të Huaj të Ftuar FIMIF</i>] kërkesa të ardhura nga biznesi ose qeveria, si përgjigje

	e kërkesave të tregut të punës, etj [Ref_092 Sondazhe mbi Tregun e Punës dhe Kompanitë UPT].			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Me qëllim ngritjen e kulturës së cilësisë Institucioni organizon aktivitete dhe seminareve informuese me studentët, kryesisht në trajtën e fushatave informuese me qëllim ndërgjegjësimin e studentëve mbi rëndësinë e pjesëmarrjes së tyre në procesin e përmirësimit të cilësisë së programeve të studimit dhe shërbimeve administrative që ata marrin në institucion [Ref_119 Broshura dhe Guida Informuese per Studentet FIMIF] (si për shembull plotësimi i pyetësorëve0, [Ref_067 Organizimi i Pyetësorit Studentor FIMIF 22-23] pjesëmarrja në Sondazhin Kombëtar të Studentëve [Ref_083 Raportimi Vjetor 2021-2022 NJSBC FIMIF] etj). Më specifikisht nëpërmjet: • Takimeve të drejtpërdrejta me studentët në auditore. • Publikimit të njoftimit në rrjetet promovuese online të Universitetit.			
Konkluzione	GVJ konkludon se: Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit. UPT publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara. Ai vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit. UPT organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.			
	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Inxhinierinë Fizike” të ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universitetit Politeknik i Tiranës”.

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Programi i studimit është pjesë integrale e programeve të Universitetit Politeknik të Tiranës, i vetmi institucion publik në vend i profilizuar tërësisht në fushën e shkencave inxhinierike e të zbatuara me eksperiencë shumëvjeçare, vlerësuar dhe akredituar për cilësinë e programeve dhe studentëve të diplomuar ndër vite.
2. Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Fizike është i vetmi program në vendin tonë i orientuar në fizikën e aplikuar me drejtim inxhinierik i konsideruar si program me interes kombëtar për nga rëndësia që ai mbart.
3. Infrastruktura laboratorike që disponon UPT, FIMIF dhe DIF, ndihmojnë studentët të praktikojë njohuritë e veta në aplikime të drejtpërdrejta duke mundësuar aftësim profesional për studentët që duan të punësohen pas përfundimit të studimeve.
4. Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit ka eksperiencë shumëvjeçare, kualifikime, aktivitet kërkimor, studime dhe botime me impakt në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Raporti staf/student është një nga më të lartat në nivel kombëtar.
5. Institucioni siguron një rrjet të gjerë partnerësh bashkëpunëtorësh dhe ekspertësh me të cilët sigurohen aktivitetet e vazhdueshme në zhvillimin e mëtejshëm profesional dhe të programit të studimit.
6. Institucioni aplikon politika të mbështetjes së vazhdueshme për kategori të ndryshme të studentëve në nevojë si dhe mbështet dhe promovon studentët që kanë arritje gjatë periudhës së studimeve në programin e studimit Bachelor në Inxhinierinë Fizike.
7. Programi i studimit garanton nivel të lartë punësimi brenda dhe jashtë vendit, njohje të plotë nga institucionet ndërkombëtare, transferim të studimeve në programe të ngjashme si dhe njohje/ekuivalentim të plotë për vijimin e studimeve master jashtë vendit.

Pika të dobta:

1. Rënia e vazhdueshme numrit të maturantëve që aplikojnë në programin e studimit ul mundësinë e përzgjedhjes së studentëve me rezultate të larta duke ndikuar në këtë mënyrë në cilësinë e tyre. **[Standardi V.1, Kriteri 1]**
2. Mungesa e lëndëve/moduleve në gjuhën angleze nuk krijon premisa për regjistrimin e studentëve të huaj. **[Standardi V.1, Kriteri 3]**

Rekomandime:


1. FIMIF dhe DIF duhet të intensifikojnë në të ardhmen politikat promovuese për informimin e maturantëve që të aplikojnë në programin e studimit duke i bashkëlidhur ofertës akademike edhe mbështetjen financiare që qeveria shqiptare garanton për studentët.

2. Të shihet mundësia e përfshirjes së lëndëve/moduleve në gjuhën angleze për regjistrimin e studentëve të huaj duke garantuar jo vetëm ecurinë afatgjatë të programit por edhe nivel më të lartë ndërkombëtarizimi.
3. Përfshirja e bashkëpunëtorëve të jashtëm të industrisë në fushën e programit të studimit për të krijuar mundësi integrimi të studentëve në tregun e punës dhe njëkohësisht mundësi financimi të programit

Evaluation's conclusions for the first cycle study program Bachelor "Physics Engineering" provided by the Higher Education Institution "Polytechnic University of Tirana"

Strengths and affirmations

1. The study program is an integral part of the Polytechnic University of Tirana's programs, the only public institution in the country entirely specialized in the field of engineering and applied sciences with many years of experience, valued and accredited for the quality of its programs and graduates over the years.
2. The Bachelor's study program in "Physics Engineering" is the only program in our country oriented towards applied physics with an engineering direction, considered a program of national interest due to its importance.
3. The laboratory infrastructure available at UPT, FIMIF, and DIF helps students apply their knowledge in direct applications, enabling professional skills development for students who wish to be employed after graduation.
4. The academic staff engaged in the study program have many years of experience, qualifications, research activities, studies, and publications with impact at both national and international levels. The staff-to-student ratio is one of the highest at the national level.
5. The institution ensures a wide network of partners, collaborators, and experts with whom continuous activities are secured for further professional development and the study program.
6. The institution applies continuous support policies for different categories of students in need, as well as supports and promotes students who have achievements during the study period in study program Bachelor in "Physics Engineering". The financial support of the study program students from the Albanian Government will affect the increase in the number of students.
7. The study program ensures a high level of employment both domestically and internationally, full recognition by international institutions, transfer of studies to similar programs, and full recognition/equivalence for pursuing master's studies abroad.




Weaknesses

3. The continuous decline in the number of high school graduates applying to the study program reduces the possibility of selecting students with high results, thus affecting their quality.
4. The lack of courses/modules in English does not create conditions for the enrollment of foreign students.

Recommendation

1. FIMIF and DIF should intensify promotional policies in the future to inform high school graduates to apply to the study program, by attaching financial support from the Albanian government to the academic offer.
2. The possibility of including courses/modules in English should be considered to enroll foreign students, ensuring not only the long-term continuity of the program but also a higher level of internationalization.
3. The inclusion of external industry collaborators in the study program's field to create opportunities for student integration into the job market and simultaneously provide funding opportunities for the program



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA , LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

